CITATE
TË KRYETARIT
MAO CEDUN

CITATE
TË KRYETARIT
MAO CEDUN

SHTËPIA BOTONJËSE E
GJUHËVE TË HUAJA
PEKIN 1972

Shtypur në Republikën Popullore të Kinës

MESAZH I SHOKUT MAO CEDUN DREJTUAR KONGRESIT TË 5-të TË PPSH

KONGRESIT TË 5-të TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Të dashur shokë,

Partia Komuniste e Kinës dhe populli kinez i shprehin Kongresit të 5-të të Partisë së Punës të Shqipërisë përshëndetjet më të nxehta.

I urojmë kongresit tuaj sukses të plotë!

Partia e lavdishme e Punës e Shqipërisë, me shokun Enver Hoxha në krye, mban lart me vendosmëri flamurin e kuq revolucionar të marksizëm-leninizmit në kushtet e rrethimit të shumëfishtë nga ana e imperializmit dhe e revizionizmit modern.

Shqipëria popullore heroike është bërë një fener i madh ndriçues i socializmit në Evropë.

Në krahasim me ju, klika udhëheqëse revizioniste e Bashkimit Sovjetik, klika titiste jugosllave dhe klikat e renegatëve dhe grevëthyesve të ndryshëm, nuk janë gjë tjetër veçse një tog me baltë, ndërsa ju jeni një mal kreshnik. Ata janë shërbëtorë e qehallarë që bien në gjunjë para imperialistëve, ndërsa ju jeni revolucionarë proletarë sypatrembur, që guxoni të luftoni kundër imperialistëve dhe këlyshëve të tyre, kundër të gjithë armiqve të egër në botë.

Në Bashkimin Sovjetik, në Jugosllavi dhe në vendet e tjera ku në fuqi janë klikat e revizionistëve modernë, ka ndryshuar ose po ndryshon ngjyra, është kryer ose po kryhet restaurimi i kapitalizmit, diktatura e proletariatit është shndërruar ose po shndërrohet në diktaturë të borgjezisë. Shqipëria socialiste heroike e ka përballuar këtë rrymë regresive revizioniste kundërrevolucionare. Duke iu përmbajtur vijës revolucionare marksiste-leniniste, ju keni

marrë një sërë masash revolucionarizuese dhe keni konsoliduar diktaturën e proletariatit. Duke ecur në rrugën e socializmit, ju po ndërtoni në mënyrë të pavarur Atdheun tuaj dhe keni arritur fitore të shkëlqyera. Ju keni kontribuar me një eksperiencë të çmuar në historinë e diktaturës së proletariatit.

"Kemi miq në këtë botë, me ta jemi lidhur fort, nga ata sado larg që jemi, porsi komshi të mirë i kemi". Mijëra male dhe qindra lumenj e ndajnë Kinën nga Shqipëria, por zemrat tona janë të lidhura ngushtë. Ne jemi miq e shokë tuaj të vërtetë dhe ju jeni gjithashtu miq e shokë tanë të vërtetë. Si ne ashtu edhe ju nuk jemi miq të rremë që nga goja nxjerrim mjaltë dhe mbajmë helmin në bark, nuk jemi njerëz me dy faqe. Miqësia jonë revolucionare e luftarake u ka rezistuar provave në stuhi e shtërngata.

E vërteta e marksizëm-leninizmit është me ne. Proletariati ndërkombëtar është me ne. Kombet e shtypura dhe popujt e shtypur janë me ne. Masat popullore, që përbëjnë mbi 90 përqind të popullsisë së

përgjithshme të botës, janë me ne. Ne kemi miq në gjithë botën. Ne nuk kemi frikë nga izolimi dhe nuk do të izolohemi kurrë. Ne jemi të pamposhtur. Një grusht njerëzish mizerabël antikinezë dhe antishqiptarë janë të destinuar të dështojnë.

Ne jetojmë tani në një epokë të re dhe të madhe të revolucionit botëror. Furtuna e revolucionit në Azi, në Afrikë dhe në Amerikën Latine do t'i japë patjetër tërë botës së vjetër një goditje shkatërruese vendimtare. Dëshmi e gjallë për këtë është fitorja e madhe e luftës që bën populli vietnamez kundër agresorëve amerikanë për shpëtimin e atdheut. Proletariati dhe punonjësit e Evropës, Amerikës Veriore dhe Oqeanisë ndodhen në një zgjim të ri. Imperialistët amerikanë dhe të gjithë parazitët e tjerë kanë pregatitur varrmihësit e tyre. Dita e varrimit të tyre nuk do të jetë e largët.

Sigurisht, rruga në të cilën ecim ne nuk mund të jetë kurrë e sheshtë e pa kthesa. Të jeni të sigurtë, shokë, se pavarësisht nga çfarëdo që të ndodhë në botë, dy partitë dhe dy popujt tanë me siguri do të që-

ndrojnë sëbashku, do të luftojnë sëbashku dhe do të fitojnë sëbashku.

Le të bashkohen partitë dhe popujt e Kinës dhe Shqipërisë, le të bashkohen marksistë-leninistët e mbarë botës, le të bashkohen popujt revolucionarë të të gjitha vendeve për të përmbysur imperializmin, për të përmbysur revizionizmin modern, për të përmbysur reaksionin e vendeve të ndryshme. Një botë e re pa imperializëm, pa kapitalizëm dhe pa sistem shfrytëzimi do të krijohet patjetër.

KOMITETI QENDROR I PARTISË KOMUNISTE TË KINËS

Kryetari

MAO CEDUN

25 tetor 1966

I. PARTIA KOMUNISTE

Forca qendrore që udhëheq çështjen tonë është Partia Komuniste e Kinës.

Baza teorike, nga e cila orientohet mendimi ynë është marksizëm-leninizmi.

Fjala e hapjes në sesionin e parë të legjislaturës së parë të Asamblesë Kombëtare Populllore të Republikës Populllore të Kinës (15 shtator 1954).

Për të bërë revolucion, duhet të kesh një parti revolucionare. Pa një parti revolucionare, pa një parti revolucionare të krijuar në bazë të teorisë revolucionare marksiste-leniniste dhe të stilit revolucionar marksist-leninist, nuk mund të udhëhiqen klasa punëtore dhe masat e gjera populllore

drejt fitores në luftën e tyre kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij.

«Forca revolucionare të të gjithë botës, bashkohuni, luftoni agresionin imperialist!» (nëndor 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Pa përpjekjet e Partisë Komuniste të Kinës, pa komunistët kinezë, si shtyllë kurrizore e popullit kinez, nuk mund të arrihet as pavarësia dhe çlirimi i Kinës, as industrializimi dhe modernizimi i bujqësisë së saj.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Partia Komuniste e Kinës është bërthama udhëheqëse e gjithë popullit kinez. Pa një bërthamë të tillë, çështja e socializmit nuk mund të triumfojë.

Bisedë e zhvilluar gjatë takimit me delegatët e Kongresit të 3-të të Bashkimit të Rinisë së Demokracisë së Re të Kinës (25 maj 1957).

Një parti e disiplinuar, e armatosur me teorinë marksiste-leniniste, që përdor metodën e autokritikës dhe që është e lidhur me masat popullore; një ushtri e udhëhequr nga një parti e tillë; një front unik i të gjitha klasave revolucionare dhe i të gjitha grupeve revolucionare nën udhëheqjen e një partie të tillë — ja tri armët kryesore, me të cilat ne e mundëm armikun.

«Mbi diktaturën demokratike të popullit» (30 qershor 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Ne duhet të kemi besim tek masat, duhet të kemi besim tek partia. Këto janë dy parime themelore. Në qoftë se do t'i vëmë në dyshim këto dy parime, ne nuk do të mund të bëjmë asgjë.

«Mbi çështjen e kooperimit të bujqësisë» (31 korrik 1955).

E armatosur me teorinë dhe ideologjinë marksiste-leniniste, Partia Komuniste e Kinës i solli popullit kinez një stil të ri

pune, tiparet kryesore të të cilit janë: bashkimi i teorisë me praktikën, lidhja e ngushtë me masat popullore dhe autokritika.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Një parti që udhëheq një lëvizje të madhe revolucionare nuk mund të korrë fitore pa zotëruar teorinë revolucionare, pa pasur njohuri mbi historinë dhe pa e kuptuar thellë lëvizjen praktike.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Ne kemi thënë edhe më parë, se lëvizja për ndreqjen e stilit është një "lëvizje e përgjithshme për edukimin marksist". Ndreqje e stilit do të thotë që gjithë partia të studiojë marksizmin nëpërmjet kritikës dhe autokritikës. Gjatë kësaj lëvizjeje ne

patjetër do ta përvehtësojmë edhe më thellë marksizmin.

> «Fjala e mbajtur në konferencën kombëtare të Partisë Komuniste të Kinës mbi punën e propagandës» (12 mars 1957).

Është një detyrë shumë e vështirë t'u sigurosh një jetë të mirë disa qindra miliona kinezëve, të shndërrosh vendin tonë të prapambetur nga pikëpamja ekonomike dhe kulturale në një vend të begatshëm, të fuqishëm dhe me një kulturë të lartë. Që të mund t'i dalim në krye më me sukses kësaj detyre, si dhe që të mund të punojmë më mirë sëbashku me të gjithë njerëzit me vullnet të mirë jashtë partisë, që janë të vendosur për të kryer transformime, ne duhet të zhvillojmë lëvizjen për ndreqjen e stilit, duhet ta zhvillojmë atë si tani ashtu edhe në të ardhmen dhe të flakim tej vazhdimisht çdo gjë të gabuar që kemi.

Po aty.

Politika është pikënisja e të gjitha veprimeve praktike të një partie revolucionare dhe manifestohet në procesin dhe rezultatet e këtyre veprimeve. Çdo veprim i një partie revolucionare është zbatim i politikës. Në qoftë se ajo nuk zbaton një politikë të drejtë, atëherë zbaton një politikë të gabuar; në qoftë se ajo nuk e zbaton në mënyrë të ndërgjegjshme një politikë të caktuar, atëherë e zbaton atë verbërisht. Ajo që ne quajmë eksperiencë, është procesi dhe rezultatet e zbatimit të politikës. Vetëm nga praktika e popullit, domethënë nga eksperienca, mund të verifikohet nëse një politikë është e drejtë apo e gabuar dhe të përcaktohet se në ç'masë ajo është e drejtë apo e gabuar. Por praktika e njerëzve, veçanërisht praktika e një partie revolucionare dhe e masave revolucionare, nuk mund të mos lidhet me këtë apo atë politikë. Prandaj, para se të ndërmarrim ndonjë veprim, duhet t'ua sqarojmë anëtarëve të partisë dhe masave politikën që kemi formuluar në përshtatje me rrethanat. Përndryshe, anëtarët e partisë dhe

masat nuk do të udhëhiqen nga politika jonë, do të veprojnë verbërisht dhe do të zbatojnë një politikë të gabuar.

«Mbi politikën në lidhje me industrinë dhe tregëtinë» (27 shkurt 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Partia jonë e ka përcaktuar vijën e përgjithshme dhe politikën e përgjithshme të revolucionit kinez, ajo ka përcaktuar gjithashtu vija të veçanta në punë dhe masa politike të veçanta. Megjithatë, ndodh shpesh që shumë shokë mbajnë mend vijat e veçanta në punë dhe masat politike të veçanta të partisë sonë, por harrojnë vijën e përgjithshme dhe politikën e përgjithshme të saj. Në qoftë se me të vërtetë e harrojmë vijën e përgjithshme dhe politikën e përgjithshme të partisë sonë, ne do të jemi revolucionarë të verbër, revolucionarë të paformuar, me mendime të turbullta dhe, kur të zbatojmë një vijë të veçantë në punë dhe masa politike të veçanta, ne do të humbasim orientimin, do të anojmë herë

nga e majta, herë nga e djathta dhe do t'i sjellim dëm punës sonë.

«Fjala e mbajtur në konferencën e kuadrove të krahinës së çliruar Shansi-Sujuan» (1 prill 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Politika dhe taktika janë jeta e partisë; shokët udhëheqës të të gjitha instancave duhet medoemos t'u kushtojnë atyre vëmendjen më të madhe dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të tregohen të pakujdesshëm.

«Qarkore mbi situatën» (20 mars 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

II. KLASAT DHE LUFTA E KLASAVE

Luftë klasash — fitorja e disa klasave, zhdukja e disa të tjerave, — e tillë është historia, historia e qytetërimeve prej mijëra vjetësh. Interpretimi i historisë sipas kësaj pikëpamjeje quhet materializëm historik, kurse interpretimi i saj nga pikëpamja e kundërt quhet idealizëm historik.

«Flakni iluzionet dhe pregatituni për luftë» (14 gusht 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Në shoqërinë me klasa çdo njeri jeton si pjesëtar i një klase të caktuar, dhe nuk ka mendim që të mos mbajë vulën e klasës.

«Mbi praktikën» (korrik 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Ndryshimet që ndodhin në shoqëri janë kryesisht rezultat i zhvillimit të kontradiktave në gjirin e saj, domethënë të kontradiktave midis forcave prodhuese dhe marrëdhënieve në prodhim, të kontradiktave midis klasave, të kontradiktave midis së resë dhe së vjetrës. Zhvillimi i këtyre kontradiktave e shtyn shoqërinë përpara, çon në zëvendësimin e shoqërisë së vjetër me shoqërinë e re.

«Mbi kontradiktën» (gusht 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Shfrytëzimi i pamëshirshëm ekonomik dhe shtypja e egër politike e fshatarësisë nga klasa çifligare e detyruan atë të shpërthejë kryengritje të shumta kundër sundimit të klasës çifligare. . . . Në shoqërinë feudale kineze vetëm lufta klasore e fshatarësisë, kryengritjet dhe luftërat fshatare përbënin forcat lëvizëse të vërteta të zhvillimit historik.

«Revolucioni kinez dhe Partia Komuniste e Kinës» (dhjetor 1939), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 3.

Lufta kombëtare është, në analizë të fundit, një luftë klasash. Zezakët në Shtetet e Bashkuara shtypen vetëm nga ata të bardhë, që përbëjnë qarqet sunduese reaksionare. Këto qarqe në asnjë mënyrë nuk mund të përfaqësojnë punëtorët, fshatarët, intelektualët revolucionarë dhe njerëzit e tjerë përparimtarë, që përbëjnë shumicën dërmuese të të bardhëve.

> «Deklaratë në përkrahje të zezakëve amerikanë në luftën e tyre të drejtë kundër dallimit racial të ushtruar nga imperializmi amerikan» (8 gusht 1963).

Popullin duhet ta organizojmë ne. Duhet ta organizojmë atë për të përmbysur reaksionarët në Kinë. Asgjë reaksionare nuk rrëzohet, po nuk e godite. Është njësoj si kur fshin: aty ku nuk kalon fshesa, pluhuri nuk ikën vetiu.

> «Gjendja dhe politika jonë pas fitores në Luftën e Rezistencës kundër Japonisë» (13 gusht 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Armiku nuk do të zhduket vetiu. As reaksionarët kinezë, as forcat agresive të imperializmit amerikan në Kinë nuk do të largohen vetë nga skena e historisë.

«Ta çojmë revolucionin deri në fund» (30 dhjetor 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Revolucioni nuk është një gosti, nuk është një krijim letrar, nuk është një vizatim ose një qëndisje; ai nuk mund të kryhet me aq elegancë e me nge, me aq qetësi e delikatesë, me aq butësi, dashamirësi, vetëpërmbajtje, mirësjellje dhe shpirtmadhësi. Revolucioni është një kryengritje, është akt dhune, me anën e të cilit një klasë përmbys një klasë tjetër.

«Raport mbi studimin e bërë në provincën e Hunanit në lidhje me lëvizjen fshatare» (mars 1927), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Çan Kaj-shiu përpiqet t'i rrëmbejë popullit edhe grimcën më të vogël të pushtetit, edhe përfitimin më të vogël. Po ne? Politika jonë është që të përgjigjemi thikë për

thikë dhe të luftojmë për çdo pëllëmbë tokë. Ne veprojmë ashtu siç vepron ai. Çan Kaj-shiu kërkon gjithmonë t'i imponojë luftën popullit, duke mbajtur një shpatë në dorën e majtë dhe një tjetër në të djathtën. Sipas shembullit të tij, ne gjithashtu rrokim shpatat. . . . Tani Çan Kaj-shiu po mpreh shpatat e tij, prandaj edhe ne duhet t'i mprehim tonat.

> «Gjendja dhe politika jonë pas fitores në Luftën e Rezistencës kundër Japonisë» (13 gusht 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Cilët janë armiqtë tanë dhe cilët janë miqtë tanë? Kjo është një çështje me rëndësi të dorës së parë për revolucionin. Shkaku kryesor, që në të kaluarën të gjitha luftërat revolucionare në Kinë kanë dhënë rezultate shumë të pakta, qëndron në faktin që revolucionarët nuk kanë mundur të bashkojnë rreth vehtes miqtë e vërtetë që t'u jepnin goditje armiqve të vërtetë. Partia revolucionare është udhëheqëse e masave dhe nuk ka pasur asnjë rast që revolucioni të mos ketë pësuar disfatë, kur partia revolucionare

i ka udhëhequr masat në rrugë të gabuar. Për të qenë të sigurtë se ne nuk do t'i udhëheqim masat në rrugë të gabuar dhe se do të arrijmë medoemos sukses në revolucion, ne duhet të kujdesemi për të bashkuar rreth vehtes miqtë tanë të vërtetë që t'u japim goditje armiqve tanë të vërtetë. Dhe për t'i dalluar miqtë e vërtetë nga armiqtë e vërtetë, ne duhet t'i bëjmë një analizë të përgjithshme gjendjes ekonomike të klasave të ndryshme në shoqërinë kineze dhe qëndrimit të tyre kundrejt revolucionit.

«Analizë mbi klasat e shoqërisë kineze» (mars 1926), *Vepra të zgjedhura*, vëll. I.

Të gjithë feudalët satrapë, burokratët, klasa kompradore dhe klasa e çifligarëve të mëdhenj, që bashkëpunojnë me imperializmin, si dhe pjesa reaksionare e inteligjencies, që varet prej tyre, janë armiqtë tanë. Proletariati industrial është forca udhëheqëse e revolucionit tonë. Gjithë gjysmëproletariati dhe borgjezia e vogël janë miqtë tanë më të afërm. Nga borgjezia e mesme e lëkundshme, krahu

i djathtë i saj mund të jetë armiku ynë dhe krahu i majtë miku ynë; por duhet të tregohemi gjithmonë vigjilentë ndaj tyre që të mos krijojnë rrëmujë në frontin tonë.

Po aty.

Kush qëndron në anën e popullit revolucionar, është revolucionar. Kush qëndron në anën e imperializmit, feudalizmit dhe kapitalizmit burokratik, është kundërrevolucionar. Kush qëndron vetëm me fjalë në anën e popullit revolucionar, por vepron ndryshe, është revolucionar me fjalë. Kush qëndron jo vetëm me fjalë, por edhe me vepra në anën e popullit revolucionar, është revolucionar në kuptimin e plotë të fjalës.

Fjala e mbylljes në sesionin e dytë të Komitetit të parë Kombëtar të Konferencës Konsultative Politike Popullore të Kinës (23 qershor 1950).

Unë jam i mendimit se përsa na takon neve, qoftë për një individ, një parti, një ushtri ose një shkollë, po të mos jemi

objekt sulmesh nga ana e armiqve, kjo do të jetë një gjë e keqe, sepse do të thotë patjetër që ne jemi zhytur në një pellg me armiqtë. Po të jemi objekt sulmesh nga ana e armiqve, kjo do të jetë një gjë e mirë, sepse do të provojë se kemi hequr një vijë të qartë demarkacioni midis nesh dhe armiqve. Dhe po të na sulmojnë armiqtë me tërbim, duke na paraqitur me ngjyrat më të errëta sikur s'kemi asgjë të mirë, do të jetë një gjë akoma më e mirë, sepse kjo do të provojë se ne jo vetëm që kemi hequr një vijë të qartë demarkacioni midis nesh dhe armiqve, por edhe kemi korrur suksese të mëdha në punën tonë.

«Të jesh objekt sulmesh nga ana e armiqve është një gjë e mirë dhe jo e keqe» (26 maj 1939).

Ne duhet të përkrahim çdo gjë që kundërshton armiku dhe duhet të kundërshtojmë çdo gjë që përkrah armiku.

«Bisedë me tre korespondentë të agjensisë telegrafike *Çzhunianshe* dhe të gazetave *Saodanbao* dhe *Sinminbao*» (16 shtator 1939), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 3.

Ne qëndrojmë në pozitat e proletariatit dhe të masave popullore. Për komunistët, kjo do të thotë se duhet të qëndrojnë në pozitat e partisë, në pozitat e partishmërisë dhe të politikës së partisë.

«Fjalime të mbajtura në mbledhjen e Jenanit për çështjet e letërsisë dhe të artit» (maj 1942), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Pas asgjësimit të armiqve me armë në duar, do të mbeten armiq pa armë në duar; këta do të bëjnë me siguri kundër nesh një luftë për vdekje; ne në asnjë mënyrë nuk duhet t'i nënvleftësojmë këta armiq. Në qoftë se tani nuk e shtrojmë dhe nuk e kuptojmë problemin në këtë mënyrë, ne do të bëjmë gabime shumë të rënda.

«Raport në plenumin e dytë të Komitetit Qendror të zgjedhur nga Kongresi i 7-të i Partisë Komuniste të Kinës» (5 mars 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Imperialistët dhe reaksionarët e vendit nuk do të pajtohen kurrë me disfatën e tyre;

ata do të bëjnë përpjekjet e fundit. Edhe kur paqa dhe rendi të jenë vendosur në mbarë vendin, ata do të vazhdojnë me të gjitha mënyrat të bëjnë sabotime dhe të shkaktojnë turbullira, do të orvaten çdo ditë e çdo çast të rivendosin sundimin e tyre në Kinë. Kjo është e pashmangshme dhe për këtë s'mund të ketë asnjë pikë dyshimi, prandaj ne nuk duhet ta dobësojmë në asnjë mënyrë vigjilencën tonë.

Fjala e hapjes në sesionin e parë plenar të Konferencës Konsultative Politike Popullore të Kinës (21 shtator 1949).

Në vendin tonë, megjithëse ka marrë fund në përgjithësi transformimi socialist në lëmin e pronës dhe ka përfunduar në përgjithësi lufta e stuhishme klasore e masave në shkallë të gjerë, që karakterizonte periudhat e revolucionit, ekzistojnë akoma mbeturina të klasave të përmbysura çifligare dhe kompradore, mbetet akoma borgjezia, ndërsa riedukimi i borgjezisë së vogël sapo ka filluar. Lufta e klasave akoma nuk ka marrë fund. Lufta e klasave

midis proletariatit dhe borgjezisë, lufta e klasave midis forcave të ndryshme politike, lufta e klasave midis proletariatit dhe borgjezisë në fushën e ideologjisë mbetet një luftë e gjatë me zigzage, bile nganjëherë shumë e ashpër. Proletariati përpiqet ta transformojë botën sipas botëkuptimit të tij, kurse borgjezia sipas botëkuptimit të saj. Në këtë drejtim, çështja se kush do të fitojë e kush do të humbasë — socializmi apo kapitalizmi — akoma nuk është zgjidhur me të vërtetë.

> «Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Zgjidhja e çështjes se kush do të fitojë e kush do të humbasë në luftën ideologjike midis socializmit dhe kapitalizmit në vendin tonë do të kërkojë akoma një kohë mjaft të gjatë. Kjo shpjegohet me faktin që influenca e borgjezisë dhe e inteligjencies së trashëguar nga shoqëria e vjetër do të ekzistojë në vendin tonë për një kohë të gjatë, po ashtu edhe ideologjia e tyre klasore.

Po të mos e kuptosh sa duhet ose po të mos e kuptosh fare këtë, do të biesh në gabime shumë të rënda dhe do të lësh pas dore luftën e nevojshme ideologjike.

Po aty.

Në vendin tonë, ideologjia borgjeze dhe mikroborgjeze, ideologjia antimarksiste do të ekzistojë akoma për një kohë të gjatë. Sistemi socialist në përgjithësi është vendosur në vendin tonë. Në përgjithësi, ne e kemi siguruar fitoren në transformimin e pronës mbi mjetet e prodhimit, por në frontin politik dhe ideologjik akoma nuk kemi fituar plotësisht. Në fushën e ideologjisë nuk është zgjidhur akoma me të vërtetë çështja se kush do të fitojë e kush do të humbasë — proletariati apo borgjezia. Neve na duhet të zhvillojmë akoma një luftë të gjatë kundër ideologjisë borgjeze dhe mikroborgjeze. Do të ishte gabim të mos e kuptonim këtë dhe të hiqnim dorë nga lufta ideologjike. Të gjitha idetë e gabuara, të gjitha barërat helmuese, të gjithë djajt e përbindëshat duhen kritikuar,

nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë që ata të përhapen lirisht. Por kjo kritikë duhet të jetë plotësisht e argumentuar, analitike dhe bindëse, ajo nuk duhet të jetë as brutale e burokratike, as metafizike e dogmatike.

«Fjala e mbajtur në konferencën kombëtare të Partisë Komuniste të Kinës mbi punën e propagandës» (12 mars 1957).

Si dogmatizmi ashtu dhe revizionizmi janë në kundërshtim me marksizmin. Marksizmi patjetër do të zhvillohet përpara, ai do të zhvillohet krahas zhvillimit të praktikës dhe nuk mund të qëndrojë në vend. Nëse ai do të mbetej në amulli dhe do të bëhej stereotip, do të pushonte së jetuari. Megjithatë parimet themelore të marksizmit nuk duhet të shkelen, ndryshe do të bëhen gabime. Ta shikosh marksizmin nga pikëpamja metafizike dhe ta konsiderosh atë si diçka të ngurtë, ky është dogmatizëm. Të mohosh parimet themelore të marksizmit, të mohosh të vërtetën e tij universale, ky është revizionizëm. Revizionizmi është një formë e ideologjisë borgjeze. Revizionistët mohojnë

ndryshimin midis socializmit dhe kapitalizmit, midis diktaturës së proletariatit dhe asaj të borgjezisë. Në fakt ata janë jo për vijën socialiste, por për vijën kapitaliste. Në rrethanat e tanishme revizionizmi është më i dëmshëm se dogmatizmi. Një nga detyrat e rëndësishme që shtrohen sot para nesh në frontin ideologjik është që të zhvillojmë kritikën kundër revizionizmit.

Po aty.

Revizionizmi, ose oportunizmi i djathtë, është një rrymë ideologjike borgjeze. Ai përbën një rrezik më të madh se dogmatizmi. Edhe revizionistët, oportunistët e djathtë, flasin shumë për marksizmin, edhe ata e sulmojnë "dogmatizmin". Mirëpo ato që sulmojnë ata janë pikërisht tezat më themelore të marksizmit. Ata kundërshtojnë ose shtrembërojnë materializmin dhe dialektikën, kundërshtojnë ose përpiqen të dobësojnë diktaturën demokratike të popullit dhe udhëheqjen e partisë komuniste, kundërshtojnë ose përpiqen të dobësojnë transformimet socialiste dhe ndërtimin

socialist. Edhe pasi në vendin tonë është arritur në përgjithësi fitorja e revolucionit socialist, në shoqëri mbetet akoma një pjesë njerëzish që ëndërrojnë të rivendosin rendin kapitalist. Ata luftojnë kundër klasës punëtore në të gjitha fushat, duke përfshirë edhe fushën ideologjike. Dhe në këtë luftë revizionistët janë ndihmësit e tyre më të mirë.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

III. SOCIALIZMI DHE KOMUNIZMI

Komunizmi është një ideologji e plotë e proletariatit dhe njëkohësisht një rend i ri shoqëror. Kjo ideologji dhe ky rend shoqëror ndryshojnë nga çdo ideologji tjetër dhe nga çdo rend tjetër shoqëror; ata janë më të përsosurit, më përparimtarët, më revolucionarët dhe më të arësyeshmit në gjithë historinë e njerëzimit. Ideologjia dhe rendi shoqëror i feudalizmit janë vënë në muzeumin e historisë. Ideologjia dhe rendi shoqëror i kapitalizmit në një pjesë të botës (në BRSS) gjithashtu janë vënë në muzeum, kurse në pjesën tjetër të botës ata i përngjajnë "diellit që perëndon, njeriut në agoni" dhe sëshpejti do të vihen në muzeum. Vetëm ideologjia dhe rendi shoqëror i komunizmit, që janë plot vitalitet

dhe gjallëri rinore, po përhapen në gjithë botën me vrullin e ortekut dhe forcën e rrufesë.

«Mbi demokracinë e re» (janar 1940), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 3.

Sistemi socialist do ta zëvendësojë më në fund sistemin kapitalist. Ky është një ligj objektiv, i pavarur nga vullneti i njeriut. Sado që të përpiqen reaksionarët për të ndaluar ecjen përpara të rrotës së historisë, revolucioni herët ose vonë do të shpërthejë dhe me siguri do të triumfojë.

«Fjala e mbajtur në sesionin jubilar të Sovjetit Suprem të BRSS me rastin e 40-vjetorit të Revolucionit të madh socialist të Tetorit» (6 nëndor 1957).

Ne, komunistët, nuk i fshehim kurrë pikëpamjet tona politike. Programi ynë për të ardhmen, ose programi maksimum, ka për qëllim ta shpjerë Kinën në socializëm dhe në komunizëm; kjo është e përcaktuar,

për këtë nuk ka asnjë dyshim. Emri i partisë sonë dhe botëkuptimi ynë marksist e tregojnë qartë këtë ideal shumë të lartë, jashtëzakonisht të ndritur dhe të mrekullueshëm, që ne do të realizojmë në të ardhmen.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Lëvizja revolucionare kineze në tërësi, e udhëhequr nga Partia Komuniste e Kinës, përfshin dy etapa — revolucionin demokratik dhe revolucionin socialist. Këto janë dy procese revolucionare me karakter të ndryshëm, dhe vetëm pasi të jetë kryer procesi i parë, mund të kalohet në kryerjen e të dytit. Revolucioni demokratik është pregatitje e domosdoshme e revolucionit socialist, ndërsa revolucioni socialist është tendenca e pashmangshme e revolucionit demokratik. Qëllimi i fundit i të gjithë komunistëve është që të luftojnë me të gjitha forcat për ndërtimin përfundimtar

të shoqërisë socialiste dhe të shoqërisë komuniste.

«Revolucioni kinez dhe Partia Komuniste e Kinës» (dhjetor 1939), *Vepra të zgjedhura,* vëll. 3.

Qëllimi i revolucionit socialist është çlirimi i forcave prodhuese. Transformimi i pronës individuale në pronë kolektive socialiste në fushën e bujqësisë dhe të artizanatit, dhe ai i pronës kapitaliste në pronë socialiste në fushën e industrisë dhe të tregëtisë private do të çojë me siguri në një çlirim të konsiderueshëm të forcave prodhuese. Dhe kështu do të krijohen kushtet shoqërore për një zhvillim shumë të madh të prodhimit industrial dhe bujqësor.

Fjalim i mbajtur në Konferencën e Lartë Shtetërore (25 janar 1956).

Tani ne po kryejmë jo vetëm një revolucion në sistemin shoqëror për transformimin e pronës private në pronë shoqërore, por edhe një revolucion teknik për transformimin e prodhimit zejtar në një prodhim

të madh të mekanizuar dhe modern. Këto dy revolucione janë të lidhura midis tyre. Në fushën e bujqësisë, në kushtet e vendit tonë (në vendet kapitaliste bujqësia zhillohet në rrugën e kthimit të saj në një ekonomi kapitaliste), më parë duhet të kryhet medoemos kooperimi dhe pastaj do të mund të përdoren maqinat e mëdha. Nga kjo del se ne nuk duhet kurrë t'i shohim industrinë e bujqësinë — industrializimin socialist e transformimin socialist të bujqësisë — si dy gjëra të ndara e të izoluara nga njëra tjetra, nuk duhet në asnjë mënyrë të vëmë theksin mbi njërën dhe të lëmë pas dore tjetrën.

«Mbi çështjen e kooperimit të bujqësisë» (31 korrik 1955).

Sistemit të ri shoqëror që sapo është vendosur i duhet akoma një kohë për t'u forcuar. Nuk duhet të mendojmë se sistemi i ri mund të forcohet plotësisht që me vendosjen e tij. Kjo është e pamundur. Ai duhet të forcohet gradualisht. Që ky sistem të forcohet përfundimisht, duhet jo vetëm

të realizohet industrializimi socialist i vendit dhe të zhvillohet me këmbëngulje revolucioni socialist në frontin ekonomik, por duhet të zhvillohen edhe revolucioni socialist dhe edukimi socialist i vazhdueshëm dhe këmbëngulës në frontin politik dhe ideologjik. Përveç kësaj, duhet që këtë ta favorizojnë edhe kushtet e ndryshme ndërkombëtare.

«Fjala e mbajtur në konferencën kombëtare të Partisë Komuniste të Kinës mbi punën e propagandës» (12 mars 1957).

Në vendin tonë lufta për forcimin e sistemit socialist, lufta që do të vendosë se kush do të fitojë — socializmi apo kapitalizmi, do të vazhdojë akoma për një periudhë shumë të gjatë historike. Por të gjithë ne duhet të kuptojmë se ky sistem i ri socialist do të forcohet me siguri. Ne do të ndërtojmë patjetër një vend socialist me industri moderne, me bujqësi moderne, me shkencë dhe kulturë moderne.

Po aty.

Intelektualët që ushqejnë ndjenja armiqësore ndaj shtetit tonë, janë një pakicë shumë e vogël. Këtyre njerëzve nuk u pëlqen shteti ynë i diktaturës së proletariatit. Ata e kujtojnë me mallëngjim shoqërinë e vjetër. Kur gjejnë ndonjë rast, ata nxisin turbullira, përpiqen të përmbysin Partinë Komuniste dhe të ringjallin Kinën e vjetër. Midis rrugës së proletariatit dhe asaj të borgjezisë, midis rrugës së socializmit dhe asaj të kapitalizmit, këta njerëz përpiqen me këmbëngulje të ndjekin rrugën e dytë. Kjo rrugë e dytë në fakt është e parealizueshme, prandaj në të vërtetë ata janë gati të kapitullojnë para imperializmit, feudalizmit dhe kapitalizmit burokratik. Njerëz të tillë hasen në rrethet politike, industrialo-tregëtare, kulturalo-arësimore, tekniko-shkencore dhe fetare. Këta janë ultrareaksionarë.

Po aty.

Një problem serioz është edukimi i fshatarësisë. Ekonomia fshatare është e shpërndarë dhe socializimi i bujqësisë, sipas eksperiencës së Bashkimit Sovjetik, kërkon

një kohë të gjatë dhe një punë të kujdesshme. Pa socializimin e bujqësisë nuk mund të ketë socializëm të plotë e të konsoliduar.

«Mbi diktaturën demokratike të popullit» (30 qershor 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Ne duhet të jemi të bindur se: 1) masat e gjera fshatare dëshirojnë të hyjnë gradualisht, nën udhëheqjen e partisë, në rrugën e socializmit; 2) partia është e aftë t'i udhëheqë fshatarët që të hyjnë në këtë rrugë. Këto dy pika janë thelbi dhe aspekti kryesor i problemit.

«Mbi çështjen e kooperimit të bujqësisë» (31 korrik 1955).

Organet drejtuese të kooperativave duhet të krijojnë në gjirin e vet epërsinë e fshatarëve të varfër të sotëm dhe të fshatarëve të mesëm të rinj të shtresës së ulët; ato duhet të kenë si forcë ndihmëse fshatarët e mesëm të vjetër të shtresës së ulët dhe fshatarët e mesëm të shtresës së lartë, qofshin të vjetër

apo të rinj. Vetëm në këtë mënyrë, në përputhje me politikën e partisë, mund të realizohet uniteti midis fshatarëve të varfër dhe fshatarëve të mesëm, të forcohen kooperativat, të zhvillohet prodhimi dhe të kryhet mbi baza të drejta transformimi socialist në të gjitha krahinat fshatare. Përndryshe, nuk mund të realizohen uniteti midis fshatarëve të mesëm dhe fshatarëve të varfër, forcimi i kooperativave, zhvillimi i prodhimit dhe transformimi socialist në të gjitha krahinat fshatare.

Shënim mbi artikullin «Si arritën fshatarët e varfër në kooperativën bujqësore të prodhimit të Utanit, lokaliteti i Kaoshanit, distrikti Çansha të sigurojnë epërsinë që deri atëherë mbahej nga fshatarët e mesëm» (1955), *Hovi i socializmit në fshatin kinez.*

Fshatarët e mesëm duhet t'i bashkojmë rreth vehtes sonë; do të ishte gabim po të mos i bashkonim. Po te kush duhet të mbështeten klasa punëtore dhe Partia Ko-

muniste në fshat për t'i bashkuar ata rreth vehtes dhe për të kryer transformimin socialist në të gjitha krahinat fshatare? Sigurisht, vetëm te fshatarët e varfër. Kështu bëmë në të kaluarën, kur ne luftonim kundër çifligarëve dhe kur zbatuam reformën agrare; kështu po bëjmë edhe sot, kur ne luftojmë kundër kulakëve dhe elementëve të tjerë kapitalistë dhe kryejmë transformimin socialist të bujqësisë. Në etapën fillestare të këtyre dy periudhave revolucionare, fshatarët e mesëm ishin të lëkundshëm. Vetëm kur shohin qartë gjendjen e përgjithshme dhe afrimin e fitores së revolucionit, ata kalojnë në anën e revolucionit. Fshatarët e varfër duhet të punojnë me fshatarët e mesëm, t'i bëjnë për vehte, me qëllim që revolucioni të zgjerohet çdo ditë e më shumë deri në fitoren përfundimtare.

Shënim mbi artikullin «Mësime të nxjerra nga lindja e "kooperativës së fshatarëve të mesëm" dhe e "kooperativës së fshatarëve të varfër" në distriktin Fuan» (1955), *Hovi i socializmit në fshatin kinez.*

Tek fshatarët me gjendje të mirë ekonomike tendencat drejt kapitalizmit janë serioze. Dhe këto tendenca do të përhapen, në rast se ne do të dobësojmë sado pak punën politike me fshatarët gjatë lëvizjes së kooperimit, bile edhe për një periudhë shumë të gjatë në të ardhmen.

Shënim mbi artikullin «Duhet bërë një luftë e vendosur kundër tendencave drejt kapitalizmit» (1955), *Hovi i socializmit në fshatin kinez.*

Lëvizja për kooperimin e bujqësisë qysh në fillim ka qenë një luftë serioze ideologjike dhe politike. Pa një luftë të tillë nuk mund të ngrihet asnjë kooperativë. Për të ngritur një sistem shoqëror krejtësisht të ri mbi truallin e sistemit të vjetër, duhet në fillim të spastrohet ky truall. Mbeturinat e ideologjisë së vjetër, që pasqyrojnë sistemin e vjetër, mbeten patjetër për një kohë të gjatë në ndërgjegjen e njerëzve dhe nuk zhduken lehtë. Pas ngritjes së saj, kooperativa duhet të bëjë akoma shumë përpjekje dhe vetëm kështu mund të forcohet. Edhe

pas forcimit, në qoftë se dobëson sado pak përpjekjet e saj, ajo prapë mund të shkatërrohet.

Shënim mbi artikullin «Një mësim serioz» (1955), *Hovi i socializmit në fshatin kinez.*

Gjatë viteve të fundit forcat spontane të kapitalizmit në fshat kanë ardhur duke u rritur çdo ditë e më tepër, kudo kanë dalë kulakë të rinj; shumë fshatarë të mesëm me gjendje të mirë ekonomike përpiqen të bëhen kulakë. Shumë fshatarë të varfër, duke mos pasur mjete të mjaftueshme prodhimi, ndodhen akoma në varfëri; disa prej tyre kanë borxhe, disa të tjerë kanë shitur tokën ose e kanë dhënë me qera. Në rast se e lëmë këtë gjendje të zhvillohet më tej, diferencimi drejt dy poleve në fshat do të bëhet në mënyrë të pashmangshme gjithnjë e më serioz. Fshatarët që kanë humbur tokën dhe ata që ndodhen akoma në varfëri do të ankohen se nuk i shpëtojmë nga katastrofa dhe nuk i ndihmojmë në kapërcimin e vështirësive. Edhe fshatarët e mesëm me gjendje të mirë ekonomike, që ecin në drejtim

të kapitalizmit, do të mbeten të pakënaqur nga ne, sepse nuk do të jemi kurrë në gjendje të plotësojmë kërkesat e tyre, në qoftë se nuk kemi ndërmend të ndjekim rrugën kapitaliste. Në një gjendje të tillë, a mund të vazhdojë të forcohet aleanca midis punëtorëve dhe fshatarëve? Është e qartë se jo. Ky problem mund të zgjidhet vetëm mbi një bazë të re. Kjo do të thotë që krahas kryerjes graduale të industrializimit socialist dhe transformimit socialist të artizanatit dhe të industrisë e të tregëtisë kapitaliste, të realizojmë gradualisht edhe transformimin socialist të bujqësisë në tërësi, domethënë të kryejmë kooperimin, të likuidojmë ekonominë kulake dhe ekonominë individuale në fshat që të rrisim mirëqenien e gjithë popullsisë fshatare. Sipas mendimit tonë, vetëm në këtë mënyrë mund të forcohet aleanca midis punëtorëve dhe fshatarëve.

«Mbi çështjen e kooperimit të bujqësisë» (31 korrik 1955).

Me planifikimin në tërësi . . . nënkuptohet planifikimi që merr parasysh interesat

e popullit tonë 600-milionësh. Kur ne hartojmë një plan, rregullojmë një punë ose studiojmë një problem, duhet të nisemi nga fakti që vendi ynë ka një popullsi prej 600 milionë frymësh dhe në asnjë rast nuk duhet ta harrojmë këtë.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Përveç udhëheqjes së partisë, një faktor vendimtar është popullsia jonë prej 600 milionësh. Kur ka më shumë njerëz, ka më shumë rrahje mendimesh, më shumë entuziazëm dhe më shumë energji. Asnjëherë masat popullore nuk kanë pasur një mobilizim moral kaq të madh, një vullnet luftarak kaq të fortë dhe një vrull kaq të lartë sa sot.

«Njihuni me një kooperativë!» (15 prill 1958).

Përveç karakteristikave të tjera, popullsinë 600-milionëshe të Kinës e dallon fakti që ajo është e varfër dhe si një letër e

bardhë. Kjo duket si një gjë e keqe, por në realitet është një gjë e mirë. Varfëria të nxit për ndryshime, për aksion, për revolucion. Mbi një letër të bardhë, pa shkarravitje mund të shkruhet e të vizatohet gjithshka që është më e re dhe më e bukur.

Po aty.

Pasi revolucioni kinez të ketë triumfuar në të gjithë vendin dhe çështja agrare të jetë zgjidhur, në Kinë përsëri do të mbeten dy kontradikta themelore. E para është kontradikta e brendshme, domethënë kontradikta midis klasës punëtore dhe borgjezisë. E dyta është kontradikta e jashtme, domethënë kontradikta midis Kinës dhe vendeve imperialiste. Për këtë arësye, pas fitores së revolucionit demokratik popullor, pushteti shtetëror i republikës popullore, që udhëhiqet nga klasa punëtore, nuk duhet të dobësohet, por të forcohet.

«Raport në plenumin e dytë të Komitetit Qendror të zgjedhur nga Kongresi i 7-të i Partisë Komuniste të Kinës» (5 mars 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

"A nuk doni ju ta likuidoni pushtetin shtetëror?" Po, ne duam, por tani për tani jo, ne akoma nuk mund ta bëjmë këtë. Pse? Sepse ekziston akoma imperializmi, ekziston akoma reaksioni i brendshëm, në vendin tonë ekzistojnë akoma klasat. Detyra jonë e tanishme është të forcojmë aparatin shtetëror të popullit, — fjala është kryesisht për ushtrinë popullore, policinë popullore dhe gjykatat popullore, me qëllim që të forcohet mbrojtja kombëtare dhe të mbrohen interesat e popullit.

«Mbi diktaturën demokratike të popullit» (30 qershor 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Shteti ynë është shtet i diktaturës demokratike të popullit, që udhëhiqet nga klasa punëtore dhe që mbështetet në aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë. Cilat janë funksionet e kësaj diktature? Funksioni i saj i parë është të shtypë brenda vendit klasat reaksionare, elementët reaksionarë dhe shfrytëzuesit që kundërshtojnë revolu-

cionin socialist, të shtypë ata që sabotojnë ndërtimin socialist, domethënë të zgjidhë kontradiktat midis nesh dhe armiqve brenda vendit. Në funksionet e diktaturës hyjnë, për shembull, arrestimi dhe dënimi i disa elementëve kundërrevolucionarë dhe heqja e të drejtave elektorale dhe e lirisë së fjalës çifligarëve dhe borgjezëve burokratë për një periudhë të caktuar. Për ruajtjen e rendit publik dhe për mbrojtjen e interesave të masave të gjera popullore, është gjithashtu e nevojshme të ushtrohet diktatura edhe kundrejt kusarëve, batakçinjve, vrasësve dhe zjarrvënësve, kundrejt bandave të vagabondëve dhe elementëve keqbërës që prishin seriozisht rendin publik. Diktatura ka edhe funksionin e saj të dytë, dhe pikërisht: të mbrojë shtetin tonë nga veprimtaria subversive dhe agresioni i mundshëm i armiqve të jashtëm. Në këtë rast diktaturës i del si detyrë të zgjidhë kontradiktat midis nesh dhe armiqve të jashtëm. Qëllimi i diktaturës është që të mbrojë punën paqësore të gjithë popullit, ta shndërrojë Atdheun tonë në një vend

socialist me industri moderne, me bujqësi moderne, me shkencë dhe kulturë moderne.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Diktatura demokratike e popullit ka nevojë për udhëheqjen e klasës punëtore, sepse ajo është klasa më largpamëse e më vetëmohuese, klasa revolucionare më konsekuente. Gjithë historia e revolucionit provon se revolucioni dështon pa udhëheqjen e klasës punëtore, kurse nën udhëheqjen e saj ai triumfon.

«Mbi diktaturën demokratike të popullit» (30 qershor 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Baza e diktaturës demokratike të popullit është aleanca e klasës punëtore, fshatarësisë dhe borgjezisë së vogël të qytetit, dhe kryesisht aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, sepse këto dy klasa përfaqësojnë 80-90 përqind të popullsisë së Kinës. Këto dy klasa janë forcat kryesore

që përmbysën imperializmin dhe reaksionin e Gomindanit. Kalimi nga demokracia e re në socializëm varet kryesisht nga aleanca e këtyre dy klasave.

Po aty.

Lufta e klasave, lufta për prodhim dhe eksperimentimi shkencor janë tri lëvizjet e mëdha revolucionare për ndërtimin e një vendi socialist të fuqishëm. Ato përbëjnë një garanci të sigurtë që komunistët do të çlirohen nga burokratizmi, do të ruhen nga revizionizmi e dogmatizmi dhe do të qëndrojnë gjithmonë të pamposhtur, një garanci të sigurtë që proletariati do të mund të bashkohet me masat e gjera punonjëse dhe të ushtrojë diktaturën demokratike. Pa këto lëvizje çifligarët, kulakët, kundërrevolucionarët, elementët keqbërës dhe djajt e përbindëshat do të lejoheshin të dilnin në shesh, ndërsa kuadrot tona do të qëndronin indiferentë përpara kësaj gjendjeje dhe shumë prej tyre bile nuk do të bënin dallimin midis nesh dhe armiqve, por do të hynin në bashkëpunim me ta, do

të korruptoheshin, do të demoralizoheshin, do të përçaheshin dhe do të çthureshin prej tyre, do të binin në prehrin e armiqve, ose armiqtë do të depërtonin në radhët tona; edhe shumë nga punëtorët, fshatarët e intelektualët gjithashtu do të binin viktima të armikut, që vepron herë me përkëdhelje e herë me kërcënime. Po të ndodhte kështu, do të duhej jo shumë kohë, minimum disa vjet ose mbi dhjetë vjet, maksimum disa dhjetra vjet, që një restaurim kundërrevolucionar të bëhej i pashmangshëm në shkallë kombëtare, që partia marksiste-leniniste të shndërrohej patjetër në një parti revizioniste, në një parti fashiste dhe që gjithë Kina të ndryshonte ngjyrë.

Cituar në artikullin «Mbi pseudokomunizmin hrushovian dhe mësimet historike botërore që dalin prej tij» (14 korrik 1964).

Në ushtrimin e diktaturës demokratike të popullit përdoren dy metoda. Ndaj armiqve përdoret metoda e diktaturës. Kjo do të thotë se gjatë një periudhe, aq sa kjo

të jetë e nevojshme, ata nuk lejohen të marrin pjesë në aktivitete politike; ata detyrohen t'u nënshtrohen ligjeve të qeverisë popullore, të punojnë dhe në procesin e punës të riedukohen për t'u bërë njerëz të rinj. Përkundrazi, ndaj popullit përdoret jo metoda e detyrimit, por metoda demokratike. Kjo do të thotë se populli duhet të lihet të marrë pjesë në veprimtari politike, ai nuk duhet detyruar të bëjë këtë ose atë gjë, por, me anë të metodës demokratike, të bëhet me të një punë edukative dhe bindëse.

Fjala e mbylljes në sesionin e dytë të Komitetit të parë Kombëtar të Konferencës Konsultative Politike Popullore të Kinës (23 qershor 1950).

Populli kinez, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, po zhvillon një lëvizje të vrullshme për ndreqjen e stilit me qëllim që të çojë përpara me shpejtësi çështjen e socializmit në Kinë mbi një bazë akoma më të shëndoshë. Ky është një diskutim i gjerë popullor që zhvillohet në qytet e në

fshat, diskutim i drejtuar dhe i lirë, me fakte dhe argumenta mbi çështjet e dy rrugëve — rrugës socialiste dhe rrugës kapitaliste, të regjimit bazë dhe të masave politike të rëndësishme të shtetit, të stilit në punë të punonjësve të partisë e të shtetit, të mirëqenies së popullit etj., në mënyrë që të gjendet një zgjidhje e drejtë e kontradiktave të ndryshme që ekzistojnë efektivisht në gjirin e popullit dhe që tani kërkojnë zgjidhje. Kjo është një lëvizje socialiste, nëpërmjet së cilës populli edukon dhe riedukon vetvehten.

> «Fjala e mbajtur në sesionin jubilar të Sovjetit Suprem të BRSS me rastin e 40-vjetorit të Revolucionit të madh socialist të Tetorit» (6 nëndor 1957).

Puna e madhe ndërtimtare shtron para nesh detyra jashtëzakonisht të vështira. Megjithëse partia jonë ka në gjirin e saj më tepër se dhjetë milion anëtarë, ata prapë përfaqësojnë vetëm një pjesë shumë të vogël të popullsisë së vendit. Shumë punë në institucionet shtetërore dhe aktivi-

tete të ndryshme shoqërore duhet të kryhen nga njerëzit pa parti. Nëse nuk do të dimë të mbështetemi në masat popullore dhe të bashkëpunojmë me njerëzit pa parti, do të jetë e pamundur ta kryejmë mirë punën tonë. Ndërsa vazhdojmë të forcojmë unitetin e gjithë partisë, ne duhet të vazhdojmë gjithashtu të forcojmë unitetin e kombësive, të klasave demokratike, të partive demokratike dhe të organizatave popullore, të konsolidojmë dhe të zgjerojmë frontin tonë unik demokratik popullor; në çdo sektor pune duhet të ndreqim me kujdes çdo çfaqje negative që dëmton unitetin e partisë me popullin.

«Fjala e hapjes në Kongresin e 8-të të Partisë Komuniste të Kinës» (15 shtator 1956).

IV. TRAJTIMI I DREJTË I KONTRADIKTAVE NË GJIRIN E POPULLIT

Para nesh ndodhen dy tipe kontradiktash shoqërore: kontradiktat midis nesh e armiqve dhe kontradiktat në gjirin e popullit. Këto janë dy tipe kontradiktash krejt të ndryshme nga karakteri i tyre.

> «Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Për t'i kuptuar drejt këto dy tipe kontradiktash — kontradiktat midis nesh e armiqve dhe kontradiktat në gjirin e popullit, para së gjithash duhet të kuptojmë se ç'është "populli" dhe ç'janë "armiqtë". . . . Në etapën e tanishme, në periudhën e

ndërtimit të socializmit, popullin e përbëjnë të gjitha klasat, shtresat dhe grupet shoqërore që aprovojnë dhe përkrahin çështjen e ndërtimit socialist dhe marrin pjesë në të, ndërsa armiq të popullit janë të gjitha ato forca dhe grupe shoqërore, të cilat kundërshtojnë revolucionin socialist, mbajnë qëndrim armiqësor kundrejt ndërtimit socialist dhe e minojnë atë.

Po aty.

Në kushtet e tanishme të vendit tonë, kontradiktat në gjirin e popullit përfshijnë në vetvehte: kontradiktat në gjirin e klasës punëtore, kontradiktat në gjirin e fshatarësisë, kontradiktat në gjirin e inteligjencies, kontradiktat midis klasës punëtore dhe fshatarësisë, kontradiktat midis klasës punëtore e fshatarësisë, nga njëra anë, dhe inteligjencies, nga ana tjetër, kontradiktat midis klasës punëtore e punonjësve të tjerë, nga njëra anë, dhe borgjezisë kombëtare, nga ana tjetër, kontradiktat në gjirin e borgjezisë kombëtare etj. Qeveria jonë popullore është një qeveri që përfaqëson

me të vërtetë interesat e popullit dhe i shërben popullit, por edhe midis saj dhe masave popullore ka disa kontradikta. Këto kontradikta përfshijnë në vetvehte kontradiktat midis interesave të shtetit, interesave të kolektivit dhe interesave të individit, midis demokracisë dhe centralizmit, midis udhëheqësve dhe të udhëhequrve, midis disa punonjësve të institucioneve shtetërore, që vuajnë nga stili burokratik në punë, dhe masave. Edhe këto kontradikta janë kontradikta në gjirin e popullit. Në përgjithësi, kontradiktat në gjirin e popullit janë kontradikta që mbështeten në bashkësinë themelore të interesave të popullit.

Po aty.

Kontradiktat midis nesh dhe armiqve janë kontradikta antagoniste. Kontradiktat në gjirin e popullit, po të flasim për kontradiktat midis punonjësve, janë joantagoniste, ndërsa po të flasim për kontradiktat midis klasës së shfrytëzuar dhe klasës shfry-

tëzuese, përveç anës antagoniste, ato kanë edhe anën joantagoniste.

Po aty.

Si të përcaktojmë në kuadrin e jetës politike të popullit tonë, nëse fjalët dhe veprimet tona janë të drejta apo të gabuara? Ne jemi të mendimit se në bazë të parimeve të Kushtetutës së shtetit tonë, në bazë të vullnetit të shumicës absolute të popullit tonë dhe të platformës politike të përbashkët, të shpallur më se një herë nga të gjitha partitë dhe grupet politike të vendit tonë, në vija të përgjithshme mund të përcaktojmë kriteret e mëposhtme:

1) Fjalët dhe veprimet duhet të ndihmojnë në bashkimin e popullit prej shumë kombësish të vendit tonë, dhe jo të mbjellin përçarje në gjirin e tij;

2) të ndihmojnë në transformimet socialiste dhe ndërtimin socialist, dhe jo t'i pengojnë ato;

3) të ndihmojnë në forcimin e diktaturës demokratike të popullit, dhe jo

ta minojnë ose ta dobësojnë këtë diktaturë;

4) të ndihmojnë në forcimin e centralizmit demokratik, dhe jo ta minojnë ose ta dobësojnë atë;

5) të ndihmojnë në forcimin e udhëheqjes së Partisë Komuniste, dhe jo të çojnë drejt shkëputjes nga kjo udhëheqje ose drejt dobësimit të saj;

6) të ndihmojnë solidaritetin socialist ndërkombëtar, solidaritetin ndërkombëtar të popujve paqedashës të mbarë botës, dhe jo ta dëmtojnë këtë solidaritet.

Nga të gjashtë kriteret e mësipërme, më të rëndësishmet janë rruga socialiste dhe udhëheqja e partisë.

Po aty.

Lufta për likuidimin e kundërrevolucionarëve është një luftë që ka të bëjë me kontradiktat midis nesh e armiqve. Në gjirin e popullit ka disa njerëz, të cilët e shikojnë deri diku ndryshe çështjen e likuidimit të kundërrevolucionarëve. Ka dy

kategori njerëzish, pikëpamjet e të cilëve ndryshojnë nga tonat. Njerëzit që kanë mendime të deviacionit të djathtë, nuk bëjnë dallim midis nesh e armiqve dhe i marrin armiqtë për njerëzit tanë. Këta njerëz i quajnë miq ata që masat e gjera i quajnë armiq. Njerëzit që kanë mendime të deviacionit "të majtë", e zgjerojnë kuadrin e kontradiktave midis nesh e armiqve, bile disa kontradikta në gjirin e popullit i shohin si kontradikta midis nesh e armiqve; disa njerëz, që në të vërtetë nuk janë kundërrevolucionarë, ata i marrin për kundërrevolucionarë. Që të dyja këto pikëpamje janë të gabuara; ato nuk lejojnë as të zgjidhet drejt çështja e likuidimit të kundërrevolucionarëve, as t'i bëhet një vlerësim i drejtë punës sonë në këtë drejtim.

Po aty.

Kontradiktat e ndryshme në cilësi mund të zgjidhen vetëm me metoda të ndryshme në cilësi. Për shembull, kontradikta midis

proletariatit dhe borgjezisë zgjidhet me metodën e revolucionit socialist; kontradikta midis masave popullore dhe rendit feudal zgjidhet me metodën e revolucionit demokratik; kontradikta midis kolonive dhe imperializmit zgjidhet me metodën e luftës nacional-revolucionare; kontradikta midis klasës punëtore dhe fshatarësisë në shoqërinë socialiste zgjidhet me metodën e kolektivizimit dhe mekanizimit të bujqësisë; kontradikta në gjirin e partisë komuniste zgjidhet me metodën e kritikës dhe autokritikës; kontradikta midis shoqërisë dhe natyrës zgjidhet me metodën e zhvillimit të forcave prodhuese. . . . Zgjidhja e kontradiktave të ndryshme me metoda të ndryshme është një parim, të cilin marksistë-leninistët duhet ta respektojnë në mënyrë rigoroze.

«Mbi kontradiktën» (gusht 1937),
Vepra të zgjedhura, vëll. 2.

Meqë kontradiktat midis nesh e armiqve dhe kontradiktat në gjirin e popullit kanë karakter të ndryshëm, edhe metodat e

zgjidhjes së tyre janë gjithashtu të ndryshme. Shkurt, tipi i parë i kontradiktave ka të bëjë me çështjen e dallimit të qartë midis nesh dhe armiqve, kurse tipi i dytë ka të bëjë me çështjen e dallimit të qartë midis asaj që është e drejtë dhe asaj që është e padrejtë. Sigurisht, edhe dallimi midis nesh e armiqve është një çështje e së drejtës dhe të padrejtës. Për shembull, çështja se kush në fund të fundit ka të drejtë e kush nuk ka të drejtë — ne apo reaksionarët e brendshëm dhe të jashtëm, imperialistët, feudalët e kapitalistët burokratë — është gjithashtu një çështje e së drejtës dhe të padrejtës, por nga karakteri i saj ajo i përket një tipi tjetër çështjesh të së drejtës dhe të padrejtës, që ndryshon nga çështjet në gjirin e popullit.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Të gjitha çështjet me karakter ideologjik, të gjitha çështjet në gjirin e popullit, rreth të cilave ka rrahje mendimesh, mund të zgjidhen vetëm me anë të metodave demokratike, të metodave të diskutimit, kritikës,

bindjes dhe edukimit; ato nuk mund të zgjidhen me anën e metodave të detyrimit dhe të nënshtrimit.

Po aty.

Që të mund të prodhojë e të mësojë në mënyrë të efektshme dhe të bëjë një jetë të rregullt, populli kërkon nga qeveria e tij, nga drejtuesit e prodhimit dhe drejtuesit e organeve kulturalo-arësimore që ata të nxjerrin urdhëresa të përshtatshme administrative me karakter të detyrueshëm. Pa këto urdhëresa administrative është e pamundur të ruhet rendi publik, dhe këtë e kupton edhe njeriu me njohuritë më elementare. Urdhëresat administrative dhe metodat e bindjes e të edukimit, që zbatohen për zgjidhjen e kontradiktave në gjirin e popullit, janë dy anë që plotësojnë njëra tjetrën. Urdhëresat administrative, që nxirren për ruajtjen e rendit publik, duhet gjithashtu të shoqërohen me punë bindëse dhe edukative; në shumë raste mbështetja vetëm në urdhëresat administrative është e paefektshme.

Po aty.

Borgjezia dhe mikroborgjezia do të pasqyrojnë patjetër ideologjinë e tyre. Ato medoemos do të çfaqen me këmbëngulje dhe me të gjitha mënyrat në çështjet politike dhe ideologjike. Është e pamundur që ato të veprojnë ndryshe. Ne nuk duhet të përdorim metodat e presionit për të ndaluar çfaqjen e tyre, por duhet ta lejojmë atë dhe njëkohësisht, kur ato çfaqen, duhet të zhvillojmë diskutime me to dhe t'u bëjmë kritikën e duhur. S'ka dyshim se ne duhet t'i kritikojmë të gjitha idetë e gabuara. Sigurisht, nuk lejohet të mos i kritikojmë këto ide, t'i lëmë të përhapen kudo dhe të pushtojnë "tregun". Nëse ka gabime, ato duhen kritikuar; nëse dalin barëra helmuese, ato duhen luftuar. Megjithatë kjo kritikë nuk duhet të jetë dogmatike, këtu nuk duhen përdorur metodat metafizike, por duhen bërë përpjekje për të përdorur metodat dialektike. Kritika duhet të mbështetet në një analizë shkencore dhe të jetë plotësisht bindëse.

Po aty.

Të metat e popullit duhen kritikuar, . . . por kjo duhet bërë duke qëndruar me të vërtetë në pozitat e popullit dhe duke u frymëzuar nga ndjenja e zjarrtë për të mbrojtur dhe edukuar popullin. Të sillesh me shokun si me armikun, do të thotë të vihesh në pozitat e armikut.

> «Fjalime të mbajtura në mbledhjen e Jenanit mbi çështjet e letërsisë dhe të artit» (maj 1942), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Kontradiktat dhe lufta janë të përgjithshme, absolute, kurse metodat për zgjidhjen e kontradiktave, domethënë format e luftës, ndryshojnë sipas karakterit të këtyre kontradiktave. Disa kontradikta kanë karakterin e një antagonizmi të hapët, disa të tjera jo. Sipas zhvillimit konkret të sendeve dhe fenomeneve, disa kontradikta, të cilat në fillim janë joantagoniste, shndërrohen në kontradikta antagoniste, kurse disa të tjera, të cilat në fillim janë antago-

niste, shndërrohen në kontradikta joantagoniste.

«Mbi kontradiktën» (gusht 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Në kushte të zakonshme, kontradiktat në gjirin e popullit nuk janë antagoniste. Mirëpo po të mos trajtohen drejt ato ose po të humbasë vigjilenca dhe të tregohet pakujdesi e moskokëçarje, mund të lindë edhe antagonizmi. Në vendet socialiste një fenomen i tillë zakonisht është i pjesshëm dhe i përkohshëm. Kjo shpjegohet me faktin se në vendet socialiste është zhdukur sistemi i shfrytëzimit të njeriut nga njeriu dhe interesat e popullit në themel janë të përbashkëta.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Në vendin tonë, kontradiktat midis klasës punëtore dhe borgjezisë kombëtare hyjnë në kontradiktat në gjirin e popullit. Lufta klasore midis klasës punëtore dhe

borgjezisë kombëtare hyn, në përgjithësi, në kategorinë e luftës klasore në gjirin e popullit, sepse në vendin tonë borgjezia kombëtare ka një karakter të dyfishtë. Në periudhën e revolucionit demokratik borgjez ajo, nga njëra anë, kishte karakter revolucionar, kurse, nga ana tjetër, kishte prirje për kompromis. Në periudhën e revolucionit socialist ajo, nga njëra anë, shfrytëzon klasën punëtore dhe nxjerr kështu fitime, kurse, nga ana tjetër, përkrah Kushtetutën dhe tregohet e gatshme të pranojë transformimet socialiste. Borgjezia kombëtare ndryshon nga imperialistët, klasa çifligare dhe borgjezia burokratike. Kontradiktat midis klasës punëtore dhe borgjezisë kombëtare janë kontradikta midis të shfrytëzuarve dhe shfrytëzuesve, të cilat në vetvehte janë antagoniste. Megjithatë, në kushtet konkrete të vendit tonë, kontradiktat antagoniste midis këtyre dy klasave, po të trajtohen drejt, mund të shndërrohen në kontradikta joantagoniste dhe mund të zgjidhen me metoda paqësore. Nëse këto kontradikta nuk do t'i trajtojmë drejt, domethënë në qoftë se nuk do të zbatojmë

kundrejt borgjezisë kombëtare politikën e bashkimit, kritikës dhe edukimit, ose në qoftë se borgjezia kombëtare nuk do ta pranojë këtë politikë, atëherë kontradiktat midis klasës punëtore dhe borgjezisë kombëtare mund të shndërrohen në kontradikta midis nesh dhe armiqve.

Po aty.

Reaksionarët brenda një vendi socialist, në bashkëpunim me imperialistët, duke shfrytëzuar kontradiktat në gjirin e popullit, mbjellin përçarje dhe nxisin trazira për të realizuar planet e tyre djallëzore. Ky mësim, i nxjerrë nga ngjarjet në Hungari, meriton vëmendjen e përgjithshme.

Po aty.

V. LUFTA DHE PAQA

Lufta e armatosur, e cila ka filluar që me lindjen e pronës private dhe të klasave, është forma më e lartë e luftës për të zgjidhur kontradiktat, në një etapë të caktuar të zhvillimit të tyre, midis klasave, midis kombeve, midis shteteve ose grupeve politike.

«Çështje të strategjisë së luftës revolucionare në Kinë» (dhjetor 1936), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

"Lufta është vazhdim i politikës". Në këtë kuptim, lufta është politikë; vetë lufta është një veprim me karakter politik, dhe qysh prej kohëve më të lashta s'ka pasur luftë që të mos ketë pasur karakter politik. . . .

Por lufta ka edhe veçoritë e veta specifike. Në këtë kuptim, lufta nuk është

identike me politikën në përgjithësi. "Lufta është vazhdim i politikës me mjete të tjera". Kur politika arrin në një fazë të caktuar zhvillimi, në të cilën ajo nuk është më në gjendje të zhvillohet si më parë, shpërthen lufta për të hequr pengesat në rrugën e politikës. . . . Kur të jenë hequr këto pengesa dhe të jetë arritur qëllimi politik, lufta merr fund. Derisa këto pengesa të mos jenë hequr krejtësisht, lufta duhet vazhduar gjer në arritjen e qëllimit të saj. . . . Prandaj mund të thuhet se politika është një luftë pa gjakderdhje, kurse lufta është një politikë me gjakderdhje.

«Mbi luftën e gjatë» (maj 1938),
Vepra të zgjedhura, vëll. 2.

Të gjitha luftërat në histori ndahen në dy lloje: në të drejta dhe në të padrejta. Të gjitha luftërat përparimtare janë të drejta, ndërsa të gjitha luftërat që e pengojnë përparimin janë të padrejta. Ne, komunistët, luftojmë kundër të gjitha luftërave të padrejta që e pengojnë përparimin, por ne nuk jemi kundër luftërave

përparimtare, të drejta. Ne, komunistët, jo vetëm nuk jemi kundër luftërave të drejta, por edhe marrim pjesë aktive në to. Përsa u përket luftërave të padrejta, një shembull i tillë ishte lufta e parë botërore, në të cilën të dyja palët luftonin për interesat imperialiste, prandaj komunistët e gjithë botës luftuan me vendosmëri kundër kësaj lufte. Rruga e kundërshtimit të luftës së këtij lloji është kjo: para se të shpërthejë lufta, të përpiqemi me të gjitha forcat ta ndalojmë atë, kur ajo ka shpërthyer, ta kundërshtojmë me sa është e mundur me luftë, të dalim kundër luftës së padrejtë me luftë të drejtë.

Po aty.

Në shoqërinë me klasa, revolucionet dhe luftërat revolucionare janë të pashmangshme; pa to është e pamundur të bëhet një hop në zhvillimin e shoqërisë, është e pamundur të përmbysen klasat sunduese reaksionare, në mënyrë që populli të marrë pushtetin në duart e tij.

«Mbi kontradiktën» (gusht 1937),
Vepra të zgjedhura, vëll. 2.

Lufta revolucionare shërben si një lloj kundërhelmi, i cili jo vetëm do të zhdukë helmin e armikut, por edhe do të spastrojë radhët tona nga ndyrësitë. Çdo luftë e drejtë, revolucionare përbën një forcë shumë të madhe dhe mund të bëjë shumë transformime ose t'u hapë rrugën këtyre transformimeve. Lufta kino-japoneze do të transformojë edhe Kinën edhe Japoninë. Gjersa Kina të vazhdojë me këmbëngulje Luftën e Rezistencës dhe të ndjekë me konsekuencë politikën e frontit unik, Japonia e vjetër do të shndërrohet patjetër në një Japoni të re, ndërsa Kina e vjetër në një Kinë të re. Si në Kinë ashtu dhe në Japoni, njerëzit dhe sendet do të transformohen gjatë kësaj lufte dhe pas saj.

«Mbi luftën e gjatë» (maj 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Çdo komunist duhet të kuptojë të vërtetën që "pushteti lind nga gryka e pushkës".

«Lufta dhe çështjet e strategjisë» (6 nëndor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Detyra qendrore e revolucionit dhe forma më e lartë e tij është marrja e pushtetit me forcë të armatosur, zgjidhja e problemit me luftë. Ky parim revolucionar i marksizëm-leninizmit është i drejtë kudo, është i drejtë si për Kinën ashtu edhe për vendet e tjera.

Po aty.

Në Kinë pa luftën e armatosur as proletariati, as populli, as Partia Komuniste nuk do të zënë vendin që u takon dhe as revolucioni nuk do të fitojë. Zhvillimi, forcimi dhe bolshevizimi i partisë sonë gjatë tetëmbëdhjetë vjetëve janë bërë në procesin e luftërave revolucionare; pa një luftë të armatosur nuk do të kishim as Partinë Komuniste që kemi sot. Shokët në gjithë partinë kurrë nuk duhet ta harrojnë këtë eksperiencë të paguar me gjak.

«Me rastin e daljes së numrit të parë të revistës "Komunisti"» (4 tetor 1939), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 3.

Nga pikëpamja e teorisë marksiste mbi shtetin, ushtria është pjesa përbërëse kryesore e pushtetit shtetëror. Kush dëshiron të marrë pushtetin shtetëror dhe ta mbajë atë, duhet të ketë një ushtri të fuqishme. Disa njerëz tallen me ne duke na quajtur përkrahës të "teorisë së plotfuqishmërisë së luftës". Po, ne jemi përkrahës të teorisë së plotfuqishmërisë së luftës revolucionare. Kjo nuk është e keqe, por e mirë, është marksiste. Pushkët e komunistëve rusë vendosën socializmin. Ne do të krijojmë një republikë demokratike. Përvoja e luftës së klasave në epokën e imperializmit na tregon se klasa punëtore dhe masat punonjëse vetëm me forcën e pushkëve mund të fitojnë mbi borgjezinë dhe çifligarët e armatosur. Në këtë kuptim, ne mund të themi se gjithë bota mund të transformohet vetëm me anën e pushkëve.

«Lufta dhe çështjet e strategjisë» (6 nëndor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Ne jemi përkrahës të teorisë së zhdukjes së luftërave, ne nuk duam luftë. Por lufta

mund të zhduket vetëm me anë të luftës. Që të mos ketë pushkë, duhet rrokur pushka.

Po aty.

Zhvillimi i shoqërisë njerëzore do të shpjerë më në fund, dhe bile në një të ardhme jo të largët, në zhdukjen e luftës, të këtij përbindëshi që çon në masakrimin reciprok të njerëzve. Por për të zhdukur luftën, ka vetëm një rrugë: të bëhet luftë kundër luftës, të bëhet luftë revolucionare kundër luftës kundërrevolucionare, luftë kombëtare revolucionare kundër luftës kombëtare kundërrevolucionare, luftë klasore revolucionare kundër luftës klasore kundërrevolucionare. . . . Kur shoqëria njerëzore, me zhvillimin e saj, do të arrijë në zhdukjen e klasave, në zhdukjen e shtetit, atëherë nuk do të ketë më kurrfarë luftërash — as kundërrevolucionare, as revolucionare, as të padrejta, as të drejta. Kjo do të jetë epoka e paqes së përjetshme për njerëzimin. Duke studiuar ligjet e luftës revolucionare, ne nisemi nga dëshira për të zhdukur të gjitha luftërat. Kjo

është vija e demarkacionit midis nesh, komunistëve, dhe të gjitha klasave shfrytëzuese.

«Çështje të strategjisë së luftës revolucionare në Kinë» (dhjetor 1936), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Vendi ynë dhe vendet e tjera socialiste kanë nevojë për paqe, popujt e mbarë botës gjithashtu. Vetëm disa grupe monopoliste në një numër të vogël vendesh imperialiste, që pasurohen me anë të agresionit, kanë etje për luftë dhe nuk duan paqe.

«Fjala e hapjes në Kongresin e 8-të të Partisë Komuniste të Kinës» (15 shtator 1956).

Për të siguruar një paqe të qëndrueshme në botë, ne duhet të zhvillojmë më tej miqësinë e bashkëpunimin me vendet vëllezër të kampit socialist dhe të forcojmë solidaritetin tonë me të gjitha vendet paqedashëse. Ne duhet të përpiqemi të vendosim me të gjitha vendet, që dëshirojnë të jetojnë në paqe me ne, marrëdhënie

diplomatike normale mbi bazën e respektimit reciprok të integritetit tokësor dhe sovranitetit, të barazisë dhe përfitimit reciprok. Ne duhet t'u japim një përkrahje aktive lëvizjeve për pavarësinë dhe çlirimin kombëtar në vendet e Azisë, Afrikës dhe Amerikës Latine, lëvizjeve për paqe dhe luftërave të drejta në të gjitha vendet e botës.

Po aty.

Përsa u përket vendeve imperialiste, ne duhet gjithashtu të bashkohemi me popujt e tyre dhe të përpiqemi për bashkekzistencën paqësore dhe për një farë tregëtie me këto vende, të ndalojmë një luftë të mundshme. Por kundrejt këtyre vendeve, ne në asnjë mënyrë nuk duhet të kemi mendime që nuk i përgjigjen realitetit.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Ne duam paqe. Por në qoftë se imperializmi ngul këmbë për luftë, ne nuk kemi

rrugë tjetër veçse të marrim vendim të prerë për të luftuar, e pastaj t'i vihemi ndërtimit. Në qoftë se çdo ditë ke frikë nga lufta dhe lufta më në fund vjen, atëherë çfarë do të bësh? Më lart unë thashë se era e Lindjes sundon mbi erën e Perëndimit dhe se lufta mund të mos shpërthejë, dhe tani unë shtova këto shpjegime rreth gjendjes që mund të krijohet në rast se shpërthen lufta. Në këtë mënyrë janë marrë parasysh të dyja mundësitë.

> Fjala e mbajtur në Mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore në Moskë (18 nëndor 1957), marrë nga «Deklarata e zëdhënësit të Qeverisë Kineze», botuar në gazetën *Zhenminzhibao* (1 shtator 1963).

Sot, në të gjitha vendet e botës, njerëzit diskutojnë nëse do të shpërthejë ose jo një luftë e tretë botërore. Ne duhet të jemi të pregatitur moralisht lidhur me këtë çështje dhe ta analizojmë atë. Ne jemi vendosmërisht për paqe dhe kundër luftës. Por edhe në qoftë se imperialistët ngulin

këmbë për shpërthimin e luftës, ne nuk duhet të kemi frikë. Qëndrimi ynë në këtë çështje është i njëllojtë me qëndrimin tonë kundrejt të gjitha "turbullirave": së pari, jemi kundër; së dyti, nuk kemi frikë. Pas luftës së parë botërore lindi Bashkimi Sovjetik me një popullsi prej 200 milionësh. Pas luftës së dytë botërore lindi kampi socialist me një popullsi prej 900 milionësh. Në qoftë se imperialistët do të shpërthejnë luftën e tretë botërore, ne mund të themi në mënyrë të prerë se, si rezultat i saj, me siguri disa qindra miliona njerëz të tjerë do të kalojnë në anën e socializmit; imperializmit nuk do t'i mbeten shumë territore, bile ka mundësi të shembet plotësisht gjithë sistemi imperialist.

> «Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Provoko trazira, dështo, provoko prapë, prapë dështo, dhe kjo deri në shkatërrimin e tyre, — ja cila është llogjika e imperialistëve dhe e të gjithë reaksionarëve të botës kundrejt çështjes së popullit, dhe asnjëherë

ata nuk do të ecin kundër kësaj llogjike. Ky është një ligj marksist. Kur ne themi "imperializmi është shumë i egër", me këtë ne kuptojmë se natyra e tij nuk do të ndryshojë dhe se imperialistët nuk do të duan kurrë ta lënë thikën e kasapit, as do të bëhen kurrë buda, dhe kjo deri në vdekjen e tyre.

Luftë, disfatë, prapë luftë, prapë disfatë, por prapë luftë dhe kjo deri në fitore, — ja cila është llogjika e popullit, por edhe ai nuk do të ecë kurrë kundër kësaj llogjike. Edhe ky është një ligj marksist. Revolucioni i popullit rus ndoqi këtë ligj, këtë ligj ndjek edhe revolucioni i popullit kinez.

«Flakni iluzionet dhe pregatituni për luftë» (14 gusht 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Fitorja në asnjë mënyrë nuk duhet të na bëjë të dobësojmë vigjilencën kundrejt komplloteve të çmendura hakmarrëse të imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre. Kushdo që do të dobësojë vigjilencën, do

të gjendet i çarmatosur politikisht dhe do ta vërë vehten në një pozitë pasive.

> «Fjalim i mbajtur në Komitetin pregatitor të Konferencës së Re Konsultative Politike» (15 qershor 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, reaksionarët kinezë, nuk do të pajtohen me disfatën e tyre në tokën kineze. Ata do të vazhdojnë bashkëpunimin midis tyre për të luftuar kundër popullit kinez me të gjitha mjetet e mundshme. Për shembull, ata do të dërgojnë agjentët e tyre në Kinë për të mbjellë përçarje dhe për të shkaktuar turbullira. Kjo është e natyrshme; ata nuk do të heqin dorë kurrë nga kjo veprimtari. Ose një shembull tjetër, imperialistët do t'i shtyjnë reaksionarët kinezë dhe bile do të përdorin forcat e veta për të bllokuar portet detare të Kinës. Këtë ata do ta bëjnë aq sa të kenë mundësi. Përveç kësaj, në qoftë se kanë akoma etje për aventura, ata do të dërgojnë trupa për të kryer akte agresive dhe provokuese në krahinat kufitare të Kinës; edhe kjo mundësi nuk

përjashtohet. Të gjitha këto ne duhet t'i kemi parasysh plotësisht.

Po aty.

Bota ecën përpara, e ardhmja është e ndritur, askush nuk mund ta ndryshojë këtë rrjedhë të përgjithshme të historisë. Ne duhet t'i bëjmë vazhdimisht të njohura popullit përparimet e botës dhe t'i tregojmë për të ardhmen e ndritur, me qëllim që atij t'i ngjallet besimi në fitore.

«Mbi bisedimet e Çuncinit» (17 tetor 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Të gjithë komandantët dhe luftëtarët e Ushtrisë Popullore Çlirimtare, në asnjë mënyrë nuk duhet ta dobësojnë sado pak vullnetin e tyre luftarak; çdo mendim, që çon në dobësimin e vullnetit luftarak dhe në nënvleftësimin e armikut, është i gabuar.

«Raport në plenumin e dytë të Komitetit Qendror të zgjedhur nga Kongresi i 7-të i Partisë Komuniste të Kinës» (5 mars 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

VI. IMPERIALIZMI DHE TË GJITHË REAKSIONARËT JANË TIGRA PREJ LETRE

Të gjithë reaksionarët janë tigra prej letre. Në dukje ata janë të tmerrshëm, por në realitet nuk kanë ndonjë forcë të madhe. Po t'i marrim çështjet nga pikëpamja e perspektivës, nuk janë reaksionarët ata që kanë forcë të madhe, por është populli.

«Bisedë me gazetaren amerikane Ana Luiza Strong» (gusht 1946), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Sikundër në botë nuk ka asnjë send që të mos ketë natyrë të dyfishtë (ky është ligji i unitetit të të kundërtave), ashtu edhe imperializmi dhe të gjithë reaksionarët

kanë natyrë të dyfishtë. Ata janë tigra të vërtetë dhe në të njëjtën kohë tigra prej letre. Në të kaluarën historike klasa e skllavopronarëve, klasa çifligare feudale dhe borgjezia, para marrjes së pushtetit dhe disa kohë pas saj ishin plot gjallëri, revolucionare e përparimtare, ishin tigra të vërtetë. Por në periudhën e mëvonshme, meqë antagonistët e tyre — klasa e skllevërve, fshatarësia dhe proletariati — po rriteshin hap pas hapi dhe po hynin në luftë kundër tyre, në një luftë gjithnjë më të ashpër, këto klasa sunduese u shndërruan pak nga pak në të kundërtën e tyre, u bënë reaksionare, të prapambetura, u bënë tigra prej letre. Dhe, më në fund, ato u përmbysën ose do të përmbysen nga populli. Edhe në luftën për jetë a vdekje që bënte populli kundër tyre, këto klasa reaksionare, të prapambetura, të kalbura kishin akoma këtë natyrë të dyfishtë. Në një kuptim, ato ishin tigra të vërtetë që gllabëronin njerëz, gllabëronin me miliona e dhjetra miliona. Lufta e popullit ishte duke

kaluar një periudhë vështirësish e pengesash, rruga e saj ishte plot kthesa e zigzage. Popullit kinez iu desh t'i kushtonte më shumë se njëqind vjet luftës për përmbysjen e sundimit të imperializmit, feudalizmit dhe kapitalizmit burokratik në Kinë, të jepte me dhjetra miliona jeta njerëzish, para se të arrinte fitoren e vitit 1949. Shikoni, a nuk ishin tigra të gjallë, tigra prej hekuri, tigra të vërtetë? Por, në fund të fundit, ata u bënë tigra prej letre, tigra të ngordhur, tigra prej djathi soje. Këto janë fakte historike. A nuk i kemi parë këto me sytë tanë, a nuk kemi dëgjuar të flitet për to? Në të vërtetë këto raste numërohen me mijëra e dhjetra mijëra! Mijëra e dhjetra mijëra! Pra, duke i parë në thelbin e tyre, nga pikëpamja e perspektivës dhe nën prizmin strategjik, imperializmi dhe të gjithë reaksionarët duhet të merren për atë që janë: tigra prej letre. Këtu mbështetet mendimi ynë strategjik. Nga ana tjetër, ata janë tigra të gjallë, tigra prej hekuri, tigra të vërtetë, ata gllabërojnë

njerëz. Këtu mbështetet mendimi ynë taktik.

> «Fjala në mbledhjen e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, mbajtur në Vuçan» (1 dhjetor 1958). Cituar nga shënimi shpjegues mbi «Bisedën me gazetaren amerikane Ana Luiza Strong», *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Unë kam thënë se të gjithë reaksionarët, të vetëquajtur të fuqishëm, nuk janë veçse tigra prej letre. Arësyeja është se ata janë të shkëputur nga populli. Shikoni, a nuk ishte Hitleri një tigër prej letre? A nuk u përmbys Hitleri? Unë kam thënë gjithashtu se cari rus ishte tigër prej letre, perandori kinez dhe imperializmi japonez ishin gjithashtu tigra prej letre. Ju e shikoni se ata janë përmbysur që të gjithë. Imperializmi amerikan nuk është përmbysur, ai ka edhe bombën atomike. Unë mendoj se

ai gjithashtu do të përmbyset, edhe ai është tigër prej letre.

Fjala e mbajtur në Mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore në Moskë (18 nëndor 1957).

"Ngre një gur për të goditur këmbët e veta", thotë një proverb kinez për të cilësuar veprimin e disa budallenjve. Reaksionarët e të gjitha vendeve janë pikërisht budallenj të tillë. Persekutimet e të gjitha llojeve që ata u bëjnë popujve revolucionarë, në fund të fundit, nuk munden veçse t'i shtyjnë popujt të zgjerojnë dhe të intensifikojnë edhe më shumë revolucionin. Mos vallë persekutimet e ndryshme të bëra nga cari rus dhe nga Çan Kaj-shiu kundër popujve revolucionarë nuk ushtruan pikërisht një rol të tillë nxitës për revolucionet e mëdha në Rusi dhe Kinë?

«Fjala e mbajtur në sesionin jubilar të Sovjetit Suprem të BRSS me rastin e 40-vjetorit të Revolucionit të madh socialist të Tetorit» (6 nëndor 1957).

Imperializmi amerikan ka invaduar dhe mban të pushtuar qysh prej nëntë vjetësh tokën tonë, Tajvanin, dhe pak kohë më parë ai dërgoi forcat e tij të armatosura për të invaduar dhe pushtuar Libanin. Shtetet e Bashkuara kanë krijuar qindra baza ushtarake në shumë vende të botës. Toka kineze e Tajvanit, Libani dhe të gjitha bazat ushtarake amerikane në tokat e huaja janë leqe të hedhura në grykën e imperializmit amerikan. Këto leqe i kanë pregatitur vetë amerikanët e askush tjetër, dhe ata vetë i vunë në grykën e tyre dhe ia dorëzuan njërën anë të litarit popullit kinez, popujve të vendeve arabe dhe të gjithë popujve të botës që duan paqen e luftojnë kundër agresionit. Sa më gjatë që agresorët amerikanë të qëndrojnë në këto vende, aq më shumë do të shtrëngohen leqet në grykën e tyre.

Fjalim i mbajtur në Konferencën e Lartë Shtetërore (8 shtator 1958).

Imperialistët nuk do ta kenë të gjatë, sepse ata bëjnë vetëm gjëra të këqia, përkrahin me të gjitha mënyrat klikat reaksionare antipopullore në vende të ndryshme, kanë pushtuar me forcë një numër të madh kolonish dhe gjysmëkolonish, kanë krijuar një numër të madh bazash ushtarake dhe kërcënojnë paqen me luftë atomike. Kështu ata detyrojnë më se 90 përqind të popullsisë së botës të ngrihet në masë tani ose në të ardhmen kundër tyre. Por imperialistët sot janë akoma të gjallë dhe vazhdojnë të sillen në mënyrë arrogante dhe arbitrare në Azi, Afrikë dhe në Amerikën Latine. Në botën perëndimore ata vazhdojnë akoma të shtypin masat popullore të vendeve të tyre. Kjo gjendje duhet ndryshuar. T'i jepet fund agresionit dhe shtypjes nga ana e imperializmit, në radhë të parë nga ana e imperializmit amerikan, — kjo është detyra e popujve të mbarë botës.

Intervistë e dhënë korespondentit të Agjensisë Sinhua (29 shtator 1958).

Imperializmi amerikan, duke u sjellë kudo në mënyrë arrogante dhe arbitrare, e vë vehten në një pozitë armiqësore me popujt e mbarë botës dhe po izolohet gjithnjë e më shumë. Bombat atomike dhe me hidrogjen në duart e imperializmit amerikan, s'i trembin dot ata që nuk pranojnë të jenë skllevër. Vala e zemërimit të popujve të mbarë botës kundër agresorëve amerikanë është e pandalshme. Lufta e popujve të mbarë botës kundër imperializmit amerikan dhe shërbëtorëve të tij do të arrijë patjetër fitore akoma më të mëdha.

«Deklaratë në përkrahje të luftës së drejtë patriotike të popullit panamez kundër imperializmit amerikan» (12 janar 1964).

Në qoftë se grupet monopoliste të Shteteve të Bashkuara do të ngulin këmbë në zbatimin e politikës së tyre të agresionit dhe të luftës, me siguri do të vijë një ditë, kur popujt e mbarë botës do t'i dënojnë

ato me litar. Një fat i tillë i pret edhe bashkëpunëtorët e Shteteve të Bashkuara.

Fjalim i mbajtur në Konferencën e Lartë Shtetërore (8 shtator 1958).

Për të luftuar kundër armiqve, ne kemi formuar për një periudhë të gjatë këtë koncept: nga pikëpamja strategjike, ne duhet t'i përçmojmë të gjithë armiqtë, kurse nga pikëpamja taktike duhet t'i vlerësojmë seriozisht. Me fjalë të tjera, në tërësi ne duhet t'i përçmojmë patjetër armiqtë, por në çdo çështje konkrete duhet t'i vlerësojmë me gjithë seriozitetin. Po qe se në tërësi nuk i përçmojmë armiqtë, do të biem në gabime oportuniste. Marksi dhe Engelsi ishin vetëm dy veta dhe qysh atëherë ata deklaruan se kapitalizmi do të përmbyset në gjithë botën. Por në qoftë se nuk i vlerësojmë seriozisht armiqtë në çështje konkrete dhe në çështjet që i përkasin çdo armiku në veçanti, ne do të biem në gabime aventuriste. Betejat mund të zhvillohen vetëm një nga një, armiqtë

mund të shpartallohen vetëm pjesë-pjesë. Fabrikat mund të ndërtohen vetëm një nga një, fshatarët mund ta plugojnë tokën vetëm ngastër pas ngastre; edhe në të ngrënë është e njëjta gjë. Nga pikëpamja strategjike ne e "përçmojmë" gjellën: ne mund ta hamë të gjithë atë. Por veprimi konkret i të ngrënit bëhet kafshatë pas kafshate; nuk mund t'i gëlltisësh të gjitha gjellët e shtruara në tavolinë me një të shtënë në gojë. Kjo quhet zgjidhje e çështjeve veç e veç, në literaturën ushtarake kësaj i thonë t'i shkatërrosh armiqtë një nga një.

Fjala e mbajtur në Mbledhjen e përfaqësuesve të partive komuniste dhe punëtore në Moskë (18 nëndor 1957).

Unë mendoj se gjendja e tanishme ndërkombëtare ka arritur në një kthesë të re. Tani në botë ka dy erëra: era e Lindjes dhe era e Perëndimit. Një proverb kinez thotë: "Ose era e Lindjes do të sundojë mbi erën e Perëndimit, ose era e Perëndimit do të sundojë mbi erën e Lindjes". Unë mendoj se gjendja e tanishme karakterizo-

het nga fakti se era e Lindjes sundon mbi erën e Perëndimit, domethënë se forcat e socializmit kanë fituar një epërsi dërmuese mbi forcat e imperializmit.

Po aty.

VII. GUXIM PËR LUFTË, GUXIM PËR FITORE

Popuj të mbarë botës, bashkohuni për të mposhtur agresorët amerikanë dhe të gjithë shërbëtorët e tyre! Popujt e mbarë botës duhet të kenë kurajo, të guxojnë të luftojnë, të mos ua kenë frikën vështirësive, të çajnë përpara njëri pas tjetrit, dhe atëherë mbarë bota do t'u përkasë atyre. Të gjithë përbindëshat do të asgjësohen plotësisht.

«Deklaratë në përkrahje të popullit të Kongos (L) kundër agresionit amerikan» (28 nëndor 1964).

Pasi i bëri një vlerësim realist gjendjes ndërkombëtare dhe të brendshme në bazë të shkencës së marksizëm-leninizmit, Partia Komuniste e Kinës fitoi bindjen se të gjitha

sulmet e reaksionarëve të brendshëm e të jashtëm jo vetëm që duhet të shpartallohen, por edhe mund të shpartallohen. Që kur në qiell u dukën re të zeza, ne theksuam se ky nuk është veçse një fenomen i përkohshëm, se errësira do të zhduket sëshpejti dhe se agimi nuk është larg.

«Gjendja e sotme dhe detyrat tona» (25 dhjetor 1947), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Në historinë e njerëzimit çdo forcë reaksionare në agoni bën patjetër përpjekjet e fundit të dëshpëruara kundër forcave revolucionare; dhe shpesh disa revolucionarë për një kohë mashtrohen nga kjo forcë e madhe në dukje, por e dobët në brendi, dhe nuk janë në gjendje të shikojnë faktin esencial që armiku do të asgjësohet sëshpejti, ndërsa ata vetë janë në prag të fitores.

«Një çast kthese në zhvillimin e luftës së dytë botërore» (12 tetor 1942), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Në qoftë se ai (Gomindani) fillon luftën, ne do ta shpartallojmë plotësisht. Puna qëndron kështu: ai na sulmon, ne e shpartallojmë, dhe ai rehatohet. Kur shpartallohet pak, rehatohet pak; kur shpartallohet shumë, rehatohet shumë; kur shpartallohet përfundimisht, rehatohet përfundimisht. Problemet e Kinës janë të ndërlikuara, pra edhe ne duhet ta kemi kokën pak të ndërlikuar. Në qoftë se na vjen ndokush për të luftuar, ne do të luftojmë, do të luftojmë për të fituar paqen.

«Mbi bisedimet e Çuncinit» (17 tetor 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Në rast se na sulmon ndokush, po qe se kushtet janë të favorshme për luftim, partia jonë, duke qenë në pozitën e vetëmbrojtjes, me siguri do ta asgjësojë atë vendosmërisht, përfundimisht, rrënjësisht e plotësisht (të mos hyjmë të papregatitur në luftime dhe, po të nisim luftimin, duhet të fitojmë).

Ne nuk duhet të trembemi në asnjë mënyrë nga pamja e llahtarshme e reaksionarëve.

«Njoftim i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës mbi bisedimet e paqes me Gomindanin» (26 gusht 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Sa për dëshirat tona, ne nuk duam të luftojmë as edhe një ditë. Por në qoftë se rrethanat na detyrojnë të luftojmë, ne jemi në gjendje të luftojmë deri në fund.

«Bisedë me gazetaren amerikane Ana Luiza Strong» (gusht 1946), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Ne jemi për paqe. Por derisa imperializmi amerikan nuk heq dorë qoftë edhe për një ditë nga kërkesat e tij arrogante e brutale dhe nga planet e tij të errëta për zgjerimin e agresionit, popullit kinez nuk i mbetet rrugë tjetër veçse të jetë i vendosur për ta vazhduar luftën përkrah popullit korean. Kjo ndodh jo për arësye se ne jemi luftëdashës. Ne jemi të gatshëm

ta pushojmë menjëherë luftën dhe çështjet e mbetura pezull t'i zgjidhim më vonë. Por imperializmi amerikan nuk e don një gjë të tillë. Atëherë mirë, le të vazhdojë lufta. Ne jemi të gatshëm të luftojmë me imperializmin amerikan aq vjet, sa të dojë ai, deri në çastin kur ai do të jetë i gatshëm ta pushojë luftën, deri në fitoren e plotë të popujve kinez dhe korean.

Fjala e mbajtur në sesionin e katërt të Komitetit të parë Kombëtar të Konferencës Konsultative Politike Popullore të Kinës (7 shkurt 1953).

Ne duhet të zhdukim në radhët tona çdo mendim që përshkohet nga fryma e dobësisë dhe e pazotësisë. Çdo pikëpamje, që mbiçmon forcën e armikut dhe nënçmon forcën e popullit, është e gabuar.

«Gjendja e sotme dhe detyrat tona» (25 dhjetor 1947), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Popujt dhe kombet e shtypura nuk duhet në asnjë mënyrë ta varin shpresën për çli-

rimin e tyre tek "urtësia" e imperializmit dhe e shërbëtorëve të tij. Vetëm duke forcuar unitetin e tyre dhe duke luftuar me këmbëngulje, ata do të triumfojnë.

> «Deklaratë kundër agresionit në Vietnamin e Jugut dhe masakrimit të popullit të Vietnamit të Jugut nga klika amerikano-ngodindiemiste» (29 gusht 1963).

Cilido qoftë çasti kur do të shpërthejë lufta civile në shkallë kombëtare, ne duhet të jemi të pregatitur mirë. Edhe në rast se ajo do të fillojë shpejt, ta zëmë nesër në mëngjes, ne gjithashtu duhet të jemi të pregatitur. Ky është momenti i parë. Në gjendjen e sotme ndërkombëtare dhe të brendshme, ka mundësi që lufta civile përkohësisht të lokalizohet, të zhvillohet në formën e disa luftimeve me karakter lokal. Ky është momenti i dytë. Momenti i parë është ai, për të cilin ne jemi duke u pregatitur; momenti i dytë është ai që ekziston prej shumë kohësh. Me një fjalë, duhet të jemi të pregatitur. Duke qenë të pregatitur, ne do të jemi në gjendje t'u bëjmë

ballë si duhet të gjitha situatave të ndërlikuara.

«Gjendja dhe politika jonë pas fitores në Luftën e Rezistencës kundër Japonisë» (13 gusht 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

VIII. LUFTA POPULLORE

Lufta revolucionare është luftë e masave. Kjo luftë mund të bëhet vetëm duke mobilizuar masat, vetëm duke u mbështetur në masat.

> «Të kujdesemi për jetën e masave, t'u kushtojmë vëmendje metodave të punës» (27 janar 1934), *Vepra të zgjedhura,* vëll. 1.

Cili është muri me të vërtetë i çelniktë? Masat, masat shumëmilionëshe, që e përkrahin revolucionin me gjithë zemër dhe me gjithë shpirt. Ja, ky është muri me të vërtetë i çelniktë, të cilin s'ka asnjë forcë që të mundë ta shkatërrojë. Ai është krejtësisht i pashkatërrueshëm. Kundërrevolucioni nuk mund të na thyejë, kurse ne do ta thyejmë atë. Duke bashkuar masat shumëmilionëshe rreth qeverisë revolucionare

dhe duke zhvilluar luftën tonë revolucionare, ne do të jemi në gjendje të asgjësojmë plotësisht kundërrevolucionin dhe të fitojmë Kinën.

Po aty.

Forcat e mëdha të luftës i kanë rrënjët e tyre shumë thellë në gjirin e masave të popullit. Arësyeja kryesore që Japonia mori guximin të na marrë nëpër këmbë është se masat e popullit kinez janë të paorganizuara. Kur të kemi zhdukur këtë të metë, do t'i vëmë agresorët japonezë përballë popullit tonë qindramilionësh të ngritur më këmbë, do t'i vëmë në gjendjen e një bualli të egër të futur në një rreth zjarri dhe mjafton një e bërtitur që ai i tmerruar të hidhet në zjarr dhe të digjet i gjallë.

«Mbi luftën e gjatë» (maj 1938),
Vepra të zgjedhura, vëll. 2.

Imperialistët sillen në mënyrë aq arbitrare me ne, sa që kundër tyre duhet të marrim masa serioze. Ne jo vetëm që duhet të kemi një ushtri të fuqishme të rregullt, por edhe duhet të krijojmë në shkallë të gjerë divi-

zione të milicisë popullore. Kështu imperialistët do ta kenë të vështirë të hedhin qoftë dhe një hap përpara në rast agresioni kundër vendit tonë.

Intervistë e dhënë korespondentit të Agjensisë Sinhua (29 shtator 1958).

Nga pikëpamja e luftës revolucionare të marrë në tërësi, lufta popullore partizane dhe operacionet e Ushtrisë së Kuqe si forcë kryesore janë si dy krahë të një njeriu. Të kesh vetëm Ushtrinë e Kuqe si forcë kryesore dhe të mos zhvillosh luftën popullore partizane, do të thotë të jesh si një luftëtar me një krah. Në rastin konkret, sidomos lidhur me operacionet luftarake, kur themi se populli në bazat mbështetëse përbën një faktor lufte, kemi parasysh një popull të armatosur. Ja, këtu qëndron shkaku kryesor që armiku ka frikë të hyjë në bazat mbështetëse.

«Çështje të strategjisë së luftës revolucionare në Kinë» (dhjetor 1936), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Nuk ka dyshim se fitorja apo disfata në luftë përcaktohet kryesisht nga kushtet ushtarake, politike, ekonomike, natyrore, në të cilat ndodhen palët ndërluftuese. Por nuk mjafton me kaq. Ajo përcaktohet edhe nga aftësitë subjektive drejtuese të palëve ndërluftuese. Një strateg ushtarak nuk mund të pretendojë për fitore në luftë jashtë caqeve që lejojnë kushtet materiale, por ai mund dhe duhet të arrijë fitore brenda këtyre caqeve. Skena e veprimtarisë së strategut ushtarak ndërtohet mbi kushte materiale objektive, por në këtë skenë ai mund të drejtojë shumë akte plot gjallëri, dinamizëm, kolorit e madhështi.

Po aty.

Lufta nuk ka asnjë qëllim tjetër, përveç "ruajtjes së forcave të tua dhe asgjësimit të forcave të armikut" (asgjësimi i forcave të armikut do të thotë çarmatosja e tij ose e ashtuquajtura "heqje e forcës së rezistencës të armikut" dhe jo çfarosja e plotë fizike e forcave të tij). Në luftërat e kohëve

të lashta përdoreshin ushta dhe shqyti. Ushta shërbente për mësymjen, për asgjësimin e armikut, kurse shqyti — për mbrojtjen, për ruajtjen e vetvehtes. Deri në ditët tona të gjitha armët janë zhvillim i mëtejshëm i këtyre dy llojeve të armëve. Bombarduesit, mitralozat, topat me qitje të largët dhe gazrat helmuese janë zhvillim i ushtës, kurse strehimet kundra-ajrore, helmetat e çelnikta, fortifikatat prej betoni dhe kundërgazet janë zhvillim i shqytit. Tanket janë një armë e re, në të cilën kombinohet ushta me shqytin. Mjeti kryesor për asgjësimin e forcave të armikut është mësymja, por edhe mbrojtja nuk duhet të lihet mënjanë. Mësymja shërben për të asgjësuar drejtpërsëdrejti forcat e armikut dhe njëkohësisht për të ruajtur forcat e tua, sepse po nuk e asgjësove armikun, do të asgjësohesh vetë. Mbrojtja shërben drejtpërsëdrejti për ruajtjen e forcave të tua, por në të njëjtën kohë ajo është edhe një mjet ndihmës për mësymje ose një mjet për të pregatitur kalimin në mësymje. Tërheqja hyn në mbrojtje dhe është vazhdim i mbrojtjes,

kurse ndjekja është vazhdim i mësymjes. Duhet vënë në dukje se nga qëllimet e luftës asgjësimi i forcave të armikut është qëllimi kryesor, kurse ruajtja e forcave të tua është qëllim i dorës së dytë, sepse vetëm asgjësimi në masë i forcave të armikut mund të sigurojë efektivisht ruajtjen e forcave të tua. Nga kjo rezulton se mësymja si mjeti kryesor për asgjësimin e forcave të armikut luan rolin kryesor, kurse mbrojtja si mjet ndihmës për asgjësimin e forcave të armikut dhe si një nga mjetet për ruajtjen e forcave të tua — luan një rol të dorës së dytë. Ndonëse në praktikë gjatë luftës ndodh që pjesa më e madhe e kohës i kushtohet mbrojtjes, kurse pjesa më e vogël — mësymjes, prapësepraprë, po të merret zhvillimi i luftës në tërësi, mësymja mbetet kryesore.

«Mbi luftën e gjatë» (maj 1938),
Vepra të zgjedhura, vëll. 2.

Të gjitha parimet udhëheqëse të veprimeve ushtarake burojnë nga një parim themelor: me sa është e mundur të ruash

forcat e tua dhe të asgjësosh forcat e armikut. . . . Po si shpjegohet atëherë inkurajimi i sakrifikimit heroik të vetvehtes në luftë? Çdo luftë kërkon një çmim, nganjëherë një çmim shumë të lartë. A nuk është kjo në kontradiktë me parimin e "ruajtjes së forcave të tua"? Në të vërtetë nuk është aspak në kontradiktë. Për të folë më sakt, sakrifikimi i vetvehtes dhe ruajtja e forcave të tua janë parime të kundërta, por ata kondicionojnë njëri tjetrin, sepse këto sakrifica janë të domosdoshme jo vetëm për asgjësimin e forcave të armikut, por edhe për ruajtjen e forcave të tua; kjo "mosruajtje" e pjesshme dhe e përkohshme (sakrifica ose pagimi i çmimit) është e domosdoshme për ruajtjen e përgjithshme dhe të përhershme. Nga parimi themelor i mësipërm burojnë një varg parimesh për drejtimin e të gjitha veprimeve ushtarake, duke filluar që nga parimet e qitjes (mbulimi i vetvehtes dhe shfrytëzimi i plotë i fuqisë së zjarrit: e para — për ruajtjen e vehtes, e dyta — për asgjësimin e armikut) deri në parimet e strategjisë. Të gjitha këto janë të përshkuara nga fryma e këtij

parimi themelor. Të gjitha parimet në fushën e teknikës, parimet taktike, operative dhe strategjike janë kushte për zbatimin e këtij parimi themelor. Parimi i ruajtjes së forcave të tua dhe i asgjësimit të forcave të armikut përbën bazën e të gjitha parimeve ushtarake.

«Çështje të strategjisë së luftës partizane kundër Japonisë» (maj 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Parimet tona ushtarake konsistojnë në sa më poshtë:

1) Të sulmojmë më parë forcat armike të shpërndara dhe të izoluara, dhe pastaj forcat armike të përqëndruara e të fuqishme.

2) Të shtiem në dorë më parë qytetet e vogla e mesatare dhe krahinat e gjera fshatare, dhe pastaj qytetet e mëdha.

3) Të caktojmë për objektiv kryesor asgjësimin e forcave të gjalla të armikut, dhe jo mbajtjen ose marrjen e një qyteti apo të një territori. Mbajtja ose marrja e një qyteti apo e një territori është rezultat i asgjësimit të forcave të gjalla të armikut, dhe shpesh një qytet apo një territor

mund të mbahet ose të merret përfundimisht, vetëm pasi të ketë kaluar disa herë nga duart e njërit në ato të tjetrit.

4) Në çdo betejë të përqëndrojmë forca me një epërsi absolute (dy, tri, katër, bile nganjëherë edhe pesë ose gjashtë herë më të mëdha se ato të armikut), të rrethojmë nga të katër anët forcat armike, të bëjmë përpjekje për t'i asgjësuar krejt ato, pa u dhënë mundësi që të shpëtojnë nga rjeta ku kanë rënë. Në raste të veçanta, të përdorim metodën e dhënies së grushteve dërmuese armikut, domethënë të përqëndrojmë të gjitha forcat tona për një sulm frontal dhe për një sulm në njërin nga krahët e armikut ose në të dy krahët, me qëllim që të asgjësojmë një pjesë të trupave të tij dhe të dërmojmë pjesën tjetër, në mënyrë që ushtria jonë të mundë t'i çvendosë shpejt forcat e veta për të dërmuar trupat e tjera të armikut. Të përpiqemi t'u shmangemi betejave rraskapitëse, në të cilat përfitimi është më i vogël se humbjet ose vetëm i kompenson ato. Kështu, në tërësi (po të flasim për raportin numerik)

ne jemi në gjendje inferioriteti, por ne kemi epërsinë absolute në çdo sektor të caktuar, në çdo betejë të veçantë, dhe kjo na siguron fitoren në planin operativ. Me kalimin e kohës, ne do të fitojmë epërsinë e përgjithshme dhe më në fund do t'i asgjësojmë të gjitha forcat armike.

5) Të mos hyjmë në një luftim pa qenë të pregatitur ose në një luftim, për të cilin nuk jemi të sigurtë se do ta fitojmë. Të bëjmë përpjekje sa më të mëdha për t'u pregatitur mirë për çdo luftim dhe për të qenë të sigurtë për fitoren në një raport të dhënë kushtesh midis armikut dhe nesh.

6) Të zhvillojmë stilin tonë — trimëri në luftë, të mos u trembemi sakrificave dhe lodhjes, qëndresë në luftime të vazhdueshme (domethënë në luftimet e zhvilluara njëri pas tjetrit brenda një kohe të shkurtër dhe pa u çlodhur).

7) Të përpiqemi ta asgjësojmë armikun në lëvizje e sipër. Në të njëjtën kohë, t'i japim rëndësi taktikës së mësymjes mbi pozicionet, me qëllim që të

shtiem në dorë pikëmbështetjet dhe qytetet e armikut.

8) Përsa i përket sulmit mbi qytete, të shtiem në dorë me vendosmëri të gjitha pikëmbështetjet dhe qytetet e mbrojtura dobët nga ana e armikut. Të shtiem në dorë, në çastin e volitshëm, të gjitha pikëmbështetjet dhe qytetet e mbrojtura mesatarisht nga ana e armikut, kur një gjë të tillë e lejojnë rrethanat. Sa për pikëmbështetjet dhe qytetet e mbrojtura fuqimisht nga ana e armikut, të presim gjersa të piqen kushtet, dhe atëherë t'i marrim.

9) T'i plotësojmë forcat tona me të gjitha armët dhe me pjesën më të madhe të efektivit që i kemi zënë armikut. Burimet njerëzore dhe materiale për ushtrinë tonë janë kryesisht në front.

10) Të dimë të shfrytëzojmë intervalin ndërmjet dy betejave për çlodhjen, edukimin ideologjik dhe stërvitjen e trupave. Periudhat e çlodhjes, edukimit ideologjik dhe stërvitjes së trupave në përgjithësi nuk duhet të jenë tepër të gjata dhe, me aq sa ka mundësi, nuk

duhet t'i lihet armikut kohë për të marrë frymë.

Këto janë metodat kryesore të zbatuara nga Ushtria Popullore Çlirimtare për të shpartalluar Çan Kaj-shiun. Këto metoda janë farkëtuar nga Ushtria Popullore Çlirimtare gjatë shumë vjetëve luftimesh kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm dhe u përshtaten plotësisht kushteve tona të tanishme. . . . Strategjia dhe taktika jonë janë ndërtuar mbi bazën e luftës popullore; asnjë ushtri antipopullore nuk mund të përdorë strategjinë dhe taktikën tonë.

«Gjendja e sotme dhe detyrat tona» (25 dhjetor 1947), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Pa pregatitje, epërsia nuk është epërsi e vërtetë dhe as mund të ekzistojë iniciativë. Duke e kuptuar këtë, trupat që janë inferiore, por që janë të pregatitura, shpeshherë,

me anë të një sulmi të befasishëm, mund të mposhtin një armik superior.

«Mbi luftën e gjatë» (maj 1938),
Vepra të zgjedhura, vëll. 2.

IX. USHTRIA POPULLORE

Pa një ushtri popullore, populli nuk do të ketë asgjë.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Kjo ushtri është e fortë, sepse të gjithë pjesëtarët e saj kanë një disiplinë të ndërgjegjshme; ata janë të bashkuar dhe luftojnë jo për interesat egoiste të një pakice njerëzish apo të ndonjë grupi të ngushtë, por për interesat e masave të gjera popullore, për interesat e mbarë kombit. Të qëndrojë përkrah popullit kinez dhe t'i shërbejë me gjithë zemër atij — ky është i vetmi qëllim i kësaj ushtrie.

Po aty.

Ushtria e Kuqe Kineze është një organizatë e armatosur që kryen detyrat politike të revolucionit. Veçanërisht në periudhën e tanishme, Ushtria e Kuqe nuk kufizohet në asnjë mënyrë vetëm me veprimtarinë luftarake. Përveç luftimeve për asgjësimin e forcës ushtarake të armikut, asaj i ngarkohen edhe detyra të tjera të rëndësishme, si të zhvillojë propagandë ndër masat, të organizojë masat, të armatosë masat, të ndihmojë masat në ngritjen e pushtetit revolucionar, dhe bile në krijimin e organizatave të Partisë Komuniste. Ushtria e Kuqe nuk bën thjesht luftë për luftë, por lufton për të zhvilluar propagandë ndër masat, për të organizuar masat, për të armatosur masat dhe për t'i ndihmuar ato në ngritjen e pushtetit revolucionar. Pa këto qëllime nuk do të kishte kuptim as zhvillimi i luftës, as vetë ekzistenca e Ushtrisë së Kuqe.

«Mbi ndreqjen e mendimeve të gabuara në parti» (dhjetor 1929), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Ushtria Popullore Çlirimtare është gjithmonë një forcë luftarake. Edhe pas fitores në shkallë kombëtare, gjatë një periudhe historike, përderisa në vendin tonë nuk do të jenë zhdukur klasat dhe në botë do të ekzistojë sistemi imperialist, ushtria jonë do të mbetet një forcë luftarake. Për këtë nuk duhet të ketë asnjë keqkuptim dhe asnjë lëkundje.

«Raport në plenumin e dytë të Komitetit Qendror të zgjedhur nga Kongresi i 7-të i Partisë Komuniste të Kinës» (5 mars 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Ne kemi një ushtri për luftë dhe një ushtri për punë. Si ushtri për luftë, ne kemi Armatën e 8-të dhe Korpusin e 4-të të Ri; por edhe ajo duhet të kryejë një punë të dyfishtë — luftë e prodhim. Duke pasur dy ushtri të tilla dhe kur ushtria që lufton është e aftë të kryejë një punë të dyfishtë dhe, përveç kësaj, të punojë edhe me masat, ne mund të kapërcejmë vështi-

rësitë dhe të shpartallojmë imperializmin japonez.

«Organizohuni!» (29 nëndor 1943), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Mbrojtja jonë kombëtare do të forcohet dhe nuk do të lejohet që imperialistët, cilëtdo qofshin ata, të invadojnë rishtas tokën tonë. Forcat tona të armatosura popullore duhet të ruhen dhe të zhvillohen mbi bazën e Ushtrisë Popullore Çlirimtare heroike dhe të sprovuar. Ne do të kemi jo vetëm një ushtri tokësore të fuqishme, por edhe një forcë ushtarake ajrore të fuqishme dhe një forcë ushtarake detare të fuqishme.

Fjala e hapjes në sesionin e parë plenar të Konferencës Konsultative Politike Popullore të Kinës (21 shtator 1949).

Parimi ynë është: partia komandon pushkën dhe nuk lejohet në asnjë mënyrë që pushka të komandojë partinë.

«Lufta dhe çështjet e strategjisë» (6 nëndor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Të gjithë oficerët dhe ushtarët tanë duhet të mbajnë mend mirë në çdo çast se ne jemi Ushtria e madhe Popullore Çlirimtare, jemi trupa të udhëhequra nga Partia e madhe Komuniste e Kinës. Në qoftë se do të udhëhiqemi me konsekuencë nga direktivat e partisë, ne me siguri do të fitojmë.

«Manifest i Ushtrisë Popullore Çlirimtare Kineze» (tetor 1947), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

X. UDHËHEQJA E KOMITETEVE TË PARTISË

Sistemi i komiteteve të partisë është një institucion i rëndësishëm i partisë për të siguruar udhëheqjen kolegjiale dhe për t'i prerë rrugën përqëndrimit të punëve në duart e një njeriu të vetëm. Kohët e fundit është konstatuar se në disa nga organet tona udhëheqëse (sigurisht, jo në të gjitha) është mjaft e përhapur praktika kur një njeri i vetëm përqëndron në duart e veta drejtimin e punës dhe merret me zgjidhjen e problemeve të rëndësishme. Për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme nuk vendos mbledhja e komitetit të partisë, por një njeri i vetëm, kurse anëtarët e komitetit të partisë janë sa për formë. Divergjencat në mendime midis anëtarëve të komitetit nuk zgjidhen dot dhe lihen për një

kohë të gjatë pa u zgjidhur. Anëtarët e komitetit të partisë kanë midis tyre vetëm një unitet formal, e jo një unitet real. Kjo gjendje duhet ndryshuar. Që tani e tutje duhet të vendoset një sistem i shëndoshë mbledhjesh të komitetit të partisë, që nga byrotë krahinore të Komitetit Qendror e deri te komitetet e qarqeve, që nga komitetet e fronteve e deri te komitetet e brigadave dhe të rretheve ushtarake (degët e Këshillit Ushtarak Revolucionar ose grupet udhëheqëse), si dhe te grupet e partisë të udhëheqjes në organet qeveritare, në organizatat popullore, në agjensinë e lajmeve dhe në gazetat. Të gjitha problemet e rëndësishme (sigurisht, jo problemet e vogla të parëndësishme ose problemet, zgjidhja e të cilave ka qenë vendosur pasi janë zhvilluar diskutime nëpër mbledhjet dhe tani mbeten vetëm për t'u zbatuar) duhet t'i paraqiten komitetit për shqyrtim; anëtarët e pranishëm duhet t'i shprehin plotësisht mendimet e tyre dhe të marrin vendime të sakta, të cilat pastaj të zbatohen nga anëtarët përkatës. ... Mbledhjet e komitetit të partisë duhet të jenë dy llo-

jesh: mbledhje të komitetit të përhershëm dhe mbledhje plenare, ato nuk duhet të ngatërrohen. Përveç kësaj, duhet të kemi parasysh se nuk duhet lënë pas dore as udhëheqja kolegjiale as përgjegjësia personale. Në ushtri, gjatë operacioneve dhe kur e kërkojnë rrethanat, personat përgjegjës kanë të drejtë të marrin vendime në çast.

«Mbi forcimin e sistemit të komiteteve të partisë» (20 shtator 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Sekretari i komitetit të partisë duhet të dijë të jetë një "skuadër-komandant". Një komitet partie ka dhjetë deri njëzet anëtarë; ai është si një skuadër në ushtri, dhe sekretari është si "skuadër-komandant". Në të vërtetë ta udhëheqësh mirë këtë skuadër, nuk është punë e lehtë. Tani secila nga byrotë ose nënbyrotë krahinore të Komitetit Qendror udhëheq një krahinë të gjerë dhe merr përsipër detyra mjaft të rënda. Të drejtosh do të thotë jo vetëm të caktosh kursin dhe masat politike, por edhe të përpunosh metoda të drejta pune. Edhe sikur

të kesh kurs dhe masa politike të drejta, po të mos tregosh kujdes për metodat e punës, prapë do të dalin probleme. Për të kryer detyrën e vet të udhëheqjes, komiteti i partisë duhet të mbështetet te "anëtarët e skuadrës" së tij dhe t'i bëjë të aftë ata për të luajtur plotësisht rolin e tyre. Për të qenë një "skuadër-komandant" i mirë, sekretari duhet të mësojë me zell dhe t'i shqyrtojë mirë çështjet. Sekretari ose zëvendës-sekretari do ta ketë të vështirë t'i drejtojë mirë "anëtarët e skuadrës" së tij, po nuk u kujdesua të bëjë punë propagande dhe organizimi në radhët e tyre, po nuk diti të mbajë marrëdhënie të drejta me anëtarët e komitetit ose po nuk studioi mënyrat se si të zhvillojë me sukses mbledhjet. Në qoftë se "anëtarët e kësaj skuadre" nuk mbajnë të njëjtin hap, ata kurrë nuk mund të shpresojnë të drejtojnë miliona njerëz në luftë e në ndërtim. Sigurisht, marrëdhëniet midis sekretarit dhe anëtarëve të komitetit duhet të jenë të tilla që pakica t'i nënshtrohet shumicës, pra, ato ndryshojnë nga marrëdhëniet midis një skuadër-komandanti

dhe luftëtarëve të tij. Këtu ne folëm vetëm për analogji.

«Metodat e punës të komiteteve të partisë» (13 mars 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Shtroni problemet mbi tavolinë. Këtë duhet ta bëjë jo vetëm "skuadër-komandanti", por edhe anëtarët e komitetit. Mos u merrni me thashetheme prapa shpine. Porsa të dalin probleme, bëni një mbledhje, shtrojini ato mbi tavolinë për diskutim, merrni vendime dhe problemet do të zgjidhen. Në qoftë se dalin probleme dhe nuk shtrohen mbi tavolinë, ato do të mbeten për një kohë të gjatë pa u zgjidhur dhe bile do të zvarriten për vjetë të tëra. "Skuadër-komandanti" dhe anëtarët e komitetit duhet të kenë edhe mirëkuptim midis tyre. S'ka asgjë më të rëndësishme se mirëkuptimi, ndihma e miqësia ndërmjet sekretarit dhe anëtarëve të komitetit, ndërmjet Komitetit Qendror dhe byrove krahinore të tij, si dhe ndërmjet byrove krahinore të Komitetit Qendror dhe komiteteve qarkore të partisë.

Po aty.

"Shkëmbeni informatat". Me fjalë të tjera, anëtarët e komitetit të partisë duhet t'ja njoftojnë njëri tjetrit informatat që kanë marrë dhe t'i shkëmbejnë ato. Kjo është shumë e rëndësishme për të gjetur një gjuhë të përbashkët. Mirëpo disa nuk veprojnë kështu dhe, siç ka thënë Lao Ci, "nuk i shkelin kurrë njëri tjetrit në derë, megjithëse janë aq afër sa që gjelat që këndojnë dhe qentë që lehin te njëri dëgjohen te tjetri". Si rezultat, atyre u mungon gjuha e përbashkët.

Po aty.

Këshillohuni me shokët e instancave më të ulta për atë që nuk e kuptoni ose nuk e dini, mos e shprehni lehtë aprovimin ose kundërshtimin. . . . Kurrë nuk duhet të pretendojmë se e dimë një gjë që nuk e dimë dhe "nuk duhet të kemi turp të këshillohemi me vartësit tanë", por duhet të dimë të dëgjojmë mendimet e kuadrove të instancave më të ulta. Jini më parë nxënës, pastaj mësues; këshillohuni më parë me kuadrot e instancave më të ulta, pastaj

jepni urdhëra. . . . Në ato që thonë kuadrot e instancave më të ulta ka mendime të drejta dhe të padrejta. Këto, mbasi t'i dëgjojmë, duhet t'i analizojmë. Mendimet e drejta duhet t'i dëgjojmë dhe të veprojmë sipas tyre. . . . Ne duhet t'i dëgjojmë edhe mendimet e gabuara që vijnë nga poshtë; do të ishte gabim të mos i dëgjonim fare ato, por, mbasi t'i kemi dëgjuar, të mos veprojmë sipas tyre, por t'i kritikojmë.

Po aty.

Mësoni "t'i bini pianos". Për t'i rënë pianos, duhet të lëvizësh të dhjetë gishtërinjtë, dhe jo vetëm disa gishtërinj, duke i lënë pa lëvizur të tjerët. Mirëpo, edhe po t'i mbështetësh të dhjetë gishtërinjtë përnjëherësh, prapë nuk del asnjë melodi. Që të dalë një muzikë e bukur, duhet që lëvizjet e gishtërinjve të jenë ritmike dhe të koordinuara. Një komitet partie duhet ta marrë mirë në dorë detyrën qendrore të tij dhe, në të njëjtën kohë, rreth kësaj detyre të bëjë punë edhe në fusha të tjera. Tani ne merremi me veprimtari në shumë

fusha; ne duhet të kujdesemi për punën në të gjitha krahinat, në të gjitha njësitë ushtarake dhe në të gjithë sektorët; ne nuk duhet t'u kushtojmë vëmendje vetëm disa problemeve, dhe të lëmë mënjanë të tjerat. Kudo që paraqiten probleme, ne duhet të vëmë dorë; kjo është një metodë, të cilën ne duhet ta përvehtësojmë. Disa i bien mirë pianos, disa të tjerë keq, dhe ndryshimi ndërmjet melodive që nxjerrin ata është shumë i madh. Shokët e komiteteve të partisë duhet të mësojnë "t'i bien pianos" mirë.

Po aty.

"Kapeni fort" punën. Kjo do të thotë se një komitet partie medoemos duhet jo vetëm "ta kapë", por edhe "ta kapë fort" punën kryesore. Një gjë mund ta kapësh mirë vetëm duke e shtrënguar fort në dorë, pa i hapur aspak gishtërinjtë. Të mos e kapësh fort, do të thotë të mos e kapësh fare. Natyrisht, me dorë të hapur s'mund të kapësh asgjë. Edhe kur e mbyll dorën, po të mos e shtrëngosh fort, të duket sikur

diçka mban, por prapë nuk ke kapur asgjë. Disa nga shokët tanë, megjithëse e kapin punën kryesore, nuk e kapin fort, prandaj atyre nuk u shkon mbarë puna. Nuk bëhet asgjë, po nuk e kape punën; gjithashtu nuk bëhet asgjë, po nuk e kape fort.

Po aty.

Ngulni "shifrat" në kokë. Kjo do të thotë se ne duhet t'i kushtojmë medoemos kujdes anës sasiore të një gjendjeje ose të një problemi dhe të bëjmë një analizë sasiore themelore. Çdo cilësi çfaqet në një sasi të caktuar, dhe pa sasi nuk ka as cilësi. Edhe deri në ditët e sotme, shumë nga shokët tanë nuk dinë t'i kushtojnë vëmendje anës sasiore të sendeve, statistikave themelore, përqindjeve kryesore dhe kufijve sasiorë që përcaktojnë cilësitë e sendeve. Ata nuk kanë "shifra" në kokë për asgjë, si rezultat, ata nuk mund të mos bien në gabime.

Po aty.

"Lajmërim popullsisë". Për mbledhje duhet lajmëruar që më parë, pikërisht sikurse i bëhet një lajmërim popullsisë, në mënyrë që secili të dijë se çfarë problemesh do të diskutohen e do të zgjidhen dhe të pregatitet me kohë. Në disa krahina mbledhjet e kuadrove thërriten pa qenë pregatitur raportet dhe projekt-rezolutat, të cilat improvizohen kur pjesëmarrësit janë mbledhur; siç thotë një fjalë, "trupat dhe kuajt kanë mbërritur, por ushqimet dhe tagjia s'janë gati". Kjo nuk është gjë e mirë. Mos u ngutni t'i thërrisni mbledhjet, pa qenë të pregatitur mirë.

Po aty.

"Më pak trupa, por më të mira; administratë më të thjeshtë". Bisedat, fjalimet, artikujt dhe rezolutat duhet të jenë të qarta dhe të përmbledhura. Mbledhjet gjithashtu nuk duhet të jenë shumë të gjata.

Po aty.

Kini mendjen të bashkoheni dhe të punoni tok me shokët, mendimet e të cilëve

ndryshojnë nga tuajat. Si në organet lokale, ashtu edhe në ushtri, kësaj i duhet kushtuar vëmendje. Kështu duhet të veprojmë edhe me njerëzit pa parti. Që të gjithë ne kemi ardhur nga të katër anët e vendit dhe duhet të dimë të bashkohemi dhe të punojmë tok jo vetëm me shokët që kanë mendime të njëjta me ne, por edhe me ata shokë që kanë mendime të ndryshme nga tonat.

Po aty.

Ruhuni nga mendjemadhësia. Kjo është një çështje parimore për drejtuesit si dhe një kusht i rëndësishëm për ruajtjen e unitetit. As atyre, që nuk kanë bërë gabime të rënda dhe që kanë korrur suksese shumë të mëdha në punën e tyre, nuk duhet t'u rritet mendja.

Po aty.

Hiqni dy vija demarkacioni. Në radhë të parë, ndërmjet revolucionit dhe kundër-

revolucionit, ndërmjet Jenanit dhe Sianit*. Disa nuk e kuptojnë se duhet hequr kjo vijë demarkacioni. Për shembull, kur luftojnë kundër burokracisë, ata flasin për Jenanin sikur atje të mos kishte "asgjë të mirë", dhe nuk bëjnë krahasim e dallim midis burokracisë në Jenan dhe burokracisë në Sian. Ata bëjnë kështu një gabim themelor. Pastaj, në radhët e revolucionarëve duhet hequr një vijë demarkacioni midis asaj që është e drejtë dhe asaj që është e gabuar, midis sukseseve dhe të metave, si dhe të dallohet cila nga të dyja është kryesore dhe cila është e dorës së dytë. Për shembull, a janë sukseset në masën 30 përqind apo 70 përqind? Të mos ketë as nënvleftësim as mbivlerësim. Duhet bërë një vlerësim i përgjithshëm i punës së njeriut, për të parë nëse sukseset janë 30 përqind

* Jenani ishte vendi ku kishte selinë Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës nga janari 1937 e deri në mars 1947. Siani ishte qendër e sundimit reaksionar të Gomindanit në Kinën Veriperëndimore. Shoku Mao Cedun i paraqet këto dy qytete si simbole të revolucionit dhe të kundërrevolucionit.

dhe gabimet 70 përqind, apo anasjelltas. Në qoftë se sukseset janë 70 përqind, puna e këtij njeriu në përgjithësi duhet aprovuar. Do të ishte krejtësisht e padrejtë të thuhej se gabimet janë kryesore, kur kryesore janë sukseset. Në shqyrtimin e problemeve kurrë nuk duhet të harrojmë t'i heqim këto dy vija demarkacioni: midis revolucionit dhe kundërrevolucionit, midis sukseseve dhe të metave. Po t'i kemi mirë parasysh këto dy vija demarkacioni, puna do të na shkojë mbarë, përndryshe ne do ta ngatërrojmë natyrën e problemeve. Natyrisht, për t'i hequr si duhet këto dy vija, është e domosdoshme të bëhet një studim dhe një analizë e hollësishme. Qëndrimi ynë kundrejt çdo personi dhe çdo çështjeje duhet të mbështetet në analizën dhe studimin.

Po aty.

Nga pikëpamja organizative, duhet siguruar me rreptësi një jetë demokratike nën një udhëheqje të centralizuar. Rrugët për ta vënë këtë në jetë janë:

1) Organet udhëheqëse të partisë duhet të kenë një vijë të drejtë orientuese dhe t'u gjejnë zgjidhje problemeve që dalin, që të bëhen kështu qendra udhëheqëse.

2) Organet më të larta duhet të kenë një ide të qartë mbi gjendjen në organet më të ulta dhe mbi jetën e masave, gjë që do të krijojë bazën objektive për një udhëheqje të drejtë.

3) Organet e partisë të të gjitha instancave nuk duhet t'i zgjidhin problemet dosido. Po u muar një vendim, ai duhet të zbatohet me vendosmëri.

4) Çdo vendim pak a shumë i rëndësishëm i organeve më të larta duhet t'u njoftohet shpejt organeve më të ulta dhe gjithë masës së anëtarëve të partisë. . . .

5) Organet më të ulta të partisë dhe masa e anëtarëve të partisë duhet t'i diskutojnë me hollësi udhëzimet e organeve më të larta, në mënyrë që ta kuptojnë plotësisht rëndësinë e këtyre

udhëzimeve dhe të përcaktojnë metodat e zbatimit të tyre.

«Mbi ndreqjen e mendimeve të gabuara në parti» (dhjetor 1929), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

XI. VIJA E MASAVE

Populli dhe vetëm populli është forca lëvizëse që krijon historinë botërore.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Masat janë heronjtë e vërtetë, ndërsa ne shpeshherë bëhemi naivë e qesharakë. Pa kuptuar këtë, është e pamundur të fitojmë qoftë edhe njohuritë më elementare.

«Parathënie dhe pasthënie mbi "Studimet lidhur me fshatin"» (mars-prill 1941), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Masat popullore kanë një forcë krijuese të pashtershme. Ato mund të organizohen dhe të marshojnë përpara në të gjitha

fushat dhe në të gjithë sektorët, ku ato mund të vënë në veprim energjitë e veta, të marshojnë përpara në fushën e prodhimit në gjerësi e në thellësi dhe të rrisin gjithnjë e më shumë mirëqenien e tyre.

Shënim mbi artikullin «Problemi i krahut të tepërt të punës gjeti zgjidhje» (1955), *Hovi i socializmit në fshatin kinez.*

Hovi i tanishëm i lëvizjes fshatare është një ngjarje shumë e madhe. Brenda një kohe shumë të shkurtër, në të gjitha provincat e Kinës Qendrore, Jugore dhe Veriore qindra miliona fshatarë do të ngrihen më këmbë si stuhi e shtrëngatë, me shpejtësi të rrufeshme dhe me vrull të papërmbajtur, dhe s'do të ketë forcë që t'i ndalë, sado e madhe që të jetë ajo. Ata do t'i këpusin të gjithë vargonjtë që i mbajnë lidhur dhe do të sulen me furi në rrugën drejt çlirimit. Ata do t'i varrosin të gjithë imperialistët, feudalët satrapë, funksionarët e korruptuar dhe ryshfetçinjtë, despotët lokalë dhe agallarët shpirtliq. Ata do t'i vënë në provë të gjitha partitë revolucionare, të gjithë

shokët revolucionarë për të vendosur nëse do t'i pranojnë apo do t'i braktisin. A do të vihesh në krye të fshatarëve dhe t'i udhëheqësh ata? Apo do të mbetesh prapa tyre dhe do t'i kritikosh me të madhe? Apo do t'u kundërvihesh dhe do t'i luftosh ata? Çdo kinez është i lirë të zgjedhë njërën nga këto tri rrugë, por situata do ta detyrojë atë ta bëjë këtë zgjedhje sa më parë.

«Raport mbi studimin e bërë në provincën e Hunanit në lidhje me lëvizjen fshatare» (mars 1927), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Tani vrulli i transformimeve shoqërore në fshat, vrulli i kooperimit, ka shpërthyer në disa krahina dhe shumë shpejt do të përhapet në mbarë vendin. Kjo është një lëvizje revolucionare socialiste në shkallë të gjerë që përfshin një popullsi fshatare prej më se 500 milionësh dhe që ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe botërore. Ne duhet ta udhëheqim atë në mënyrë aktive, entuziaste e sistematike dhe jo ta tërheqim prapa me gjithfarë mënyrash. Gjatë kësaj lëvizjeje janë të

pashmangshme disa devijime; kjo është e kuptueshme, dhe ato nuk është vështirë të ndreqen. Në qoftë se ne do t'i ndihmojmë aktivisht kuadrot dhe fshatarët, ata do të mund t'i zhdukin të metat ose t'i ndreqin gabimet e tyre.

«Mbi çështjen e kooperimit të bujqësisë» (31 korrik 1955).

Në gjirin e masave fshihet një entuziazëm jashtëzakonisht i madh për socializmin. Ata që në periudhën e revolucionit dinë vetëm të ecin sipas rutinës, nuk e shohin fare këtë entuziazëm. Ata janë të verbër, përpara tyre gjithshka është e zezë. Nganjëherë ata shkojnë deri atje sa të ngatërrojnë të vërtetën me gënjeshtrën dhe ta paraqesin të bardhën për të zezë. Mos vallë kemi parë pak njerëz të tillë? Ata që dinë të ecin vetëm sipas rutinës, e nënvleftësojnë gjithmonë entuziazmin e popullit. Kur çfaqet një gjë e re, ata, si rregull, nuk e aprovojnë. Në fillim e kundërshtojnë, pastaj pranojnë disfatën dhe bëjnë një farë autokritike. Kur çfaqet një gjë tjetër e re, ata veprojnë në të njëjtën mënyrë, duke

mbajtur rishtas këto dy qëndrime. Dhe kështu veprojnë ata vazhdimisht, sa herë që çfaqet ndonjë gjë e re. Këta njerëz janë gjithnjë pasivë. Në çastet kritike ata gjithmonë qëndrojnë në vend dhe kanë nevojë që t'u jepet një shtytje e fortë në kurriz për të bërë një hap përpara.

Shënim mbi artikullin «Ky lokalitet e realizoi kooperimin e bujqësisë në dy vjet» (1955), *Hovi i socializmit në fshatin kinez.*

Prej më shumë se njëzet vjetësh, partia jonë çdo ditë punon me masat dhe ka më se dhjetë vjetë, që flet çdo ditë për vijën e masave. Ne gjithmonë kemi qenë të mendimit se revolucioni duhet të mbështetet në masat popullore dhe se në të duhet të marrin pjesë të gjithë; ne kemi qenë gjithnjë kundër mbështetjes vetëm në disa persona që japin urdhëra. Mirëpo në punën e disa shokëve vija e masave akoma nuk gjen zbatim; ata mbështeten akoma vetëm mbi një numër të vogël personash dhe punojnë të vetmuar e pa gjallëri. Një nga

arësyet është se, çfarëdo që të bëjnë, ata asnjëherë nuk duan t'u japin shpjegime të qarta njerëzve që ata udhëheqin dhe nuk dinë si ta zhvillojnë iniciativën dhe forcën krijuese të tyre. Subjektivisht, edhe ata duan që të gjithë të marrin pjesë në punë, por ata nuk u tregojnë të tjerëve çfarë duhet bërë dhe si duhet bërë. Në këtë mënyrë si është e mundur të vihen të gjithë në lëvizje dhe të kryhet mirë puna? Për ta zgjidhur këtë problem, sigurisht, kryesorja është që të bëhet një edukim ideologjik lidhur me vijën e masave, por njëkohësisht këtyre shokëve duhet t'u mësojmë shumë metoda konkrete pune.

«Bisedë me redaktorët e gazetës *Cinsujzhibao*» (2 prill 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Eksperienca 24-vjeçare na tregon se çdo detyrë, çdo politikë dhe çdo stil pune, kur ato janë të drejta, u përgjigjen kërkesave të masave në një kohë të caktuar e në një vend të caktuar dhe forcojnë lidhjet tona me masat; ndërsa çdo detyrë, çdo politikë

dhe çdo stil pune, kur ato janë të gabuara, nuk u përgjigjen kërkesave të masave në një kohë të caktuar dhe në një vend të caktuar dhe shpien në shkëputjen nga masat. Dogmatizmi, empirizmi, fryma e komandimit, zvaritja në bisht, sektarizmi, burokratizmi, qëndrimi arrogant në punë dhe vese të tjera janë pa dyshim të dëmshme e të palejueshme, dhe në qoftë se ndokush vuan nga këto vese, duhet medoemos t'i zhdukë, sepse ato shpien në shkëputjen nga masat.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Për të mbajtur lidhje me masat, ne duhet të veprojmë sipas nevojave dhe vullnetit të tyre. Në çdo punë për masat ne duhet të nisemi nga nevojat e tyre, dhe jo nga dëshirat personale, sado të mira që të jenë ato. Shpeshherë masat, megjithëse kanë objektivisht nevojë për ndonjë transformim, subjektivisht nuk janë ende të ndërgjegjshme për këtë, ato nuk kanë ende as ve-

ndosmëri, as dëshirë për ta kryer këtë transformim. Në të tilla raste ne duhet të presim me durim. Këtë transformim ne duhet ta kryejmë vetëm kur si rezultat i punës sonë, masat në shumicën e tyre të bëhen të ndërgjegjshme dhe të kenë vendosmëri e vullnet për ta kryer atë. Përndryshe, do të shkëputemi nga masat. Pa ndërgjegjen dhe vullnetin e masave, çdo punë që kërkon pjesëmarrjen e tyre do të kthehet në një formalitet të zbrazët dhe do të dështojë. . . . Këtu udhëhiqemi nga dy parime: njëri është parimi i nevojave reale të masave, dhe jo i nevojave të lindura në imagjinatën tonë; tjetri është parimi i vullnetit të masave, vendosmërisë që tregojnë vetë masat, dhe jo vendosmërisë që tregojmë ne në vend të tyre.

«Fronti unik në punën kulturale» (30 tetor 1944), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Kongresi ynë duhet t'i bëjë thirrje gjithë partisë të jetë vigjilente dhe të kujdeset që

asnjë shok, në çdo post që të jetë, të mos shkëputet nga masat. Çdo shok duhet të edukohet në mënyrë të atillë, që t'i dojë masat popullore, të dëgjojë me vëmendje zërin e tyre; të shkrihet me masat kudo që të ndodhet, të mos qëndrojë mbi to, por të futet në gjirin e tyre; të zgjojë dhe të rrisë ndërgjegjen e masave, duke marrë parasysh nivelin e tyre; në bazë të parimit të vullnetarizmit të plotë t'i ndihmojë masat të organizohen gradualisht dhe të zhvillojnë gradualisht të gjitha format e domosdoshme të luftës, që lejojnë rrethanat e brendshme e të jashtme në një vend të caktuar dhe në një kohë të caktuar.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Në qoftë se ne do të hidheshim në mësymje kur masat akoma nuk janë bërë të ndërgjegjshme, ky do të ishte aventurizëm. Në qoftë se ne do të ngulnim këmbë t'i udhëhiqnim masat që të bënin diçka kundër vullnetit të tyre, ne do të dë-

shtonim me siguri. Në qoftë se ne nuk do të përparonim, kur masat kërkojnë të përparojnë, ky do të ishte oportunizëm i djathtë.

«Bisedë me redaktorët e gazetës *Cinsujzhibao*» (2 prill 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Në të gjitha punët, fryma e komandimit është e gabuar, sepse ajo e kalon nivelin e ndërgjegjes së masave dhe shkel parimin e vullnetarizmit të masave, ajo është çfaqje e një sëmundjeje që quhet ngutje. Shokët tanë nuk duhet të mendojnë se një gjë që e kanë kuptuar ata, do ta kenë kuptuar edhe masat e gjera. Nëse masat e kanë kuptuar atë dhe janë gati të veprojnë, këtë mund ta marrim vesh vetëm duke shkuar në gjirin e tyre dhe duke bërë hetime. Po të veprojmë në këtë mënyrë, ne do të mund t'i shmangemi frymës së komandimit. Në të gjitha punët, zvaritja në bisht është gjithashtu e gabuar, sepse ajo është shprehje e mbetjes prapa nivelit të ndërgjegjes së masave, shkel pari-

min e udhëheqjes së masave në ecjen e tyre përpara dhe është çfaqje e një sëmundjeje që quhet javashllëk. Shokët tanë nuk duhet të mendojnë se atë që nuk e kanë kuptuar akoma ata vetë, nuk do ta kenë kuptuar as masat. Shpeshherë masat e gjera na e kalojnë neve dhe kërkojnë me ngutje të ecin përpara, ndërsa shokët tanë, të paaftë për të qenë udhëheqës të masave të gjera, pasqyrojnë mendimet e një pjese elementësh të prapambetur dhe këto mendime i marrin gabimisht për mendime të masave të gjera, duke u zvaritur në bisht të elementëve të prapambetur.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Të grumbullojmë mendimet e masave, t'i përgjithësojmë dhe t'i çojmë përsëri në masat për t'i vënë në jetë, me qëllim që të formojmë ide udhëheqëse të drejta — kjo është metoda themelore e udhëheqjes.

«Disa çështje në lidhje me metodat e udhëheqjes» (1 qershor 1943), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Në gjithë veprimtarinë praktike të partisë sonë, çdo udhëheqje e drejtë duhet të mbështetet në parimin "të marrim nga masat dhe të çojmë në masat". Kjo do të thotë t'i grumbullojmë mendimet e masave (të shpërndara, të pasistemuara), t'i përgjithësojmë dhe t'i çojmë përsëri në masat (të përgjithësuara dhe të sistemuara, pas një studimi), t'i propagandojmë dhe t'i shpjegojmë, që ato të bëhen mendime të masave, të zbatohen nga masat, të kthehen në veprime dhe në veprimet e masave të verifikojmë nëse këto mendime janë të drejta. Pastaj përsëri t'i grumbullojmë dhe t'i përgjithësojmë mendimet e masave dhe t'i çojmë përsëri në masat që ato t'i zbatojnë. Dhe kështu, duke ndjekur një proces të tillë spiral pa mbarim, këto mendime bëhen gjithnjë e më të drejta, më të gjalla dhe më të pasura. E tillë është teoria marksiste e njohjes.

Po aty.

Ne duhet të shkojmë tek masat, të mësojmë nga masat, të përgjithësojmë ekspe-

riencën e tyre për të nxjerrë prej saj parime dhe metoda akoma më të mira dhe të sistemuara, pastaj t'ua bëjmë të njohura masave (t'i propagandojmë), t'u bëjmë thirrje masave që t'i zbatojnë ato dhe të zgjidhim problemet e tyre, me qëllim që masat të çlirohen dhe të sigurojnë lumturinë.

«Organizohuni!» (29 nëndor 1943), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Në organet tona drejtuese të disa krahinave ka njerëz që mendojnë se mjafton që politikën e partisë ta njohin vetëm udhëheqësit dhe se nuk është e nevojshme që ajo t'u bëhet e njohur masave. Ky është një nga shkaqet themelore që një pjesë e punës sonë nuk ka qenë e mundur të kryhet mirë.

«Bisedë me redaktorët e gazetës *Cinsujzhibao*» (2 prill 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Në çdo lëvizje të masave ne duhet të bëjmë një hetim dhe një analizë themelore

për të përcaktuar numrin e përkrahësve aktivë, të kundërshtarëve dhe të atyre që mbajnë një qëndrim të ndërmjemë, të mos marrim vendime pa bazë e në mënyrë subjektive.

«Metodat e punës të komiteteve të partisë» (13 mars 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Masat, kudo që janë, ndahen në përgjithësi në tri kategori: njerëz relativisht aktivë, njerëz me një qëndrim të ndërmjemë dhe njerëz relativisht të prapambetur. Prandaj drejtuesit duhet të jenë të aftë të bashkojnë rreth vehtes një numër të vogël aktivistësh si levë kryesore për udhëheqjen dhe, duke u mbështetur tek ata, të ngrejnë nivelin e elementëve të ndërmjemë dhe të tërheqin pas vehtes elementët e prapambetur.

«Disa çështje në lidhje me metodat e udhëheqjes» (1 qershor 1943), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Të dimë ta shndërrojmë politikën e partisë në veprime të masave, të dimë të

bëjmë që të gjitha lëvizjet dhe përpjekjet tona jo vetëm të kuptohen nga kuadrot drejtuese, por edhe të kuptohen dhe të përvehtësohen nga masat e gjera, — ky është një art marksist-leninist i udhëheqjes. Nga kjo varet gjithashtu nëse ne do të bëjmë apo jo gabime në punë.

«Bisedë me redaktorët e gazetës *Cinsujzhibao*» (2 prill 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Aktiviteti që tregon vetëm një grup drejtues, po të mos kombinohet me atë të masave të gjera, do të shndërrohet në përpjekje të pafrytshme të një pakice njerëzish. Por edhe aktiviteti i masave të gjera pa një grup drejtues të fortë, që ta organizojë si duhet këtë aktivitet, nuk mund as të vazhdojë gjatë, as të zhvillohet në rrugë të drejtë dhe të ngrihet në një nivel më të lartë.

«Disa çështje në lidhje me metodat e udhëheqjes» (1 qershor 1943), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Veprimtaria prodhuese e masave, interesat e tyre, eksperienca e tyre dhe gjendja shpirtërore e tyre — ja ku duhet të përqëndrohet vazhdimisht vëmendja e kuadrove drejtuese.

Mbishkrim për ekspozitën mbi veprimtarinë prodhuese të organeve të varura drejtpërdrejt nga KQ i partisë dhe nga Këshilli Ushtarak pranë KQ të partisë (Gazeta *Çefanzhibao* e Jenanit, 24 nëndor 1943).

Ne duhet t'u kushtojmë një vëmendje të madhe çështjeve që kanë të bëjnë me jetën e masave, duke filluar nga çështjet e tokës dhe të punës e deri te çështjet e furnizimit me lëndë djegëse, oriz, vaj dhe kripë. . . . Të gjitha këto çështje, që kanë të bëjnë me jetën e masave, duhet t'i vëmë në rend të ditës. Ne duhet t'i shqyrtojmë ato, të marrim vendime, t'i vëmë në jetë këto vendime dhe të kontrollojmë zbatimin e tyre. Duhet që masat e gjera ta kuptojnë se ne përfaqësojmë interesat e tyre, se ne kemi

të njëjtën frymëmarrje me to. Duhet që, duke u nisur nga kjo, ato t'i kuptojnë detyrat akoma më të larta- që shtrojmë ne, detyrat e luftës revolucionare, që ato ta përkrahin revolucionin, ta përhapin atë në gjithë vendin, t'u përgjigjen thirrjeve tona politike dhe të luftojnë deri në fund për fitoren e revolucionit.

«Të kujdesemi për jetën e masave, t'u kushtojmë vëmendje metodave të punës» (27 janar 1934), *Vepra të zgjedhura,* vëll. 1.

XII. PUNA POLITIKE

Në atë kohë (gjatë luftës së parë civile revolucionare 1924-1927 — shën. i red.) në ushtri u vendos sistemi i përfaqësuesve të partisë dhe i degëve politike. Ky sistem nuk ishte parë në historinë e Kinës. Me këtë sistem ushtria mori një pamje krejt të re. Pas vitit 1927 Ushtria e Kuqe, sot Armata e 8-të, e ka trashëguar dhe zhvilluar këtë sistem.

«Bisedë me korespondentin anglez Xhems Bertram» (25 tetor 1937), *Vepra të zgjedhura,* vëll. 2.

Mbi bazën e luftës popullore dhe të parimit të unitetit midis ushtrisë dhe popullit, midis komandantëve dhe luftëtarëve si dhe parimit të çthurjes së trupave armike, Ushtria Popullore Çlirimtare ka ndërtuar

punën e saj politike revolucionare të fuqishme, gjë që përbën një faktor të rëndësishëm të fitores sonë mbi armikun.

«Gjendja e sotme dhe detyrat tona» (25 dhjetor 1947), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Kjo ushtri ka krijuar një sistem të tërë pune politike, që është i domosdoshëm për luftën popullore dhe që ka për detyrë të luftojë për shtrëngimin e radhëve të ushtrisë, për unitetin me ushtritë mike, për unitetin me popullin, për çthurjen e trupave armike dhe sigurimin e fitores në betejë.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Puna politike është një arter jetik për gjithë punën tonë në fushën ekonomike. Ajo është e tillë veçanërisht në periudhën kur sistemi ekonomiko-shoqëror po pëson transformime rrënjësore.

Shënim mbi artikullin «Një mësim serioz» (1955), *Hovi i socializmit në fshatin kinez.*

Nëse Ushtria e Kuqe ka mundur të luftojë me heroizëm në kushte kaq të vështira pa u shpartalluar, një nga arësyet e rëndësishme është "organizimi i celulës së partisë në bazë kompanie".

«Lufta në malet Cinganshan» (25 nëndor 1928), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Puna politike e Armatës së 8-të mbështetet në tri parime themelore:

Së pari, parimi i unitetit midis oficerëve dhe ushtarëve. Kjo nënkupton zhdukjen e praktikës feudale në ushtri, ndalimin e rrahjeve dhe sharjeve, vendosjen e një disipline të ndërgjegjshme, ndarjen e gëzimeve dhe hidhërimeve midis oficerëve dhe ushtarëve; të gjitha këto e bëjnë ushtrinë kompakte.

Së dyti, parimi i unitetit midis ushtrisë dhe popullit. Kjo nënkupton mbajtjen e një disipline që nuk lejon të cenohen sado pak interesat e popullit, punën propagandistike me të, organizimin dhe armatosjen e tij, lehtësimin e barrës së tij ekonomike dhe goditjen e tradhëta-

rëve të Atdheut që dëmtojnë popullin e ushtrinë; të gjitha këto krijojnë unitetin midis ushtrisë dhe popullit dhe bëjnë që ushtria të mirëpritet kudo nga populli.

Së treti, parimi i çthurjes së trupave armike dhe i trajtimit zemërgjerë të robërve të luftës. Fitorja jonë nuk varet vetëm nga veprimet luftarake të ushtrisë sonë, por edhe nga çthurja e trupave armike.

«Bisedë me korespondentin anglez Xhems Bertram» (25 tetor 1937), *Vepra të zgjedhura,* vëll. 2.

Në marrëdhëniet midis ushtrisë dhe popullit, midis ushtrisë dhe organeve të pushtetit, midis ushtrisë dhe organeve të partisë, midis oficerëve dhe ushtarëve, midis punës ushtarake dhe punës politike dhe në marrëdhëniet reciproke midis kuadrove, trupat tona duhet të udhëhiqen nga parime të drejta dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të bien në gabime militariste. Oficerët duhet të kujdesen për ushtarët, të mos jenë indiferentë ndaj tyre dhe të mos përdorin kundrejt tyre ndëshkime trupore. Ushtria

duhet ta dojë popullin dhe të mos dëmtojë interesat e tij; ajo duhet të respektojë organet e pushtetit e të partisë dhe të mos pretendojë "pavarësinë".

«Organizohuni!» (29 nëndor 1943),
Vepra të zgjedhura, vëll. 4.

Politika jonë ndaj robërve të luftës të ushtrisë japoneze, të trupave kuklla ose antikomuniste është që ata të lirohen, me përjashtim të atyre, ndaj të cilëve masat ushqejnë urrejtje të thellë dhe të cilët duhet të ekzekutohen patjetër pasi vendimet të jenë aprovuar nga instancat më të larta. Nga robërit, ata që janë futur me forcë në ushtri dhe që kanë pak a shumë frymë revolucionare, duhet të tërhiqen në një numër të madh që të shërbejnë në ushtrinë tonë, ndërsa të gjithë të tjerët të lihen të lirë. Në qoftë se ata do të luftojnë përsëri kundër nesh, përsëri do të zihen robër dhe përsëri do të lihen të lirë. Ata nuk duhet të fyhen, nuk duhet t'u merren paret dhe sendet, nuk duhet t'u kërkohet që të shprehin pendimin, por në të gjitha rastet

ndaj tyre duhet mbajtur një qëndrim i përzemërt dhe dashamirës. Kjo politikë duhet ndjekur ndaj të gjithë robërve, sado reaksionarë që të jenë. Kjo është një politikë shumë e efektshme për izolimin e kampit reaksionar.

«Mbi politikën tonë» (25 dhjetor 1940), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 3.

Armët janë një faktor i rëndësishëm në luftë, por jo vendimtar. Faktor vendimtar është njeriu dhe jo sendi. Raporti i forcave konsiston jo vetëm në raportin e fuqisë ushtarake dhe ekonomike, por edhe në raportin e burimeve njerëzore dhe të forcave morale. Forcat ushtarake dhe ekonomike drejtohen nga njerëzit.

«Mbi luftën e gjatë» (maj 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Bomba atomike është një tigër prej letre, që reaksionarët amerikanë e përdorin për të frikësuar njerëzit. Ajo është e llahtarshme nga pamja e jashtme, por në të vërtetë nuk është e tillë. Sigurisht, bomba atomike

është një armë e çfarosjes në masë, por është populli ai që vendos fatin e një lufte, dhe jo një ose dy armë të reja.

«Bisedë me gazetaren amerikane Ana Luiza Strong» (gusht 1946), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Baza e ushtrisë është ushtari. Pa rrënjosur në ushtri një frymë politike përparimtare dhe pa bërë për këtë qëllim një punë politike përparimtare është e pamundur të arrihet një unitet i vërtetë midis oficerëve dhe ushtarëve, është e pamundur të ngjallet ndër ta një entuziazëm shumë i madh në Luftën e Rezistencës dhe t'i sigurohet teknikës e taktikës një bazë e përsosur që ato të tregojnë si duhet efikasitetin e tyre.

«Mbi luftën e gjatë» (maj 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Në një pjesë shokësh në Ushtrinë e Kuqe janë shumë të përhapura pikëpamjet thjesht ushtarake. Këto pikëpamje manifestohen si më poshtë:

1. Ata janë të mendimit se çështjet ushtarake dhe politika janë në kundërshtim me njëra tjetrën dhe nuk pranojnë se çështjet ushtarake s'janë gjë tjetër veçse një nga mjetet për plotësimin e detyrave politike. Bile disa thonë se "kur je mirë nga ana ushtarake, natyrisht, do të jesh mirë edhe nga ana politike; kur nuk je mirë nga ana ushtarake, nuk mund të jesh mirë as nga ana politike", dhe në këtë mënyrë ata shkojnë edhe më tej, duke menduar se çështjet ushtarake udhëheqin politikën.

. . . . . .

«Mbi ndreqjen e mendimeve të gabuara në parti» (dhjetor 1929), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Marrja në dorë e edukimit ideologjik është hallka qendrore në përpjekjet për të bashkuar gjithë partinë në luftën e madhe politike. Pa zgjidhur këtë detyrë, partia nuk mund të plotësojë asnjë nga detyrat e saj politike.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Kohët e fundit, në radhët e inteligjencies dhe të rinisë shkollore, është vënë re një dobësim i punës ideopolitike, janë çfaqur disa devijime. Sipas mendimit të disa njerëzve, nuk kemi përse të interesohemi për çështjet politike, për të ardhmen e Atdheut dhe për idealet e njerëzimit, marksizmi ka qenë i modës dikur, ndërsa tani nuk është më aq i modës. Duke pasur parasysh këtë gjendje, tani është e nevojshme të forcohet puna ideopolitike. Si inteligjencia, ashtu edhe rinia shkollore duhet të studiojnë me zell. Përveç përvehtësimit të specialitetit të tyre, ato duhet të bëjnë përparime si nga pikëpamja ideologjike, ashtu edhe nga pikëpamja politike, dhe për këtë duhet të studiojnë marksizmin, ngjarjet aktuale e problemet politike. Të mos kesh pikëpamje të drejta politike, është njësoj si të mos kesh shpirt. . . . Për punën ideopolitike duhet të përgjigjen të gjithë sektorët e organizatat. Me këtë çështje duhet të merret Partia Komuniste, Bashkimi i Rinisë, organet përkatëse të pushtetit dhe

sidomos drejtorët dhe personeli pedagogjik i institucioneve arësimore.

> «Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Nëpërmjet edukimit politik, ushtarët e Ushtrisë së Kuqe kanë fituar ndërgjegjen klasore, kanë përvehtësuar njohuri të përgjithshme mbi ndarjen e tokës, vendosjen e pushtetit, armatosjen e punëtorëve dhe fshatarëve etj., kanë kuptuar se luftojnë për vehten e tyre, për klasën punëtore dhe fshatarësinë. Prandaj, me gjithë kushtet e rënda të luftës, ata nuk ankohen. Çdo kompani, batalion dhe regjiment ka komitetin e vet të ushtarëve, i cili përfaqëson interesat e tyre dhe zhvillon punë politike e punë me masat.

> «Lufta në malet Cinganshan» (25 nëndor 1928), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Në sajë të zhvillimit të drejtë të lëvizjes për të treguar rreth vuajtjeve (denoncimi

i vuajtjeve që i kanë shkaktuar popullit punonjës shoqëria e vjetër dhe reaksionarët) dhe të tre verifikimeve (në lidhje me prejardhjen klasore, kryerjen e punës dhe vullnetin luftarak) është ngritur shumë ndërgjegja e komandantëve dhe e luftëtarëve të gjithë ushtrisë në luftën e tyre për çlirimin e masave punonjëse të shfrytëzuara, për zbatimin e reformës agrare në gjithë vendin dhe për asgjësimin e armikut të përbashkët të popullit, bandës së Çan Kaj-shiut. Në të njëjtën kohë është forcuar së tepërmi uniteti monolit i të gjithë komandantëve dhe luftëtarëve nën udhëheqjen e Partisë Komuniste. Mbi këtë bazë janë bërë edhe më të pastra radhët e ushtrisë, është forcuar disiplina, ka marrë një hov lëvizja masive për stërvitjen ushtarake, në ushtri është zhvilluar, nën një udhëheqje të drejtë dhe me rregull të plotë, demokracia në fushën politike, ekonomike e ushtarake. Në këtë mënyrë, ushtria është bashkuar si një trup i vetëm, i gjithë efektivi i saj kontribuon me mendimet dhe forcat e veta, nuk i trembet asnjë sakrifice, kapërcen vështirësitë materiale, tregon

trimëri dhe heroizëm në masë në luftën për shpartallimin e armikut. Një ushtri e tillë do të jetë e pathyeshme.

> «Mbi fitoren e madhe në Kinën Veriperëndimore dhe lëvizjen e edukimit ideologjik të tipit të ri në Ushtrinë Çlirimtare» (7 mars 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Këta muajt e fundit pothuajse të gjitha repartet e Ushtrisë Popullore Çlirimtare, duke shfrytëzuar intervalet ndërmjet veprimeve luftarake, kanë bërë një punë të gjerë për edukimin ideologjik dhe stërvitjen e trupave. Kjo është bërë sipas metodës demokratike, nën një udhëheqje të drejtë dhe me rregull të plotë. Si rrjedhim, është rritur entuziazmi revolucionar i masave të gjera të luftëtarëve dhe të komandantëve, ata e kanë kuptuar qartë qëllimin e luftës, janë likuiduar disa tendenca ideologjike të gabuara dhe disa çfaqje negative që ishin dukur në ushtri, është bërë një punë e mirë edukative me kuadrot e ushtarët dhe është rritur shumë aftësia luftarake. Ne duhet të vazhdojmë të zhvillojmë edhe në të

ardhmen lëvizjen e edukimit ideologjik të tipit të ri në ushtri, lëvizje që ka një karakter demokratik e masiv.

> «Fjala e mbajtur në konferencën e kuadrove të krahinës së çliruar Shansi-Sujuan» (1 prill 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Në punën mësimore të Akademisë ushtarako-politike antijaponeze ndiqet ky kurs: orientim politik i vendosur dhe i drejtë, stil këmbënguljeje dhe thjeshtësie në punë, strategji e taktikë e shkathët dhe manovruese. Këto tri parime janë të domosdoshme për pregatitjen e një ushtaraku revolucionar të luftës antijaponeze. Në përputhje me këto tri parime, personeli administrativ, trupi mësimor dhe kursantët e kësaj akademie kryejnë punën e tyre mësimore dhe studimet.

> «Të jesh objekt sulmesh nga ana e armiqve është një gjë e mirë dhe jo e keqe» (26 maj 1939).

Kombi ynë ka pasur gjithmonë një stil tradicional të luftës këmbëngulëse, të cilin

ne duhet ta zhvillojmë. . . . Për më tepër, Partia Komuniste ka inkurajuar gjithnjë një orientim politik të vendosur dhe të drejtë. . . . Ky orientim është i pandarë nga stili i këmbënguljes në punë. Pa një orientim politik të vendosur dhe të drejtë, është gjithashtu e pamundur të zhvillohet stili i këmbënguljes në punë. Pa një stil të tillë, është e pamundur të ndiqet një orientim politik i vendosur dhe i drejtë.

«Fjala e mbajtur në mitingun me rastin e Ditës ndërkombëtare të punonjësve, 1 Majit, në Jenan» (1 maj 1939).

Unitet, operativitet, seriozitet dhe gjallëri.

Moto për Akademinë ushtarako-politike antijaponeze.

Ajo, që ka me të vërtetë rëndësi në botë, është qëndrimi serioz, dhe pikërisht këtij qëndrimi Partia Komuniste i kushton vëmendjen më të madhe.

Bisedë me studentët dhe praktikantët kinezë në Moskë (17 nëndor 1957).

XIII. MARRËDHËNIET MIDIS OFICERËVE DHE USHTARËVE

Ushtria jonë ka ndjekur gjithmonë dy parime, sipas të cilëve: së pari, duhet të jemi të pamëshirshëm ndaj armikut, ta mposhtim dhe ta asgjësojmë atë; së dyti, duhet të jemi të dashur me njerëzit tanë, me popullin, me shokët, me eprorët e vartësit tanë dhe të sigurojmë unitetin me ta.

Fjalimi i mbajtur në pritjen e dhënë nga Komiteti Qendror i partisë për nder të përfaqësuesve të aktivistëve të dalluar në studim, të dërguar nga forcat e prapavijës (18 shtator 1944).

Ne kemi ardhur këtu nga të katër anët e vendit, jemi mbledhur për një qëllim

revolucionar të përbashkët. . . . Kuadrot tona duhet të kujdesen për çdo luftëtar, të gjithë ata që bëjnë pjesë në radhët e revolucionarëve duhet të kujdesen për njëri tjetrin, duhet ta duan dhe ta ndihmojnë njëri tjetrin.

«T'i shërbejmë popullit» (8 shtator 1944), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Në të gjitha repartet ushtarake duhet të zhvillohet lëvizja për të përkrahur kuadrot dhe për t'u kujdesur për ushtarët, kuadrove t'u bëhet thirrje të tregojnë kujdes për ushtarët dhe ushtarëve — të përkrahin kuadrot. Ata duhet t'ja vënë në dukje hapur të metat dhe gabimet njëri tjetrit dhe t'i ndreqin shpejt ato. Kështu ata do të mund të arrijnë një unitet të brendshëm të përsosur.

«Detyrat e vitit 1945» (15 dhjetor 1944).

Shumë njerëz mendojnë se midis oficerëve dhe ushtarëve, midis ushtrisë dhe popullit nuk ka marrëdhënie të mira për shkak të metodave jo të drejta; unë u kam thënë kurdoherë atyre se këtu çështja ka

të bëjë me qëndrimin themelor (ose me qëllimin themelor) që konsiston në respektin për ushtarin dhe për popullin. Nga ky qëndrim rrjedhin politika, metodat dhe format përkatëse. Ndërsa po të largohemi nga ky qëndrim, edhe politika, metodat e format do të jenë patjetër të gabuara dhe nuk do të jetë e mundur në asnjë mënyrë të vendosen marrëdhënie të mira midis oficerëve dhe ushtarëve, midis ushtrisë dhe popullit. Tri parimet kryesore të punës politike në ushtri janë: së pari, uniteti midis oficerëve dhe ushtarëve; së dyti, uniteti midis ushtrisë dhe popullit; së treti, çthurja e forcave armike. Për t'i zbatuar në mënyrë të efektshme këto parime, duhet të nisemi nga ky qëndrim themelor: respekt për ushtarin, për popullin dhe për dinjitetin njerëzor të robërve të luftës që kanë dorëzuar armët. Ata që mendojnë se këtu nuk është puna për qëndrimin themelor, por për çështje me karakter teknik, me siguri që gabohen rëndë dhe duhet të ndreqen.

«Mbi luftën e gjatë» (maj 1938),
Vepra të zgjedhura, vëll. 2.

Komunistët në punën e tyre me punonjësit, duhet të përdorin metodat demokratike të bindjes dhe të edukimit, nuk lejohen në asnjë mënyrë komandimi dhe detyrimi. Partia Komuniste e Kinës i përmbahet me besnikëri këtij parimi marksist-leninist.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Shokët tanë duhet ta kuptojnë patjetër se puna për riedukimin ideologjik kërkon një kohë të gjatë, durim dhe kujdes, dhe nuk duhet të pretendojnë që me anë të disa leksioneve ose të disa mbledhjeve të ndryshojnë ideologjinë e të tjerëve që është formuar gjatë një jete prej dhjetra vjetësh. Për të bindur njerëzit, duhet përdorur arësyetimi e jo detyrimi. Detyrimi ka si rezultat vetëm nënshtrimin dhe jo bindjen. Njerëzit nuk mund të binden me anë të forcës. Kjo metodë mund të përdoret ndaj

armikut, por në asnjë mënyrë ndaj shokëve dhe miqve.

«Fjala e mbajtur në konferencën kombëtare të Partisë Komuniste të Kinës mbi punën e propagandës» (12 mars 1957).

Duhet bërë një dallim i qartë midis njerëzve tanë dhe armiqve. Ndaj shokëve nuk duhet të mbajmë qëndrim armiqësor dhe t'i trajtojmë ata si armiq. Ne duhet të flasim duke u nisur nga dëshira e zjarrtë për mbrojtjen e çështjes së popullit, për ngritjen e ndërgjegjes së tij dhe jo të përdorim tallje e sulme.

Po aty.

XIV. MARRËDHËNIET MIDIS USHTRISË DHE POPULLIT

Ushtria duhet të shkrihet me popullin, në mënyrë që populli të shikojë tek ajo ushtrinë e vet. Një ushtri e tillë do të jetë e pathyeshme. . .

«Mbi luftën e gjatë» (maj 1938),
Vepra të zgjedhura, vëll. 2.

Duhet që çdo shok të kuptojë se, derisa të mbështetemi tek populli, të kemi besim të patundur në forcat krijuese të pashtershme të masave popullore dhe, si rrjedhim, t'i besojmë popullit dhe të shkrihemi me të, ne do të mund të kapërcejmë çdo vështirësi dhe asnjë armik nuk do të mu-

ndë të na mposhtë, ndërsa ne do të mposhtim çdo armik.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Kudo që të shkojnë, shokët tanë duhet të vendosin marrëdhënie të mira me masat, të tregojnë kujdes për to dhe t'i ndihmojnë në kapërcimin e vështirësive. Ne duhet të bashkojmë rreth vehtes masat e gjera popullore, dhe sa më shumë aq më mirë do të jetë.

«Mbi bisedimet e Çuncinit» (17 tetor 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Në zonat e çliruara, nga njëra anë, ushtria duhet të përkrahë organet e pushtetit dhe të kujdeset për popullin, nga ana tjetër, organet e pushtetit demokratik duhet të udhëheqin popullin në punën që ai bën për të përkrahur ushtrinë dhe për të favorizuar familjet e luftëtarëve të

Rezistencës, në mënyrë që të përmirësohen edhe më shumë marrëdhëniet midis ushtrisë dhe popullit.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Në ushtri ne duhet të bëjmë punë ideologjike me të gjithë komandantët e luftëtarët, në mënyrë që ata të kuptojnë plotësisht se sa e rëndësishme është të përkrahësh organet e pushtetit dhe të kujdesesh për popullin. Në qoftë se ushtria e kryen mirë këtë detyrë, edhe marrëdhëniet e autoriteteve lokale dhe të popullit me ushtrinë do të përmirësohen.

«Orientimi i punës sonë në krahinat e çliruara për vitin 1946» (15 dhjetor 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Gjatë fushatave të përkrahjes së organeve të pushtetit dhe të kujdesit për popullin, të përkrahjes së ushtrisë dhe të

favorizimeve për familjet e luftëtarëve të Rezistencës, ushtria, nga njëra anë, dhe organet e partisë e të pushtetit, nga ana tjetër, duhet të shqyrtojnë në mënyrë të gjithanshme të metat e gabimet e tyre të bëra në vitin 1943 dhe t'i ndreqin me vendosmëri në vitin 1944. Në të ardhmen, në muajin e parë të çdo viti sipas kalendarit të hënës, duhet të organizohen kudo të tilla fushata, gjatë të cilave të lexohen kohë pas kohe zotimet lidhur me përkrahjen e organeve të pushtetit dhe kujdesin për popullin si dhe me përkrahjen e ushtrisë dhe favorizimet për familjet e luftëtarëve të Rezistencës; duhet të bëhet herë pas here autokritikë e hapur përpara masave për të metat e gabimet që janë konstatuar në bazat mbështetëse: qëndrimi arrogant e arbitrar i reparteve ushtarake të veçanta ndaj organeve të partisë dhe të pushtetit si dhe ndaj popullit, kujdesi i pamjaftueshëm për ushtrinë nga ana e organeve të partisë dhe të pushtetit si dhe nga ana e popullit (secila palë të kritikojë vetëm vehten e

saj dhe jo palën tjetër), dhe të ndreqen plotësisht këto të meta dhe gabime.

> «Të zhvillojmë në bazat mbështetëse lëvizjet për uljen e qirasë së tokës dhe për shtimin e prodhimit, për përkrahjen e organeve të pushtetit dhe kujdesin për popullin» (1 tetor 1943), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

XV. DEMOKRACIA NË TRI FUSHAT KRYESORE

Në ushtri duhet zbatuar në një masë të caktuar demokratizimi; kryesorja është të zhduket praktika feudale e rrahjeve dhe sharjeve dhe të arrihet që oficerët dhe ushtarët në jetën e tyre të përditshme të ndajnë midis tyre gëzimet dhe hidhërimet. Kështu do të arrihet qëllimi — uniteti midis oficerëve dhe ushtarëve, do të rritet pa masë aftësia luftarake e ushtrisë dhe ne s'do të kemi frikë se nuk do të rezistojmë dot në këtë luftë të gjatë dhe të ashpër.

«Mbi luftën e gjatë» (maj 1938),
Vepra të zgjedhura, vëll. 2.

Me gjithë kushtet materiale aq të vështira dhe luftimet aq të shpeshta, Ushtria e Kuqe vazhdon të qëndrojë e patundur, dhe

kjo shpjegohet jo vetëm me rolin e partisë, por edhe me faktin që në ushtri është vënë në jetë demokracia. Oficerët nuk i rrahin ushtarët, oficerët dhe ushtarët trajtohen në mënyrë të barabartë, ushtarët gëzojnë lirinë e mbledhjeve dhe të fjalës, janë anulluar formalitetet e tepruara, administrimi financiar bëhet me dijeninë e të gjithëve. . . . Në Kinë demokracia i duhet jo vetëm popullit, por edhe ushtrisë. Regjimi demokratik në ushtri përbën një armë të rëndësishme për të thyer ushtrinë mercenare feudale.

«Lufta në malet Cinganshan» (25 nëndor 1928), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Orientimi për punën politike në repartet ushtarake është që të mobilizohen plotësisht masa e ushtarëve, komandantët dhe gjithë personeli punonjës, me qëllim që me një lëvizje demokratike nën një udhëheqje të centralizuar, të arrihen tri objektiva kryesore: uniteti politik i një shkalle të lartë, përmirësimi i kushteve të jetesës dhe ngritja e nivelit të teknikës dhe të taktikës

ushtarake. "Tre verifikimet" dhe "tri ndreqjet"*, që tani janë duke u zbatuar me entuziazëm në repartet tona ushtarake, kanë për qëllim arritjen e dy objektivave të para me metodat e demokracisë në fushën politike dhe ekonomike.

Demokraci në fushën ekonomike do të thotë që përfaqësuesve të zgjedhur nga ushtarët t'u sigurohet e drejta për të ndihmuar komandën e kompanisë (pa i kaluar kompetencat e saj) në punët e furnizimit dhe të ushqimit të kompanisë.

Demokraci në fushën ushtarake do të thotë që në stërvitje të përdoret metoda e mësimit reciprok si midis oficerëve e ushta-

---

* "Tre verifikimet" dhe "tri ndreqjet" përbënin një lëvizje të rëndësishme për konsolidimin e partisë dhe forcimin e edukimit ideologjik në ushtri; ato qenë zbatuar nga partia jonë në lidhje me reformën agrare gjatë Luftës Popullore Çlirimtare. Në organizatat lokale të partisë "tre verifikimet" kishin të bënin me prejardhjen klasore, ideologjinë dhe stilin në punë; në ushtri — me prejardhjen klasore, kryerjen e punës dhe vullnetin luftarak. "Tri ndreqjet" donin të thoshin forcim organizativ, forcim i edukimit ideologjik dhe përmirësim i stilit në punë.

rëve ashtu dhe midis vetë ushtarëve; në kohën e luftimeve kompanitë e vijës së parë të zhvillojnë mbledhje të ndryshme, të mëdha ose të vogla. Nën drejtimin e komandës së kompanisë, të aktivizohen ushtarët për të diskutuar se si duhen sulmuar dhe marrë pozicionet e armikut dhe si duhen kryer detyrat e tjera luftarake. Kur luftimi vazhdon për disa ditë me radhë, duhet të mbahen disa herë mbledhje të tilla. Kjo formë e demokracisë në fushën ushtarake u praktikua gjatë betejës së Panlunit në pjesën veriore të provincës Shensi dhe në betejën e Shicjaçzhuanit në krahinën Shansi-Çahar-Hëbej dhe u arritën rezultate jashtëzakonisht të mëdha. Është provuar se kjo praktikë ka vetëm anë pozitive dhe asnjë anë negative.

«Lëvizja demokratike në ushtri» (30 janar 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Në luftën e madhe që po zhvillohet, Partia Komuniste e Kinës kërkon që të gjitha organet e saj udhëheqëse, të gjithë anëtarët

dhe kuadrot e saj të tregojnë aktivitet të lartë, sepse vetëm kështu ajo mund të arrijë fitoren. Zhvillimi i aktivitetit duhet të gjejë shprehjen e vet konkrete në aftësinë krijuese të organeve udhëheqëse, të kuadrove dhe të gjithë anëtarëve të partisë, në ndjenjën e tyre të përgjegjësisë, në dinamizmin e tyre në punë, në guximin dhe zotësinë e tyre për të shtruar probleme, për të çfaqur mendime, për të kritikuar të metat si dhe në ushtrimin e kontrollit mbi organet më të larta dhe kuadrot drejtuese, duke u nisur nga kujdesi për to. Pa këto, ai që ne quajmë aktivitet do të mbetej një fjalë boshe. Dhe zhvillimi i këtij aktiviteti varet nga demokratizimi i jetës së brendshme të partisë. Po të mungojë jeta demokratike në parti, është e pamundur të zhvillohet aktiviteti. Pregatitja e një numri të madh kuadrosh të afta është e mundur vetëm në kushtet e jetës demokratike.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Kushdo, mjafton që të mos jetë element armik dhe të mos ndërmarrë sulme keqdashëse, duhet lejuar të shprehet, s'ka gjë edhe në qoftë se ai flet gabim. Drejtuesit e të gjitha instancave kanë për detyrë të dëgjojnë kur flasin të tjerët. Për këtë duhen zbatuar dy parime: 1) Po e dite, folë; po fole, thuaji të tëra; 2) mos e qorto atë që flet; po të dëgjosh, do të mësosh. Në qoftë se nuk respektohet parimi "mos e qorto atë që flet" dhe në qoftë se ky parim nuk pranohet me të vërtetë, por sa për formë, është e pamundur të zbatohet në mënyrë të efektshme parimi "po e dite, folë; po fole, thuaji të tëra".

«Detyrat e vitit 1945» (15 dhjetor 1944).

Në parti duhet bërë një punë edukative në lidhje me demokracinë e brendshme, në mënyrë që anëtarët e partisë të kuptojnë ç'është jeta demokratike, ç'lidhje ka midis demokracisë e centralizmit dhe si zbatohet centralizmi demokratik. Vetëm në këtë

mënyrë ne do të kemi mundësi, nga njëra anë, të zgjerojmë me të vërtetë jetën demokratike në parti dhe, nga ana tjetër, t'i shmangemi ultrademokratizmit dhe çthurjes liberale, që cënon disiplinën.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Si në ushtri, ashtu edhe në organizatat lokale, demokracia e brendshme e partisë duhet të ketë për qëllim forcimin e disiplinës dhe ngritjen e aftësisë luftarake, dhe jo dobësimin e tyre.

Po aty.

Në lëmin e teorisë, të shkulen rrënjët e ultrademokratizmit. Para së gjithash duhet vënë në dukje se rreziku i ultrademokratizmit qëndron në dëmtimin e organizatave të partisë deri në shkatërrimin e tyre të plotë, në dobësimin e aftësisë luftarake të partisë deri në zhdukjen e saj të plotë, gjë që e bën partinë të paaftë për kryerjen e detyrave

luftarake, duke shkaktuar kështu disfatën e revolucionit. Përveç kësaj, duhet vënë në dukje se ultrademokratizmi e ka burimin në çthurjen liberale mikroborgjeze. Duke depërtuar në parti, kjo çthurje liberale ushqen idetë ultrademokratike në fushën politike dhe organizative. Këto ide janë krejtësisht të papajtueshme me detyrat luftarake të proletariatit.

«Mbi ndreqjen e mendimeve të gabuara në parti» (dhjetor 1929), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

XVI. ARËSIMI DHE STËRVITJA

Politika jonë në fushën e arësimit duhet t'u sigurojë zhvillimin nga pikëpamja morale, mendore dhe fizike atyre që e marrin arësimin, në mënyrë që ata të bëhen punonjës me ndërgjegje socialiste dhe me kulturë.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Përsa i përket edukimit të kuadrove që i vazhdojnë studimet pa u shkëputur nga puna ose në institucionet mësimore të kuadrove, duhet të ndiqet një politikë që të vërë në qendër studimin e çështjeve praktike të revolucionit kinez dhe që si udhë-

heqje të ketë parimet themelore të marksizëm-leninizmit, dhe të hidhet poshtë metoda e studimit të marksizëm-leninizmit në mënyrë statike dhe të shkëputur nga jeta.

«Të riorganizojmë mësimin tonë» (maj 1941), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Për një shkollë ushtarake, problemet më të rëndësishme janë zgjedhja e komandantit të shkollës, e instruktorëve dhe përpunimi i kursit mësimor.

«Çështje të strategjisë së luftës revolucionare në Kinë» (dhjetor 1936), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Në rast se në një shkollë me njëqind veta nuk ka një grup drejtues të formuar në përputhje me kushtet reale (e jo të sajuar) dhe të përbërë nga disa njerëz, deri në dhjetë ose më shumë, nga elementët më aktivë, më të ndershëm dhe më të shkathët ndërmjet pedagogëve, punonjësve

dhe nxënësve, kjo shkollë me siguri nuk do të funksionojë mirë.

«Disa çështje në lidhje me metodat e udhëheqjes» (1 qershor 1943), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Të gjithë komandantët dhe luftëtarët e ushtrisë sonë duhet të perfeksionojnë artin ushtarak, të marshojnë përpara me guxim në luftën ngadhnjimtare dhe t'i asgjësojnë të gjithë armiqtë vendosmërisht, përfundimisht, rrënjësisht e plotësisht.

«Manifest i Ushtrisë Popullore Çlirimtare Kineze» (tetor 1947), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Në programin njëvjeçar të stërvitjes dhe konsolidimit që porsa ka filluar, duhet t'i jepet e njëjta rëndësi si anës ushtarake, ashtu dhe anës politike. Këto dy anë duhet të kombinohen. Në fillim, theksi duhet vënë mbi anën politike, veçanërisht mbi përmirësimin e marrëdhënieve midis oficerëve dhe ushtarëve, mbi forcimin e unitetit të brendshëm dhe mbi aktivizimin

sa më të madh të kuadrove dhe të masave të luftëtarëve. Vetëm kështu konsolidimi dhe stërvitja ushtarake mund të zhvillohen më lehtë dhe me rezultate më të mira.

«Detyrat e vitit 1945» (15 dhjetor 1944).

Lidhur me metodën e stërvitjes ushtarake, ne duhet të zhvillojmë një lëvizje masive, gjatë së cilës oficerët të mësojnë ushtarët, ushtarët të mësojnë oficerët dhe ushtarët të mësojnë njëri tjetrin.

«Orientimi i punës sonë në krahinat e çliruara për vitin 1946» (15 dhjetor 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Parulla jonë në stërvitjen ushtarake është: "Oficerët të mësojnë ushtarët, ushtarët të mësojnë oficerët dhe ushtarët të mësojnë njëri tjetrin". Ushtarët kanë përvojën e madhe praktike të luftës. Oficerët duhet të mësojnë nga ushtarët; duke

përvehtësuar përvojën e të tjerëve, ata do të bëhen më të aftë.

«Bisedë me redaktorët e gazetës *Cinsujzhibao*» (2 prill 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Në programin e stërvitjes ushtarake qëllimi ynë mbetet në radhë të parë që të ngrihet niveli teknik i qitjes, i luftimit me bajonetë, i hedhjes së granatave etj., dhe së dyti, të ngrihet niveli i taktikës, duke u dhënë një rëndësi të posaçme ushtrimeve të zhvillimit të luftimeve natën.

«Orientimi i punës sonë në krahinat e çliruara për vitin 1946» (15 dhjetor 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

XVII. T'I SHËRBEJMË POPULLIT

Ne duhet të jemi modestë dhe të matur, të ruhemi nga mendjemadhësia e gjaknxehtësia dhe t'i shërbejmë popullit kinez me gjithë zemër . . .

«Dy fatet e Kinës» (23 prill 1945),
Vepra të zgjedhura, vëll. 4.

T'i shërbejmë popullit me gjithë zemër, pa u shkëputur për asnjë çast nga masat; në çdo gjë të nisemi nga interesat e popullit dhe jo nga interesat personale ose interesat e një grupi të vogël; përgjegjësinë përpara popullit dhe përgjegjësinë përpara organeve udhëheqëse të partisë ta

shikojmë si një gjë të vetme — ja, kjo është pikënisja jonë.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura,* vëll. 4.

Organet shtetërore zbatojnë centralizmin demokratik, ato duhet të mbështeten mbi masat popullore, punonjësit e tyre duhet t'i shërbejnë popullit.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Fryma e vetëmohimit të plotë dhe e gadishmërisë së përhershme për t'u shërbyer të tjerëve, e cila karakterizonte shokun Betyn, gjeti shprehjen e saj në ndjenjën e përgjegjësisë së tij më të thellë për punën dhe në dashurinë e tij më të zjarrtë për shokët dhe për popullin. Çdo komunist duhet ta marrë atë si shembull.

. . . . . .

Të gjithë ne duhet të mësojmë nga fryma e tij e devotshmërisë së pakufishme. Kushdo

që pajiset me këtë frymë, mund të bëhet shumë i dobishëm për popullin. Njeriu mund të ketë aftësi të mëdha ose të vogla, por në qoftë se është i pajisur me këtë frymë, ai është njeri fisnik, njeri i dlirë, njeri me moral të lartë, njeri i çliruar nga interesat e ulta, njeri i dobishëm për popullin.

«Kujtimit të Norman Betynit» (21 dhjetor 1939), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 3.

Partia jonë Komuniste, si dhe Armata e 8-të e Korpusi i 4-të i Ri, që udhëhiqen prej saj, janë ushtria e revolucionit. Kjo ushtri i kushtohet tërësisht çlirimit të popullit dhe punon plotësisht për interesat e tij.

«T'i shërbejmë popullit» (8 shtator 1944), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Të gjitha kuadrot tona, në çfarëdo post qofshin, janë shërbëtorë të popullit. Çdo

gjë që bëjmë ne i shërben popullit. Pra a do të kishte gjë të keqe, nga e cila ne nuk do të donim të hiqnim dorë?

«Detyrat e vitit 1945» (15 dhjetor 1944).

Është detyra jonë të mbajmë përgjegjësi përpara popullit. Çdo fjalë, çdo veprim dhe çdo masë politike duhet t'u përgjigjet interesave të popullit. Në qoftë se janë bërë gabime, ato duhen ndrequr patjetër, kësaj i thonë të mbajmë përgjegjësi përpara popullit.

«Gjendja dhe politika jonë pas fitores në Luftën e Rezistencës kundër Japonisë» (13 gusht 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Në luftë gjithmonë ka sakrifica, edhe vdekja është një gjë që ndodh shpesh. Por ne vdesim për popullin, duke pasur në zemër interesat e tij dhe vuajtjet e shumicës së madhe të tij, dhe kjo është një vdekje kuptimplote. Megjithatë, ne duhet t'i pa-

kësojmë sa të jetë e mundur më shumë sakrificat e panevojshme.

«T'i shërbejmë popullit» (8 shtator 1944), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Kushdo do të vdesë një ditë, por nuk kanë të gjitha vdekjet një kuptim. Në kohën e lashtë në Kinë ishte një shkrimtar që quhej Sima Cjan, i cili ka thënë: "Sigurisht, çdo njeri ka për të vdekur, mirëpo ka vdekje që peshon më rëndë se mali i Tajshanit, ka edhe vdekje që peshon më lehtë se një pupël". Vdekja për interesat e popullit peshon më rëndë se mali i Tajshanit, kurse vdekja në shërbim të fashistëve, për shfrytëzuesit, për shtypësit e popullit peshon më lehtë se një pupël.

Po aty.

XVIII. PATRIOTIZMI DHE INTERNACIONALIZMI

A mundet një komunist, si internacionalist, të jetë njëkohësisht edhe patriot? Ne mendojmë se jo vetëm që mundet, por edhe duhet të jetë. Përmbajtja konkrete e patriotizmit përcaktohet nga kushtet historike. Ekziston "patriotizmi" i agresorëve japonezë dhe i Hitlerit, ekziston edhe patriotizmi ynë. Komunistët duhet të shprehen me vendosmëri kundër të ashtuquajturit "patriotizëm" të agresorëve japonezë dhe të Hitlerit. Komunistët japonezë dhe gjermanë janë për disfatën e vendeve të tyre në luftë. Është në interes të popujve japonez dhe gjerman të ndihmojnë me të gjitha mjetet që lufta e agresorëve japonezë dhe e Hitlerit të pësojë disfatë, dhe sa më e plotë të jetë kjo disfatë, aq më mirë do

të jetë. . . . Sepse këto luftëra, që bëjnë agresorët japonezë dhe Hitleri, janë në dëm jo vetëm të popujve të tjerë të botës, por edhe të popujve të vendeve të tyre. Ndryshe është gjendja e Kinës që ka rënë viktimë e agresionit. Prandaj komunistët kinezë duhet ta kombinojnë patriotizmin me internacionalizmin. Ne jemi internacionalistë dhe njëkohësisht patriotë. Parulla jonë është të luftojmë për mbrojtjen e Atdheut kundër agresorëve. Për ne disfatizmi është krim; të luftojmë për fitoren në Luftën e Rezistencës kundër Japonisë është detyra jonë e padiskutueshme, sepse vetëm duke luftuar për mbrojtjen e Atdheut mund të shpartallojmë agresorët dhe të arrijmë çlirimin kombëtar, dhe vetëm me çlirimin kombëtar bëhet i mundshëm çlirimi i proletariatit dhe i gjithë popullit punonjës. Fitorja e Kinës dhe shpartallimi i imperialistëve, që shpërthyen agresionin kundër Kinës, do të jenë njëkohësisht edhe një ndihmë për popujt e vendeve të tjera. Prandaj patriotizmi është

zbatimi i internacionalizmit në luftën nacional-çlirimtare.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Një i huaj, pa qenë i shtyrë nga ndonjë qëllim egoist, e bëri të tijën çështjen e çlirimit të popullit kinez. Ç'është kjo frymë? Kjo është fryma e internacionalizmit, fryma e komunizmit, nga e cila duhet të mësojë çdo komunist kinez. . . . Ne duhet të bashkohemi me proletariatin e të gjitha vendeve kapitaliste, me atë të Japonisë, Anglisë, Shteteve të Bashkuara, Gjermanisë, Italisë, si dhe të të gjitha vendeve të tjera kapitaliste; vetëm kështu mund të përmbyset imperializmi dhe të arrihet çlirimi i kombit dhe popullit tonë, çlirimi i kombeve dhe popujve të tjerë të botës. I tillë është internacionalizmi ynë, me ndihmën e këtij internacionalizmi ne luftojmë si kundër nacionalizmit të ngushtë, ashtu dhe kundër patriotizmit të ngushtë.

«Kujtimit të Norman Betynit» (21 dhjetor 1939), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 3.

Për të arritur çlirimin e plotë, popujt e shtypur duhet të mbështeten para së gjithash në luftën e tyre, dhe vetëm pastaj në ndihmën ndërkombëtare. Popujt që kanë arritur fitoren në revolucion, duhet t'i ndihmojnë popujt që janë duke luftuar për çlirimin e tyre. Kjo është detyra jonë internacionaliste.

Bisedë me miqtë afrikanë (8 gusht 1963).

Vendet socialiste janë shtete të një tipi krejtësisht të ri, ku klasat shfrytëzuese janë përmbysur dhe populli punonjës ka marrë pushtetin në dorë. Në marrëdhëniet midis këtyre vendeve zbatohet parimi i unitetit të internacionalizmit me patriotizmin. Ne na lidhin ngushtë interesat e përbashkëta dhe ideali i përbashkët.

«Fjala e mbajtur në sesionin jubilar të Sovjetit Suprem të BRSS me rastin e 40-vjetorit të Revolucionit të madh socialist të Tetorit» (6 nëndor 1957).

Popujt e kampit socialist duhet të bashkohen, popujt e vendeve të Azisë, Afrikës dhe Amerikës Latine duhet të bashkohen, popujt e të gjitha kontinenteve duhet të bashkohen, të gjitha vendet paqedashëse duhet të bashkohen, të gjitha vendet viktima të agresionit, kontrollit, ndërhyrjes dhe arbitraritetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës duhet të bashkohen dhe të formojnë një front unik sa më të gjerë kundër politikës së agresionit e të luftës të imperializmit amerikan dhe për mbrojtjen e paqes në botë.

«Deklaratë në përkrahje të luftës së drejtë patriotike të popullit panamez kundër imperializmit amerikan» (12 janar 1964).

Çdo gjë zhvillohet pa ndërprerje. Deri tani kanë kaluar vetëm 45 vjet që nga Revolucioni i vitit 1911 dhe pamja e Kinës ka ndryshuar krejtësisht. Pas 45 vjetësh të tjerë, domethënë në vitin 2001, ose në fillim të shekullit XXI, pamja e Kinës do të ketë pësuar ndryshime edhe më të mëdha.

Kina do të bëhet një vend socialist i fuqishëm industrial. Dhe ajo duhet të bëhet një vend i tillë. Meqë Kina është një vend me një sipërfaqe prej 9.600.000 kilometrash katrore dhe me 600 milion banorë, ajo duhet t'i japë njerëzimit një kontribut relativisht të madh. Por ky kontribut për një periudhë të gjatë ka qenë shumë i vogël. Neve na vjen keq për këtë.

Por ne duhet të jemi modestë. Duhet të jemi të tillë jo vetëm tani, por edhe pas 45 vjetësh e kurdoherë. Në marrëdhëniet ndërkombëtare, kinezët duhet të zhdukin shovinizmin e shtetit të madh vendosmërisht, përfundimisht, rrënjësisht e plotësisht.

«Kujtimit të Dr. Sun Jat-senit»
(nëndor 1956).

Ne nuk duhet të mbajmë në asnjë mënyrë qëndrim arrogant të shovinizmit të shtetit të madh dhe nuk duhet të bëhemi në asnjë rast mendjemëdhenj për shkak të fitores në revolucion dhe të disa sukseseve të arritura në ndërtim. Çdo shtet, i madh

ose i vogël qoftë, ka të mirat dhe dobësitë e tij.

«Fjala e hapjes në Kongresin e 8-të të Partisë Komuniste të Kinës» (15 shtator 1956).

XIX. HEROIZMI REVOLUCIONAR

Kjo ushtri marshon kurdoherë përpara. Ajo do të mposhtë çdo armik, kurse vetë nuk do të thyhet kurrë nga armiku. Në çfarëdo rrethanash të vështira e plot mundime, edhe sikur të mbetet një njeri i vetëm, ai do të vazhdojë të luftojë.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Të zhvillojmë stilin tonë — trimëri në luftë, të mos u trembemi sakrificave dhe lodhjes, qëndresë në luftime të vazhdueshme (domethënë në luftimet e zhvilluara njëri

pas tjetrit brenda një kohe të shkurtër dhe pa u çlodhur).

«Gjendja e sotme dhe detyrat tona» (25 dhjetor 1947), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Mijëra e mijëra dëshmorë kanë dhënë heroikisht jetën e tyre për interesat e popullit. Le ta mbajmë lart flamurin e tyre dhe të shkojmë përpara në rrugën e skuqur me gjakun e tyre!

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Të jemi të vendosur, të mos i trembemi asnjë sakrifice, të kapërcejmë çdo vështirësi për të korrur fitoren.

«Y Guni tundi malet nga vendi» (11 qershor 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

. . . Në çastin kritik të zhvillimit të Ekspeditës drejt Veriut, fronti kombëtar

unik i Gomindanit, Partisë Komuniste dhe shtresave të ndryshme të popullsisë, front, i cili përfaqësonte çështjen e çlirimit të popullit kinez, u prish, si edhe të gjitha parimet e tij politike revolucionare, për shkak të politikës antipopullore dhe tradhëtare të "spastrimit të partisë" dhe të masakrimeve, të ndjekur nga autoritetet e Gomindanit. . . . Pas kësaj, vendin e unitetit e zuri lufta civile, vendin e demokracisë — diktatura, vendin e Kinës së ndritur — një Kinë e errësuar. Por Partia Komuniste e Kinës dhe populli kinez nuk u frikësuan, nuk u nënshtruan dhe nuk u çfarosën. Ata u ngritën më këmbë, fshinë gjakun, varrosën shokët e rënë dhe vazhduan luftën. Ata mbajtën lart flamurin e madh të revolucionit dhe bënë rezistencë të armatosur. Në krahina të gjera të Kinës ata ngritën pushtetin e popullit, zbatuan reformën agrare, krijuan ushtrinë e popullit — Ushtrinë e Kuqe Kineze, ruajtën dhe zhvilluan forcat revolucionare të popullit kinez.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Ju keni shumë cilësi të mira, keni merita të mëdha, por duhet të mbani mend kurdoherë një gjë: të mos ju rritet mendja. Ju nderoheni nga të gjithë, dhe këtë e meritoni, por kjo mund t'i japë shkas fare lehtë mendjemadhësisë. Në qoftë se juve do t'ju rritet mendja, në qoftë se ju nuk do të jeni modestë, nuk do të bëni më përpjekje, nuk do t'i respektoni të tjerët, nuk do të respektoni kuadrot dhe masat, — atëherë ju nuk do të jeni më heronj dhe punonjës shembullorë. Në të kaluarën ka pasur disa njerëz të tillë, unë shpresoj se ju nuk do të ndiqni shembullin e tyre.

«Të mësohemi të punojmë në lëmin e ekonomisë» (10 janar 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Në luftën për likuidimin e armikut, për rimëkëmbjen dhe zhvillimin e prodhimit industrial e bujqësor, ju keni kapërcyer vështirësi të shumta, keni treguar guxim, zgjuarsi dhe aktivitet shumë të madh. Ju jeni shembull për mbarë kombin kinez, jeni kollona vertebrare që e çon triumfalisht përpara çështjen e popullit në fusha të

ndryshme, një mbështetje e sigurtë e qeverisë popullore dhe një urë që e lidh atë me masat e gjera popullore.

Përshëndetje drejtuar konferencës kombëtare të përfaqësuesve të Heronjve të Luftës dhe të punonjësve shembullorë në emër të KQ të PKK (25 shtator 1950).

Kombi kinez ka vullnet të fortë për të luftuar kundër armikut deri në pikën e fundit të gjakut; ai është i vendosur të rifitojë me forcat e veta atë që ka humbur dhe i aftë të qëndrojë me këmbët e veta në një radhë me kombet e tjera të botës.

«Mbi taktikën e luftës kundër imperializmit japonez» (27 dhjetor 1935), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

XX. DASHURIA PËR PUNËN DHE FRYMA E KURSIMIT NË NDËRTIMIN E VENDIT

Duhet që të gjitha kuadrot dhe gjithë populli të kenë vazhdimisht parasysh që vendi ynë është një vend i madh socialist, por njëkohësisht edhe një vend i varfër dhe i prapambetur ekonomikisht. Kjo përbën një kontradiktë të madhe. Që vendi ynë të bëhet i begatshëm dhe i fuqishëm, duhen disa dhjetra vjet përpjekjesh këmbëngulëse, duke përfshirë këtu edhe zbatimin e orientimit lidhur me dashurinë për punën dhe frymën e kursimit në ndërtimin e vendit, domethënë vendosjen e një regjimi të rreptë kursimi dhe luftën kundër shpenzimeve të kota.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Parimi i dashurisë për punën dhe i frymës së kursimit duhet zbatuar në çdo punë, qoftë në drejtimin e fabrikave, dyqaneve, ndërmarrjeve shtetërore e kooperativiste apo të sektorëve të tjerë. Ky është parimi i kursimit, i cili përbën një nga parimet themelore të ekonomisë socialiste. Kina është një vend i madh, por sot është akoma shumë e varfër dhe do të duhen disa dhjetra vjet që ajo të bëhet e begatshme. Bile edhe atëherë duhet zbatuar parimi i dashurisë për punën dhe i frymës së kursimit. Por sidomos gjatë këtyre dhjetra vjetëve dhe gjatë këtyre pesëvjeçarëve, duhet zhvilluar fryma e dashurisë për punën dhe i duhet kushtuar vëmendje regjimit të kursimit.

Shënim mbi artikullin «Dashuria për punën dhe fryma e kursimit në drejtimin e kooperativave» (1955), *Hovi i socializmit në fshatin kinez.*

Duhet të kursehen kudo dhe me çdo mënyrë burimet njerëzore dhe materiale; në asnjë mënyrë nuk duhet jetuar vetëm me

të sotmen, nuk duhet lejuar që burimet tona të harxhohen pa vend dhe të shkojnë kot. Në çdo vend, qysh në vitin e parë të punës, duhet medoemos të bëhet llogari për shumë vjet të ardhshëm, duke marrë parasysh luftën e gjatë, kundërmësymjen dhe ndërtimin që do të fillojë pas dëbimit të armikut. Duhet, nga njëra anë, që në asnjë rast të mos lejohen harxhime pa vend dhe shpenzime të tepërta dhe, nga ana tjetër, të bëhen të gjitha përpjekjet për zhvillimin e prodhimit. Në të kaluarën disa krahina e paguan shtrenjt mungesën e një pune me perspektivë, pakujdesinë e tyre si në kursimin e burimeve njerëzore e materiale, ashtu dhe në zhvillimin e prodhimit. Ky mësim tani duhet të tërheqë vëmendjen e të gjithëve.

«Të mësohemi të punojmë në lëmin e ekonomisë» (10 janar 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Me qëllim që të shpejtohet rimëkëmbja dhe zhvillimi i prodhimit bujqësor, si dhe i prodhimit industrial në qytete të vogla ne, gjatë luftës për zhdukjen e sistemit feu-

dal, duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet për të ruajtur në maksimum të gjitha mjetet e prodhimit dhe mjetet e jetesës që mund të hyjnë në përdorim, të marrim masa për një luftë të vendosur kundër kujtdo që dëmton ose shpërdoron mjetet e prodhimit dhe mjetet e jetesës, të luftojmë kundër shpenzimeve të tepërta në të ngrënë e të pirë dhe t'i kushtojmë vëmendje regjimit të kursimit.

«Fjala e mbajtur në konferencën e kuadrove të krahinës së çliruar Shansi-Sujuan» (1 prill 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Shpenzimet financiare duhet të mbështeten mbi parimin e kursimit. Duhet që të gjithë punonjësit e organeve të pushtetit ta kuptojnë se përvehtësimet dhe shpërdorimet janë krime shumë të rënda. Lufta kundër përvehtësimeve dhe shpërdorimeve në të kaluarën ka dhënë disa rezultate, por këto përpjekje duhen vazhduar edhe në të ardhmen. Të kursejmë çdo qindarkë për nevojat e luftës dhe të revolucionit, për

ndërtimin tonë ekonomik — ky është parimi i kontabilitetit tonë.

«Politika jonë ekonomike» (23 janar 1934), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Tek shumë nga kuadrot tona sot po rriten tendenca të rrezikshme, që shprehen në mungesën e dëshirës për të ndarë me masat gëzimet dhe hidhërimet, në pretendimin dhe synimin për lavdi dhe për interesin personal. Kjo është një gjë shumë e keqe. Gjatë lëvizjes për shtimin e prodhimit dhe për regjimin e kursimit, ne kërkojmë thjeshtimin e aparatit, dërgimin e kuadrove në bazë, kthimin e një numri të konsiderueshëm kuadrosh në prodhim. Kjo është një nga metodat për kapërcimin e kësaj tendence të rrezikshme.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Vetëfurnizimi i ushtrisë me anën e zhvillimit të prodhimit jo vetëm që ka përmirë-

suar kushtet e jetesës së saj, ka lehtësuar barrën e popullit dhe jep kështu mundësi për të shtuar efektivin e ushtrisë, por edhe ka sjellë menjëherë shumë rezultate plotësuese. Këto rezultate janë:

1) Përmirësimi i marrëdhënieve midis oficerëve dhe ushtarëve. Duke punuar sëbashku në prodhim, ata afrohen me njëri tjetrin si vëllezër.

2) Forcimi i dashurisë për punën. . . . Që kur filloi veprimtaria prodhuese e ushtrisë për vetëfurnizimin e saj, është shtuar dashuria për punën dhe janë zhdukur veset që karakterizojnë rrugaçët.

3) Forcimi i disiplinës. Vendosja e disiplinës së punës në veprimtarinë prodhuese jo vetëm nuk e dobëson, por edhe e forcon disiplinën luftarake dhe disiplinën e ushtarakëve në jetën e përditshme.

4) Përmirësimi i marrëdhënieve midis ushtrisë dhe popullit. Që kur repartet ushtarake kanë krijuar ekonominë e tyre, rastet e cënimit të pasurisë së popullit janë bërë më të pakta ose janë zhdukur fare. Në procesin e prodhimit ushtria

dhe populli ndihmojnë njëri tjetrin në punë, gjë që i forcon edhe më shumë marrëdhëniet e tyre miqësore.

5) Janë bërë më të rralla ankesat e reparteve ushtarake ndaj organeve të pushtetit, janë përmirësuar marrëdhëniet midis ushtrisë dhe organeve të pushtetit.

6) Është nxitur fushata e madhe e popullit për zhvillimin e prodhimit. Kur ushtria merret me prodhim, bëhet edhe më e qartë për institucionet e ndryshme nevoja që të merren me prodhim, dhe ato i përvishen edhe më energjikisht kësaj pune; natyrisht, bëhet edhe më e qartë për gjithë popullin nevoja e përhapjes së fushatës për zhvillimin e prodhimit kudo dhe populli i përvishet edhe më energjikisht kësaj pune.

> «Mbi vetëfurnizimin e ushtrisë me anën e zhvillimit të prodhimit dhe mbi rëndësinë e lëvizjes për ndreqjen e stilit dhe të fushatës për shtimin e prodhimit» (27 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Disa thonë se kur repartet ushtarake merren me prodhim, ato nuk mund të luftojnë dhe të bëjnë stërvitje dhe se kur institucionet merren me prodhim, ato nuk mund ta kryejnë punën e tyre. Kjo nuk është e drejtë. Gjatë këtyre vjetëve të fundit, repartet tona ushtarake në Zonën Kufitare, duke u marrë me një veprimtari të gjerë prodhuese, kanë arritur ta furnizojnë vehten me sasi të bollshme ushqimi e veshmbathjeje dhe, krahas kësaj, janë marrë me stërvitjen ushtarake, me mësime politike dhe arësimin e përgjithshëm. Në të gjitha këto drejtime janë arritur suksese më të mëdha se më parë, kompaktësia e ushtrisë dhe uniteti midis ushtrisë e popullit janë forcuar akoma më shumë në krahasim me të kaluarën. Në front gjatë gjithë vitit të kaluar u përhap fushata e gjerë për zhvillimin e prodhimit, por në të njëjtën kohë u arritën suksese të mëdha në zhvillimin e veprimeve luftarake dhe filloi gjerësisht lëvizja e stërvitjes ushtarake. Si rezultat i zhvillimit të prodhimit, janë përmirësuar kushtet e jetesës së punonjësve

të · institucioneve, ata punojnë me vëmendje më të përqëndruar dhe me rezultate më të mira. Kështu ndodh si në Zonën Kufitare, ashtu edhe në front.

«Të mësohemi të punojmë në lëmin e ekonomisë» (10 janar 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

XXI. MBËSHTETJA NË FORCAT E VETA DHE LUFTA KËMBËNGULËSE

Mbi ç'bazë duhet të mbështetet politika jonë? Në forcën tonë, kjo do të thotë mbështetje në forcat e veta. Ne nuk jemi vetëm, të gjitha vendet dhe të gjithë popujt e botës që luftojnë kundër imperializmit janë miqtë tanë. Megjithatë, ne e theksojmë se duhet të mbështetemi në forcat tona. Duke u mbështetur në forcat që organizojmë, ne jemi në gjendje t'i mundim të gjithë reaksionarët kinezë e të huaj.

«Gjendja dhe politika jonë pas fitores në Luftën e Rezistencës kundër Japonisë» (13 gusht 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Ne jemi për mbështetjen në forcat e veta. Ne do të donim të merrnim ndihmë nga jashtë, por nuk mund të varemi nga kjo ndihmë. Ne mbështetemi në përpjekjet tona, në forcat krijuese të gjithë ushtrisë dhe popullit tonë.

«Të mësohemi të punojmë në lëmin e ekonomisë» (10 janar 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Arritja e fitores në gjithë vendin është vetëm hapi i parë i një marshimi të gjatë prej dhjetë mijë li. . . . Revolucioni kinez është një revolucion i madh, por pas fitores ne do të kemi një rrugë edhe më të gjatë, puna jonë do të jetë më e madhe dhe më e vështirë. Kjo duhet shpjeguar qartë që tani në parti, me qëllim që shokët të vazhdojnë të jenë modestë e të matur, të mos jenë mendjemëdhenj e gjaknxehtë në stilin e tyre të punës, që ata të ruajnë stilin e tyre të jetës së thjeshtë dhe të luftës këmbëngulëse.

«Raport në plenumin e dytë të Komitetit Qendror të zgjedhur nga Kongresi i 7-të i Partisë Komuniste të Kinës» (5 mars 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Ne duhet t'ua heqim krejtësisht nga mendja kuadrove tona çdo ide se mund të korrim fitore në saje të ndonjë të papriture ose të fatit, pa bërë një luftë këmbëngulëse, pa i paguar këto fitore me gjakun e djersën tonë.

> «Të krijojmë baza mbështetëse të shëndosha në Kinën Verilindore» (28 dhjetor 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Ne duhet t'i bëjmë vazhdimisht të njohura popullit përparimet e botës dhe perspektivat e saj të ndritura, me qëllim që t'i ngjallet besimi në fitore. Në të njëjtën kohë, ne duhet t'i tregojmë popullit dhe të gjithë shokëve se rruga jonë është me zigzage. Në rrugën e revolucionit ka akoma shumë pengesa e vështirësi. Kongresi i 7-të i partisë sonë ka parashikuar një numër të madh vështirësish; ne preferojmë të supozojmë sa më shumë vështirësi. Disa shokë nuk duan të mendojnë shumë për vështirësitë. Por vështirësitë në fakt ekzistojnë, ne duhet të njohim aq vështirësi, sa ka dhe jo të mbajmë "qëndrim mosnjo-

hës". Ne duhet t'i njohim vështirësitë, t'i analizojmë ato dhe të luftojmë kundër tyre. Në botë nuk ka rrugë të drejta, ne duhet të pregatitemi për të kaluar një rrugë me zigzage dhe të mos përpiqemi të fitojmë gjëra me pak shpenzime. As që mund të merret me mend që një mëngjes të bukur të gjithë reaksionarët të bien në gjunjë vetiu. Me një fjalë, e ardhmja është e ndritur, por rruga është me zigzage. Ne kemi përpara akoma shumë vështirësi, të cilat nuk duhet të mos i përfillim. Duke u bashkuar me gjithë popullin dhe duke bërë përpjekje të përbashkëta, ne do t'i kapërcejmë me siguri vështirësitë e shumta dhe do të korrim fitoren.

«Mbi bisedimet e Çuncinit» (17 tetor 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Kush sheh vetëm anën e ndritur dhe nuk vë re vështirësitë, nuk do të mundë të luftojë me sukses për realizimin e detyrave të partisë.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Pasuritë e shoqërisë krijohen nga vetë punëtorët, fshatarët dhe intelektualët punonjës. Në qoftë se marrin në dorë fatin e tyre, ndjekin një vijë marksiste-leniniste, nuk u shmangen problemeve, por i vihen aktivisht punës për zgjidhjen e tyre, ata do të përballojnë çdo vështirësi në botë.

Shënim mbi artikullin «Sekretari i partisë vihet në krye të detyrës dhe të gjithë anëtarët e partisë marrin pjesë në ngritjen e kooperativave» (1955), *Hovi i socializmit në fshatin kinez.*

Të gjithë shokët e partisë duhet t'i kenë parasysh plotësisht të gjitha vështirësitë dhe të jenë të gatshëm t'i kapërcejnë ato sistematikisht e me një vullnet të paepur. Forcat reaksionare kanë vështirësitë e tyre, ndërsa ne kemi tonat. Por vështirësitë e forcave reaksionare janë të pakapërcyeshme, sepse ato janë forca që po i afrohen vdekjes dhe që nuk kanë të ardhme. Vështirësitë tona mund të kapërcehen, sepse ne jemi forca

të reja në rritje dhe kemi të ardhme të ndritur.

«Të përshëndesim vrullin e ri të revolucionit kinez» (1 shkurt 1947), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Në çaste të vështira, shokët tanë duhet të shikojnë sukseset, duhet të shikojnë të ndriturën dhe të ngrejnë më lart trimërinë tonë.

«T'i shërbejmë popullit» (8 shtator 1944), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Çdo gjë e re zhvillohet duke ndjekur një rrugë të vështirë dhe me zigzage. Do të ishte një iluzion të mendohej se në çështjen e socializmit gjithshka mund të shkojë kurdoherë mbarë dhe të arrihen lehtë suksese, pa vështirësi e zigzage, pa përpjekje shumë të mëdha.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Në luftën revolucionare ka raste kur kushtet e vështira janë më të shumta se kushtet e favorshme. Në këto raste kushtet e vështira përbëjnë anën kryesore të kontradiktës, ndërsa kushtet e favorshme — anën e dorës së dytë. Por, me përpjekjet e revolucionarëve, mund të kapërcehen gradualisht vështirësitë e të krijohet një gjendje e re e favorshme, dhe atëherë gjendja e vështirë ja lëshon vendin gjendjes së favorshme.

«Mbi kontradiktën» (gusht 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Ç'është puna? Puna është luftë. Atje* ka vështirësi e probleme që neve na duhet t'i zgjidhim. Është pikërisht për të kapërcyer vështirësitë që ne vemi të punojmë e të luftojmë. Shok i mirë është ai që kërkon aq më tepër të vejë në një vend ku vështirësitë janë më të mëdha.

«Mbi bisedimet e Çuncinit» (17 tetor 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

---

* Atje — në front.

Ka një përrallë të lashtë kineze që quhet "Y Guni tundi malet nga vendi". Ajo tregon se në kohët e lashta, në Kinën Veriore, jetonte një plak i quajtur Y Gun (plaku budalla), nga malet e Veriut. Rrugën nga shtëpia e tij për në Jugë e prisnin dy male të mëdha — Tajhanshani dhe Vanushani. Y Guni vendosi që bashkë me djemtë e tij t'i shembte këto dy male duke i gërmuar me shata. Një tjetër plak, i quajtur Çi Sou (plaku i mençur), kur i pa, qeshi me të madhe e tha: "Sa budallenj që jeni, si punoni kështu! Është krejtësisht e pamundur që ju t'i shembni këto dy male". Y Guni iu përgjegj: "Mbasi të vdes unë, do të mbeten djemtë e mi, mbasi të vdesin djemtë do të mbeten nipërit, e kështu brez pas brezi pa mbarim. Këto dy male janë vërtet të larta, por më të larta se ç'janë s'mund të bëhen; sa më shumë të gërmojmë, aq më të ulta do të bëhen; e pse s'qenkemi në gjendje t'i rrafshojmë?" Si hodhi poshtë mendimin e gabuar të Çi Sout, Y Guni, pa u lëkundur aspak, vazhdoi punën duke i gërmuar malet ditë për ditë. Kjo e mallëngjeu perëndinë dhe ajo dërgoi në

tokë dy engjëj, të cilët i hoqën këto male. Tani mbi kurrizin e popullit kinez rëndojnë gjithashtu dy male të mëdha — njëri quhet imperializëm, tjetri feudalizëm. Partia Komuniste e Kinës ka vendosur prej kohësh t'i shembë këto dy male. Ne do të vazhdojmë përpjekjet tona dhe do të punojmë pa ndërprerje, edhe ne do ta mallëngjejmë perëndinë; dhe kjo perëndi s'është ndokush tjetër, por vetë masat e popullit kinez. Në qoftë se masat e popullit në mbarë vendin do të ngrihen më këmbë dhe do t'i gërmojnë këto dy male bashkë me ne, vallë a nuk do të mund t'i shembim?

«Y Guni tundi malet nga vendi» (11 qershor 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

XXII. METODA E TË MENDUARIT DHE METODA E PUNËS

Historia e njerëzimit është procesi i një zhvillimi të pandërprerë nga mbretëria e domosdoshmërisë drejt mbretërisë së lirisë. Dhe ky proces nuk ka për të mbaruar kurrë. Në shoqërinë ku ekzistojnë klasat, lufta e klasave s'ka mbarim. Në shoqërinë pa klasa, lufta midis së resë dhe së vjetrës, midis asaj që është e drejtë dhe asaj që është e gabuar s'merr fund kurrë. Gjatë luftës për prodhim dhe në eksperimentimin shkencor, njerëzimi ecën vazhdimisht përpara, edhe natyra zhvillohet pa ndërprerje, ata nuk do të ndalen kurrë në një nivel të caktuar. Prandaj njerëzimi duhet të përgjithësojë vazhdimisht eksperiencën e tij, të zbulojë, të shpikë, të krijojë dhe të ecë

përpara. Pikëpamjet e atyre që besojnë në teorinë e stanjacionit, që bien në pesimizëm, që vuajnë nga plogështia ose që tregojnë mendjemadhësi dhe vetëkënaqje, janë të gabuara. Këto pikëpamje janë të gabuara, sepse ato nuk përputhen me faktet historike të zhvillimit të shoqërisë njerëzore prej gati një milion vjetësh; ato nuk përputhen as me faktet historike të natyrës që njihen prej nesh gjer tani (për shembull, natyra ashtu siç është pasqyruar nga historia e trupave qiellore, e tokës, e botës organike dhe e shkencave të tjera të natyrës).

Cituar në «Raportin mbi aktivitetin e qeverisë, mbajtur nga Kryetari i Këshillit të Shtetit Çu En-lai në sesionin e parë të legjislaturës së 3-të të Asamblesë Kombëtare Populllore të RP të Kinës» (21-22 dhjetor 1964).

Shkencat e natyrës janë një armë në luftën e njerëzve për liri. Që të fitojnë lirinë në shoqëri, ata duhet të shfrytëzojnë shkencat shoqërore për ta njohur shoqërinë, për ta transformuar atë dhe për të bërë revolucionin shoqëror. Që të fitojnë lirinë në

natyrë, ata duhet të shfrytëzojnë shkencat e natyrës për ta njohur natyrën, për ta nënshtruar dhe transformuar atë, dhe kështu fitojnë lirinë në natyrë.

Fjala e mbajtur në ceremoninë e themelimit të Shoqatës së Studimeve të Shkencave të Natyrës të Zonës Kufitare (5 shkurt 1940).

Filozofia marksiste — materializmi dialektik — ka dy veçori shumë të qarta: njëra është karakteri i saj klasor, pranimi haptazi se materializmi dialektik i shërben proletariatit; tjetra është karakteri i saj praktik, nënvizimi i varësisë së teorisë nga praktika, nënvizimi i faktit se baza e teorisë është praktika dhe se teoria, nga ana e saj, i shërben praktikës.

«Mbi praktikën» (korrik 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Sipas filozofisë marksiste, çështja më e rëndësishme nuk është që, pasi të kesh kuptuar ligjet e botës objektive, të jesh në gjendje të shpjegosh botën, por që ta për-

dorësh njohjen e ligjeve objektive për transformimin aktiv të saj.

Po aty.

Nga vijnë idetë e drejta të njeriut? Mos bien nga qielli? Jo. Mos kanë lindur vetvetiu në tru? Jo. Idetë e drejta të njeriut mund të vijnë vetëm nga praktika shoqërore, nga të tri format e saj: lufta për prodhim, lufta klasore dhe eksperimentimi shkencor.

«Nga vijnë idetë e drejta të njeriut?» (maj 1963).

Qenia shoqërore e njerëzve përcakton idetë e tyre. Dhe idetë e drejta që përfaqësojnë klasën pararojë, sapo përvehtësohen nga masat, shndërrohen në një forcë materiale për transformimin e shoqërisë dhe të botës.

Po aty.

Gjatë praktikës shoqërore njerëzit bëjnë luftë të llojeve të ndryshme dhe fitojnë një përvojë të pasur si nga sukseset, ashtu dhe

nga disfatat. Fenomenet e panumërta të botës së jashtme objektive pasqyrohen në tru nëpërmjet të pesë organeve të shqisave — të parit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të shijuarit dhe të prekurit; kështu formohet, në fillim, njohja shqisore. Kur këto të dhëna të njohjes shqisore grumbullohen në sasi të mjaftueshme, ndodh një hop dhe ato shndërrohen në njohje racionale, domethënë në ide. Ky është një proces i njohjes. Kjo është shkalla e parë e gjithë procesit të njohjes — shkalla e kalimit nga materja, që është objektive, te fryma, që është subjektive, nga qenia te idetë. Në këtë shkallë, akoma nuk është vërtetuar nëse fryma ose idetë (duke përfshirë teoritë, politikën, planet, mënyrat e veprimit) i pasqyrojnë drejt ligjet e botës së jashtme objektive, nuk është ende e mundur të përcaktohet nëse ato janë të drejta ose jo. Pastaj vjen shkalla e dytë e procesit të njohjes — shkalla e kalimit nga fryma te materja, nga idetë te qenia. Në këtë shkallë puna është që njohja e fituar gjatë shkallës së parë të zbatohet në praktikën shoqërore për të parë nëse teoritë, politika, planet, mënyrat e

veprimit etj. japin rezultatet e pritura. Në përgjithësi, është e drejtë ajo që del me sukses dhe e gabuar ajo që dështon. Kjo është e vërtetë veçanërisht përsa i përket luftës së njerëzve kundër natyrës. Në luftën shoqërore, forcat që përfaqësojnë klasën pararojë pësojnë nganjëherë disfatë, jo pse kanë ide jo të drejta, por sepse në raportin e forcave që ndeshen, forcat përparimtare janë përkohësisht më pak të fuqishme se forcat reaksionare, prandaj pësojnë përkohësisht disfatë, por do të vijë një ditë që ato të triumfojnë. Duke kaluar provat e praktikës, njohja e fituar nga njerëzit bën prapë një hop tjetër, i cili ka një rëndësi edhe më të madhe se i pari, sepse vetëm ky hop mund të vërtetojë nëse hopi i parë — idetë, teoritë, politika, planet, mënyrat e veprimit etj., të përpunuara në procesin e pasqyrimit të botës së jashtme objektive, janë të drejta apo të gabuara. Nuk ka mjet tjetër për të verifikuar të vërtetën.

Po aty.

Njohja e drejtë zakonisht arrihet vetëm duke bërë shumë përsëritje të procesit të

kalimit nga materja te fryma dhe nga fryma te materja, domethënë nga praktika te njohja dhe nga njohja te praktika. Kjo është teoria marksiste e njohjes, teoria materialiste dialektike e njohjes.

Po aty.

Askush nuk mund të njohë asnjë fenomen pa rënë në kontakt me të, domethënë në qoftë se nuk jeton (ushtron praktikën) në kushtet e këtij fenomeni. . . . Në qoftë se dëshiron të fitosh dituri, duhet të marrësh pjesë në praktikën për ndryshimin e realitetit. Në qoftë se dëshiron të dish shijen e dardhës, duhet ta ndryshosh atë, domethënë ta përtypësh. . . . Në qoftë se dëshiron të njohësh teorinë dhe metodat e revolucionit, duhet të marrësh pjesë në revolucion. Të gjitha dijet e vërteta burojnë nga përvoja e drejtpërdrejtë.

«Mbi praktikën» (korrik 1937),
Vepra të zgjedhura, vëll. 1.

Njohja fillon nga praktika. Njohja teorike e fituar me anën e praktikës, duhet të

kthehet përsëri tek praktika. Roli aktiv i njohjes nuk shprehet vetëm në hopin aktiv nga njohja shqisore në njohjen racionale, por, dhe kjo është më e rëndësishme, edhe në hopin nga njohja racionale në praktikën revolucionare.

Po aty.

Të gjithë e kanë të qartë se çdo gjë që të bëjmë, po të mos kuptojmë kushtet e saj, karakterin e saj, lidhjet e saj me sendet e fenomenet e tjera, nuk do të kuptojmë ligjet e saj, nuk do të dimë se si ta bëjmë dhe nuk do të mund ta bëjmë mirë.

«Çështje të strategjisë së luftës revolucionare në Kinë» (dhjetor 1936), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Në qoftë se njeriu dëshiron të korrë suksese në punë, domethënë të arrijë rezultatet e pritura, ai duhet të bëjë patjetër që idetë e tij të përputhen me ligjet e botës së jashtme objektive; në rast të kundërt, ai do të pësojë disfatë në praktikë. Pasi pë-

son disfatë, njeriu nxjerr mësime prej saj, i ndreq idetë e tij dhe i bën që të përputhen me ligjet e botës së jashtme dhe atëherë ai mund ta kthejë disfatën në fitore. Pikërisht këtë të vërtetë shprehin fjalët e urta: "Disfata është nëna e suksesit" dhe "pësimi bëhet mësim".

«Mbi praktikën» (korrik 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Ne jemi marksistë dhe marksizmi na mëson që në shqyrtimin e çështjeve të nisemi jo nga përkufizimet abstrakte, por nga faktet që ekzistojnë objektivisht, dhe në bazë të analizës së këtyre fakteve të përcaktojmë kursin, politikën dhe mënyrat e veprimit.

«Fjalime të mbajtura në mbledhjen e Jenanit për çështjet e letërsisë dhe të artit» (maj 1942), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Metoda më themelore e punës, që duhet të mbajë mend mirë çdo komunist, është që ne ta përcaktojmë kursin tonë të punës

sipas gjendjes reale. Nga analiza e gabimeve që kemi bërë, del se ato kanë rrjedhur nga fakti që ne përcaktuam në mënyrë subjektive kursin tonë të punës, duke u shkëputur nga gjendja reale në një kohë të caktuar dhe në një vend të caktuar.

«Fjala e mbajtur në konferencën e kuadrove të krahinës së çliruar Shansi-Sujuan» (1 prill 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Idealizmi dhe metafizika kërkojnë më pak përpjekje se çdo gjë tjetër në botë, sepse ato u japin mundësi njerëzve të flasin gjepura pa u bazuar në realitetin objektiv dhe pa iu nënshtruar kontrollit të tij. Përkundrazi, materializmi dhe dialektika kërkojnë përpjekje prej tyre; ata duhet të bazohen në realitetin objektiv dhe t'i nënshtrohen kontrollit të tij. Në rast se ata nuk bëjnë përpjekje, do të shkasin në idealizëm dhe metafizikë.

Shënim mbi «Materialet në lidhje me grupin kundërrevolucionar të Hu Funit» (maj 1955).

Çdo send duhet ta shikojmë nga thelbi i tij, ndërsa çfaqjet e jashtme duhet t'i shikojmë vetëm si shenja udhërrëfyese që na çojnë në pragun, përtej të cilit ne duhet të kapim thelbin e sendit. Kjo është e vetmja metodë e sigurtë shkencore e analizës.

«Nga një shkëndijë mund të digjet gjithë stepa» (5 janar 1930), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Shkaku themelor i zhvillimit të sendeve dhe fenomeneve nuk ndodhet jashtë, por brenda tyre, në kontradiktat brenda vetë sendeve dhe fenomeneve. Çdo send dhe fenomen ka në brendinë e vet kontradikta, prandaj shkaktohen lëvizja dhe zhvillimi i sendeve dhe fenomeneve. Kontradiktat, që janë në brendinë e sendeve dhe fenomeneve, janë shkaku themelor i zhvillimit të tyre, ndërsa lidhja reciproke dhe ndikimi reciprok midis një sendi ose fenomeni dhe sendeve ose fenomeneve të tjera janë shkaqe të dorës së dytë.

«Mbi kontradiktën» (gusht 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Sipas dialektikës materialiste, shkaqet e jashtme janë kushti i ndryshimeve, ndërsa shkaqet e brendshme janë baza e ndryshimeve; shkaqet e jashtme veprojnë nëpërmjet shkaqeve të brendshme. Veza, mbasi merr nxehtësinë e duhur, shndërrohet në zog, por nxehtësia nuk është në gjendje ta shndërrojë gurin në zog, sepse baza e tyre është e ndryshme.

Po aty.

Sipas filozofisë marksiste, ligji i unitetit të të kundërtave është ligji themelor i gjithësisë. Ky ligj vepron kudo si në natyrë, ashtu edhe në shoqërinë njerëzore dhe në mendimin njerëzor. Anët e kundërta të kontradiktës janë në unitet dhe në luftë, kjo nxit lëvizjen dhe ndryshimin e sendeve dhe të fenomeneve. Kontradiktat ekzistojnë kudo, por karakteri i tyre ndryshon sipas karakterit të sendeve dhe fenomeneve. Për çdo send dhe fenomen konkret, uniteti i të kundërtave është i kondicionuar, i përkohshëm, kalimtar, dhe për këtë arësye

edhe relativ, kurse lufta e të kundërtave është absolute.

> «Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Metoda analitike është metodë dialektike. Me analizë ne kuptojmë analizën e kontradiktave të sendeve dhe fenomeneve. Pa njohur mirë jetën, pa kuptuar me të vërtetë kontradiktat, për të cilat bëhet fjalë, është e pamundur të bëjmë një analizë të drejtë.

> «Fjala e mbajtur në konferencën kombëtare të Partisë Komuniste të Kinës mbi punën e propagandës» (12 mars 1957).

Analiza konkrete e gjendjes konkrete, ka thënë Lenini, është "vetë thelbi, shpirti i gjallë i marksizmit". Shumë shokëve tanë u mungon aftësia për të menduar në mënyrë analitike; ata nuk dëshirojnë t'i analizojnë e t'i studiojnë në mënyrë të përsëri-

tur e të thellë sendet dhe fenomenet e ndërlikuara, por preferojnë të nxjerrin konkluzione të thjeshta: ose absolutisht pozitive, ose absolutisht negative. ... Këtej e tutje kjo gjendje duhet ndrequr.

«Studimi ynë dhe gjendja aktuale» (12 prill 1944), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Mënyra se si këta shokë i shohin çështjet, nuk është e drejtë. Ata nuk shohin anët e tyre esenciale e kryesore, por theksojnë anët joesenciale e jokryesore. Duhet vënë në dukje se nuk mund të lihen pas dore çështjet joesenciale e jokryesore, ato duhet të zgjidhen një nga një. Por nuk duhet t'i marrim ato si esenciale e kryesore dhe të humbasim kështu orientimin.

«Mbi çështjen e kooperimit të bujqësisë» (31 korrik 1955).

Në botë sendet janë të ndërlikuara dhe përcaktohen nga faktorë të ndryshëm. Ne

duhet ta shqyrtojmë problemin nga të gjitha anët, dhe jo nga një anë e vetme.

«Mbi bisedimet e Çuncinit» (17 tetor 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Vetëm njerëzit që i shohin problemet në mënyrë subjektive, të njëanshme dhe të përciptë, kur vijnë në një vend, pa u interesuar për rrethanat, pa parë gjithë punën (historinë dhe gjendjen e saj aktuale në tërësi) dhe pa hyrë në thelbin e saj (në karakterin e punës dhe lidhjet e saj të brendshme me punët e tjera), fillojnë menjëherë të japin urdhëra duke e quajtur vehten të pagabueshëm; të tillë njerëz i pret një dështim i pashmangshëm.

«Mbi praktikën» (korrik 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Në studimin e çështjeve është i palejueshëm trajtimi subjektiv, i njëanshëm dhe i përciptë. Trajtim subjektiv do të thotë të mos jesh i zoti t'i shohësh çështjet në mënyrë objektive, domethënë nga pikëpamja

materialiste. Këtë e kam përmendur në artikullin «Mbi praktikën». Trajtim i njëanshëm do të thotë të mos jesh i zoti t'i shohësh çështjet në mënyrë të gjithanshme, . . . ose, si të thuash, të shohësh vetëm të pjesshmen, dhe jo të tërën, të shohësh vetëm drutë, dhe jo pyllin. Në këtë mënyrë është e pamundur të gjesh metoda për zgjidhjen e kontradiktave, është e pamundur të plotësosh detyrat e revolucionit, është e pamundur të kryesh mirë punën që të është ngarkuar, është e pamundur të zhvillosh drejt luftën ideologjike në parti. Sun Ci, duke analizuar çështjet ushtarake, thoshte: "Njih armikun, njih edhe vehten, dhe do të jesh kurdoherë fitimtar". Ai fliste për dy palët ndërluftuese. Vej Çeni, që jetoi në dinastinë Tan, thoshte: "Po t'i dëgjosh të dyja palët, do të mbetesh i qartë; po të besosh vetëm njërën palë, do të mbetesh në errësirë". Edhe ai e kuptonte se trajtimi i njëanshëm është i gabuar. Kurse shokët tanë shpeshherë i trajtojnë çështjet në mënyrë të njëanshme dhe njerëzve të tillë shpeshherë u has sharra në gozhdë. . . . Lenini thoshte: "Për ta njohur me të

vërtetë një send duhet të kapen, të studiohen të gjitha anët e tij, të gjitha lidhjet dhe "varësitë reciproke" të tij. Ne nuk do ta arrijmë kurrë këtë plotësisht, por kërkesa për të qenë të gjithanshëm do të na ruajë nga gabimet dhe nga ngurtësia". Fjalët e tij ne duhet t'i mbajmë mend. Trajtim i përciptë do të thotë të mos marrësh parasysh as veçoritë e kontradiktës në tërësi, as veçoritë e anëve të saj të ndryshme, të mohosh nevojën për t'u futur thellë në brendinë e sendit dhe për të studiuar me hollësi veçoritë e kontradiktës, të hedhësh vetëm një vështrim nga larg, të shohësh fluturimthi vetëm anën e jashtme të kontradiktës dhe të mundohesh ta zgjidhësh atë menjëherë (t'u përgjigjesh pyetjeve, të zgjidhësh mosmarrëveshjet, të kryesh punën dhe të drejtosh veprimet luftarake). Një trajtim i tillë i çështjeve do të sjellë patjetër çrregullime. . . . Trajtimi i njëanshëm dhe i përciptë është gjithashtu trajtim subjektiv, sepse të gjitha sendet objektive në realitet janë të lidhura midis tyre dhe kanë ligje të brendshme, por njerëzit, në vend që ta pasqyrojnë këtë ashtu

siç është, i shikojnë sendet në mënyrë të njëanshme ose të përciptë, nuk njohin lidhjet e tyre reciproke dhe ligjet e tyre të brendshme, prandaj kjo metodë është subjektive.

«Mbi kontradiktën» (gusht 1937),
Vepra të zgjedhura, vëll. 2.

Njëanshmëria është absolutizim në mendime, është trajtim i çështjeve në mënyrë metafizike. Të aprovosh ose të mohosh çdo gjë në vlerësimin e punës sonë, do të thotë të tregohesh i njëanshëm. . . . Të aprovosh çdo gjë do të thotë të shikosh vetëm të mirat dhe jo të këqijat, të pranosh vetëm lavdërimet dhe jo kritikat. Të thuash se çdo gjë shkon mirë në punën tonë, kjo nuk u përgjigjet fakteve. Në të vërtetë, jo çdo gjë shkon mirë, ne kemi akoma të meta dhe gabime. Por edhe të thuash se çdo gjë shkon keq, kjo gjithashtu nuk u përgjigjet fakteve. Del pra nevoja e analizës. Të mohosh çdo gjë, do të thotë pa bërë ndonjë analizë të mendosh se asgjë nuk shkon mirë dhe se në një vepër kaq të madhe, siç është ndërtimi socialist, në këtë

luftë kaq të madhe që po zhvillojnë qindra miliona njerëz, nuk ka asgjë të mirë për t'u përmendur dhe gjithshka është në rrëmujë të madhe. Megjithëse shumë njerëz që kanë pikëpamje të tilla ndryshojnë nga ata elementë, që ushqejnë ndjenja armiqësie ndaj regjimit socialist, prapëseprapë pikëpamjet e tyre mbeten shumë të gabuara e shumë të dëmshme, ato vetëm mund t'i dekurajojnë njerëzit. Është gabim ta vlerësosh punën tonë duke u nisur nga pikëpamja që të aprovosh ose të mohosh çdo gjë.

«Fjala e mbajtur në konferencën kombëtare të Partisë Komuniste të Kinës mbi punën e propagandës» (12 mars 1957).

Në trajtimin e çështjes, marksistët duhet të shikojnë jo vetëm të pjesshmen, por edhe tërësinë e saj. Një bretkosë, që rrinte brenda në pus, thoshte se "qielli është sa gryka e pusit". Kjo nuk është e drejtë, sepse qielli nuk është sa gryka e pusit. Në qoftë se do të thoshte se "një pjesë e qiellit

është sa gryka e pusit", kjo do të ishte e drejtë, sepse u përgjigjet fakteve.

«Mbi taktikën e luftës kundër imperializmit japonez» (27 dhjetor 1935), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Ne duhet të mësohemi t'i shohim çështjet në mënyrë të gjithanshme, të shohim jo vetëm anën e përparme, por edhe anën e pasme të sendeve dhe fenomeneve. Në kushte të caktuara, një gjë e keqe mund të sjellë rezultate të mira, dhe një gjë e mirë mund të sjellë rezultate të këqia.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Ne pranojmë se në procesin e përgjithshëm të zhvillimit historik, është elementi material që përcakton elementin shpirtëror, është qenia shoqërore që përcakton ndërgjegjen shoqërore. Por njëkohësisht pranojmë, dhe duhet të pranojmë, veprimin anasjelltas të elementit shpirtëror mbi elementin material, të ndërgjegjes shoqërore mbi qenien

shoqërore, të superstrukturës mbi bazën ekonomike. Kjo nuk është në kundërshtim me materializmin, por pikërisht kështu ne i shmangemi materializmit mekanistik dhe i përmbahemi materializmit dialektik.

«Mbi kontradiktën» (gusht 1937),
Vepra të zgjedhura, vëll. 2.

Ata që drejtojnë luftimet nuk mund të pretendojnë për fitore jashtë caqeve që lejojnë kushtet objektive, por mund dhe duhet të përpiqen aktivisht për të arritur fitore në luftimet brenda caqeve të kushteve objektive. Skena e veprimtarisë së komandantëve në luftë duhet të ndërtohet në bazë të kushteve objektive, por në këtë skenë ata mund të drejtojnë një numër të madh aktesh plot gjallëri, dinamizëm, kolorit e madhështi.

«Mbi luftën e gjatë» (maj 1938),
Vepra të zgjedhura, vëll. 2.

Mendimet e njerëzve duhet t'u përshtaten rrethanave të ndryshuara. Sigurisht, askush nuk duhet të ketë mendime të pa-

themelta e fantastike, të përpunojë plane veprimi jashtë kushteve që lejojnë rrethanat objektive, dhe t'i vihet me zor një pune që në fakt nuk mund të kryhet. Por çështja tani qëndron në faktin që në shumë fusha ne na pengojnë akoma mendimet konservatore të së djathtës, të cilat bëjnë që puna në këto fusha të mos i përgjigjet zhvillimit të rrethanave objektive. Sot çështja është se shumë njerëz e quajnë të pamundur kryerjen e një pune, të cilën do të mund ta kryenin, në qoftë se do të bënin përpjekje.

Parathënie për librin «Hovi i socializmit në fshatin kinez» (27 dhjetor 1955).

Për çdo gjë duhet ta vëmë trurin në veprim dhe të mendojmë mirë. Një fjalë e urtë thotë: "Me të rrudhur vetullat — në kokë të lind një plan". Me fjalë të tjera, të menduarit e thellë është burimi i urtësisë. Për të zhdukur verbërinë, që është mjaft e përhapur në partinë tonë, duhet t'i inkurajojmë shokët tanë të mendojnë, të zotërojnë metodën e analizës së sendeve

e të fenomeneve dhe ta bëjnë analizën shprehi.

«Studimi ynë dhe gjendja aktuale» (12 prill 1944), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Në qoftë se në një proces ekzistojnë një numër kontradiktash, midis tyre ka patjetër një kontradiktë kryesore, e cila luan rolin drejtues dhe vendimtar, ndërsa kontradiktat e tjera zënë një vend të dorës së dytë dhe të varur. Pra, në studimin e çdo procesi, në qoftë se ky është një proces i ndërlikuar që përmban më shumë se dy kontradikta, duhen bërë të gjitha përpjekjet për të zbuluar kontradiktën e tij kryesore. Me t'u përcaktuar kjo kontradiktë kryesore, të gjitha problemet mund të zgjidhen lehtë.

«Mbi kontradiktën» (gusht 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Njëra nga të dyja anët e kontradiktës është patjetër kryesorja, kurse tjetra — e dorës së dytë. Ana kryesore është ajo që luan

rolin drejtues në kontradiktë. Karakteri i sendeve dhe fenomeneve përcaktohet kryesisht nga ana kryesore e kontradiktës, e cila zë një pozitë sunduese.

Por kjo gjendje nuk është e pandryshueshme. Ana kryesore dhe ana jokryesore e kontradiktës shndërrohen njëra në tjetrën, dhe bashkë me këtë ndryshon edhe karakteri i sendit dhe fenomenit.

Po aty.

Ne duhet jo vetëm të shtrojmë detyra, por edhe të zgjidhim çështjen e metodave për kryerjen e këtyre detyrave. Ta zëmë se detyra jonë është që të kapërcejmë një lumë, por, kur nuk kemi urë ose lundër, s'kemi si ta kapërcejmë. Po nuk zgjidhëm çështjen e urës ose të lundrës, fjalët për kapërcimin e lumit do të mbeten fjalë boshe. Po nuk zgjidhëm çështjen e metodës, kryerja e detyrës do të mbetet një llomotitje e zbrazët.

«Të kujdesemi për jetën e masave, t'u kushtojmë vëmendje metodave të punës» (27 janar 1934), *Vepra të zgjedhura,* vëll. I.

Pa lëshuar një thirrje të përgjithshme, që të përhapet tek të gjithë, është e pamundur të mobilizohen masat e gjera për kryerjen e çdo detyre qoftë. Por në qoftë se drejtuesit do të kufizohen vetëm me një thirrje të përgjithshme, po qe se ata nuk do të futen thellë në disa nga organizatat që të merren vetë konkretisht dhe drejtpërdrejt me punën, për kryerjen e së cilës ata bëjnë thirrje — në mënyrë që, pasi të kenë hapur të çarën e parë dhe të kenë fituar përvojë, ta përdorin këtë përvojë për drejtimin e punës në sektorët e tjerë, — ata nuk do të mund të kontrollojnë nëse është e drejtë apo jo thirrja e përgjithshme që ata lëshojnë, nuk do të mund të pasurojnë përmbajtjen e saj dhe atëherë do të ketë rrezik që kjo thirrje e përgjithshme të mbetet pezull në ajr.

«Disa çështje në lidhje me metodat e udhëheqjes» (1 qershor 1943), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Asnjë drejtues nuk mund të realizojë drejtimin e përgjithshëm të të gjithë sektorëve, po qe se nuk fiton një përvojë

konkrete në sektorë të veçantë të instancave më të ulta nga punonjës të veçantë, në çështje të veçanta. Kjo metodë duhet të përhapet gjerësisht, me qëllim që kuadrot drejtuese të të gjitha instancave të mund ta përvehtësojnë.

Po aty.

Në asnjë krahinë nuk mund të ketë njëkohësisht një numër detyrash qendrore; në një kohë të caktuar mund të ketë vetëm një detyrë qendrore, të plotësuar me detyra të tjera — të dorës së dytë dhe të tretë. Prandaj përgjegjësi kryesor i një krahine duhet që, duke pasur parasysh historinë e luftës dhe rrethanat e kësaj lufte në këtë krahinë, t'i lërë secilës detyrë vendin që i takon, dhe jo të veprojë pa pasur asnjë plan të tij, vetëm sipas udhëzimeve që vijnë nga lart, të hidhet nga një detyrë në tjetrën, duke krijuar shumë "detyra qendrore" dhe një gjendje plot rrëmujë e çrregullime. Edhe organet e larta nga ana e tyre nuk duhet t'u ngarkojnë organeve të ulta shumë detyra në një kohë, duke

mos i ndarë ato sipas rëndësisë e ngutësisë dhe duke mos dalluar qendroren ndër to, sepse kjo u shkakton organeve të ulta rrëmujë në organizimin e punës dhe kështu bën që të mos arrihen rezultatet e parashikuara. Në përshtatje me kushtet historike dhe me gjendjen e tanishme të një krahine të dhënë dhe duke pasur parasysh gjendjen në tërësi, drejtuesi duhet të marrë vendim të drejtë në lidhje me qendrën e gravitetit të punës dhe radhën e kryerjes së saj në çdo periudhë, dhe pas kësaj të zbatojë me këmbëngulje vendimin e marrë dhe të arrijë me çdo kusht rezultatet e caktuara. Kjo është një nga çfaqjet e artit të udhëheqjes.

Po aty.

Byrotë dhe nënbyrotë krahinore të Komitetit Qendror . . . duhet të jenë gjithnjë në dijeni mbi zhvillimin e punës, të shkëmbejnë eksperiencën dhe të ndreqin gabimet. Ato nuk duhet të presin disa muaj, një gjashtëmujor ose një vit për të bërë, në mbledhjet e analizës së punës, një verifikim të përgjithshëm dhe një ndreqje të për-

gjithshme të gabimeve. Një gjë e tillë do të sillte dëme të mëdha, kurse dëmet do të ishin më të pakta, po të ndreqeshin gabimet sa herë që çfaqen.

«Mbi politikën në lidhje me industrinë dhe tregëtinë» (27 shkurt 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Mos prisni t'i zgjidhni problemet vetëm pasi ato të jenë grumbulluar dhe të kenë shkaktuar shumë ngatërresa. Drejtuesit duhet të vihen medoemos në ballë të lëvizjes dhe të mos mbeten në bisht të saj.

Shënim mbi artikullin «Puna stinore e kontraktuar» (1955), *Hovi i socializmit në fshatin kinez.*

Ne duhet të jemi entuziastë, por gjakftohtë, të bëjmë punë intensive, por të rregullt.

«Çështje të strategjisë së luftës revolucionare në Kinë» (dhjetor 1936), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

XXIII. HETIME DHE STUDIME

Të gjitha kuadrot e punës praktike duhet të merren me hetimin e gjendjes në bazë. Për ata që njohin vetëm teorinë, por nuk e njohin gjendjen e vërtetë, është veçanërisht e nevojshme kryerja e hetimeve të tilla; përndryshe ata nuk do të mund ta lidhin teorinë me praktikën. "Pa bërë hetim, nuk ke të drejtën e fjalës". Megjithëse me këtë frazë disa janë tallur, duke e cilësuar si çfaqje të "empirizmit të ngushtë", unë edhe sot nuk pendohem që e kam thënë; dhe jo vetëm që nuk pendohem, por prapë ngul këmbë që pa bërë hetim nuk mund të kesh të drejtën e fjalës. Ka shumë njerëz që "me të zbritur nga qerrja", fillojnë të çirren e të japin mendime, të bëjnë vërejtje, të kritikojnë njërin dhe të qortojnë tjetrin; në të vërtetë nga dhjetë njerëz

të tillë, që të dhjetë do të dështojnë, sepse gjykimet ose kritikat e këtij lloji, që nuk janë të mbështetura në një hetim të gjithanshëm, s'janë gjë tjetër veçse llomotitje njerëzish të paditur. Dëmi që i kanë sjellë partisë sonë këta "të dërguar perandorakë" s'ka të llogaritur; mirëpo këta "të dërguar perandorakë" rendin andej e këndej, pothuaj kudo. Me të drejtë J. V. Stalini ka thënë se "teoria bëhet një gjë pa objekt, po qe se ajo nuk lidhet me praktikën revolucionare". Natyrisht, të drejta janë gjithashtu fjalët e tij se "praktika bëhet e verbër, po qe se nuk e ndriçon rrugën e saj me teorinë revolucionare". Asnjeri nuk duhet të akuzohet për "empirizëm të ngushtë" përveç prakticienëve të verbër, pa perspektivë dhe jolargpamës.

«Parathënie dhe pasthënie mbi "Studimet lidhur me fshatin"» (mars-prill 1941), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Një qëndrim i tillë do të thotë që në faktet të zbulosh të vërtetën. "Faktet" janë

të gjitha sendet dhe fenomenet që ekzistojnë objektivisht. "E vërteta" është lidhja e brendshme, domethënë ligjet e të gjitha sendeve dhe fenomeneve që ekzistojnë objektivisht. "Të zbulosh" do të thotë të studiosh. Ne duhet të nisemi nga gjendja reale brenda vendit dhe jashtë tij, brenda provincës dhe jashtë saj, brenda distriktit dhe jashtë tij, brenda rrethit dhe jashtë tij, të nxjerrim nga ajo ligjet e saj të vërteta, e jo të shpikura, domethënë të gjejmë në ngjarjet që zhvillohen rreth e përqark nesh lidhjen e brendshme dhe t'i marrim ato si udhëheqje për veprim. Mirëpo për këtë ne duhet të mbështetemi jo në imagjinatën subjektive, jo në vrullin e çastit, jo në njohuri libreske, por në faktet që ekzistojnë objektivisht, duhet të zotërojmë të dhëna të hollësishme dhe, duke u udhëhequr nga parimet e përgjithshme të marksizëm-leninizmit, të nxjerrim nga këto të dhëna konkluzione të drejta.

«Të riorganizojmë mësimin tonë» (maj 1941), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Të veprosh si "një njeri që ndjek harabelin me sy mbyllur", si "i verbëri që përpiqet të kapë peshkun", të trajtosh çështjen pa kujdes dhe përciptas, të merresh me pallavra të kota, të kënaqesh me njohuri gjysmake — ky stil shumë i keq, që është krejtësisht në kundërshtim me frymën themelore të marksizëm-leninizmit, vazhdon të ekzistojë tek shumë shokë në partinë tonë. Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini na mësojnë që ta studiojmë gjendjen me seriozitet, të nisemi nga gjendja e vërtetë objektive e jo nga dëshirat subjektive. Mirëpo shumë nga shokët tanë veprojnë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me këtë të vërtetë.

Po aty.

Nuk mund ta zgjidhësh një problem? Atëherë heto, informohu mbi gjendjen e tanishme dhe historikun e tij. Pasi ta kesh hetuar mirë e thellë problemin, do të gjesh mënyrën për ta zgjidhur. Të gjitha konkluzionet dalin në fund të hetimit dhe jo përpara tij. Vetëm budallai fill i vetëm ose me një grup njerëzish nuk bën asnjë

hetim, por lodh trutë për të "gjetur një zgjidhje", për të "nxjerrë një ide". Duhet ta dish se në këtë mënyrë nuk mund të gjesh asnjë zgjidhje të mirë dhe as të nxjerrësh një ide të mirë.

«Kundër fetishizimit të librit» (maj 1930).

Hetimi mund të krahasohet me një "gjendje shtatzënieje që zgjat dhjetë muaj" dhe zgjidhja e problemit me "ditën e lindjes". Të bësh hetimin do të thotë të zgjidhësh problemin.

Po aty.

Duke përdorur teorinë dhe metodën marksiste-leniniste, të hetojmë dhe të studiojmë në mënyrë sistematike e të gjithanshme gjendjen që na rrethon. Në punën tonë të mos mbështetemi vetëm në entuziazëm, por, siç thotë J. V. Stalini, të kombinojmë vrullin revolucionar me shpirtin praktik.

«Të riorganizojmë mësimin tonë» (maj 1941), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

E vetmja metodë për të njohur gjendjen është studimi i shoqërisë dhe i realitetit të gjallë të të gjitha klasave të shoqërisë. Për ata që merren me punë drejtuese, metoda më themelore për njohjen e gjendjes është që të caktojnë sipas një plani disa qytete e fshatra dhe, duke iu përmbajtur pikëpamjes themelore të marksizmit, domethënë metodës së analizës klasore, të bëjnë një varg studimesh të hollësishme.

«Parathënie dhe pasthënie mbi "Studimet lidhur me fshatin"» (mars-prill 1941), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Në një mbledhje për hetimin e një problemi nuk është nevoja të ftohen shumë njerëz, mjafton të ftohen tre-katër, ose shtatë-tetë veta. Për këtë duhet t'u lësh pjesëmarrësve kohën e nevojshme, të pregatisësh çështjet kryesore, pyetjet t'i bësh vetë, të mbash shënim përgjigjet dhe të rrahësh çështjet sëbashku me pjesëmarrësit në mbledhje. Kështu pra, po nuk tregove entuziazëm të madh, po nuk tregove vendosmëri për t'i drejtuar sytë nga baza, po nuk pate etje

për të fituar njohuri, po nuk tregove gadishmëri për të flakur tej fodullëkun e ndyrë dhe për të kaluar në gjendjen e nxënësit, këtë punë nuk mund ta kryesh fare ose me siguri do ta kryesh keq.

Po aty.

Vendosja e drejtë e trupave rrjedh nga vendimi i drejtë i komandantit; vendimi i drejtë rrjedh nga vlerësimi i drejtë i gjendjes, dhe vlerësimi i drejtë i gjendjes rrjedh nga zbulimi i gjithanshëm e i domosdoshëm dhe nga shqyrtimi sistematik i të gjitha të dhënave të tij. Komandanti shfrytëzon të gjitha mjetet e mundshme dhe të domosdoshme të zbulimit, studion të dhënat e nxjerra nga zbulimi mbi gjendjen e armikut, duke ndarë shapin nga sheqeri, duke flakur të rremen e duke ruajtur të vërtetën, duke kaluar nga njëra anë e fenomeneve tek tjetra, nga e jashtmja në të brendshmen; pastaj komandanti, duke marrë parasysh edhe gjendjen e vet, studion gjendjen e të dyja palëve dhe lidhjen reciproke midis tyre, dhe atëherë bën vlerësimin, merr

vendimin dhe harton planin. Ky është një proces i tërë i njohjes së gjendjes nga strategu ushtarak para se ai të hartojë çdo plan strategjik, plan operativ ose luftimi.

«Çështje të strategjisë së luftës revolucionare në Kinë» (dhjetor 1936), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

XXIV. NDREQJA E MENDIMEVE TË GABUARA

Edhe sikur puna jonë të kurorëzohet me suksese shumë të mëdha, nuk ka asnjë arësye që të na rritet mendja. Modestia të çon përpara, kurse mendjemadhësia të shpie prapa. Ne duhet ta mbajmë mend kurdoherë këtë të vërtetë.

«Fjala e hapjes në Kongresin e 8-të të Partisë Komuniste të Kinës» (15 shtator 1956).

Me arritjen e fitores, në parti mund të dalin disa tendenca: mendjemadhësia, prirja për t'u njohur si njeri me merita, plogështia dhe mungesa e dëshirës për të shkuar përpara, kërkimi i qejfeve dhe mungesa e gadishmërisë për të bërë akoma një jetë të vështirë. Me arritjen e fitores,

populli do të na jetë mirënjohës; edhe borgjezia do të vijë të na bëjë lajka. Armiku nuk mund të na mposhtë me forcën e armëve, kjo gjë është provuar. Megjithatë ka mundësi që lajkat e borgjezisë të mposhtin në radhët tona njerëzit me vullnet të dobët. Mund të ketë komunistë të tillë, të cilët nuk u mposhtën nga armiku i armatosur dhe qëndruan përballë tij si heronj të denjë për këtë emër, por që nuk do t'u bëjnë dot ballë sulmeve me predha të sheqerosura dhe do të shpartallohen prej tyre. Ne duhet t'i dalim përpara një gjendjeje të tillë.

«Raport në plenumin e dytë të Komitetit Qendror të zgjedhur nga Kongresi i 7-të i Partisë Komuniste të Kinës» (5 mars 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Shumë gjëra mund të bëhen për ne një ngarkesë, një barrë, po të biem në verbëri dhe po të na mungojë vetëdija. Për shembull: një njeri ka bërë gabim dhe mund të mendojë se tani ai, sido që të jetë, ka një cen dhe kështu e ndjen vehten të

dëshpëruar; një tjetër nuk ka bërë gabime dhe, duke ndjerë që s'ka gabuar, mund t'i rritet mendja. Njëri nuk ka arritur suksese në punë, ai mund të bjerë në gjendje pesimizmi dhe dekurajimi; tjetri ka arritur suksese në punë, ai mund të mbajë hundën përpjetë. Njëri ka një stazh të shkurtër në luftë dhe për këtë shkak ai mund të mbajë një qëndrim pa përgjegjësi ndaj punës; tjetri ka një stazh të gjatë në luftë dhe për këtë shkak ai mund ta quajë vehten të pagabueshëm. Një punëtor ose fshatar, duke u mburrur me origjinën e tij të lavdishme, mund t'i shikojë me përbuzje intelektualët, kurse një intelektual, duke u mburrur me disa njohuri që ka, mund t'i shikojë me përbuzje punëtorët e fshatarët. Mjeshtëria profesionale mund të shërbejë si kapital për mendjemadhësinë dhe qëndrimin mospërfillës ndaj të tjerëve. Bile edhe mosha mund të shërbejë si shkak për mendjemadhësinë: një i ri, duke e quajtur vehten të mençur dhe të aftë, mund t'i shohë me përçmim pleqtë, kurse një plak, duke u mburrur me përvojën e tij të pasur, mund t'i shohë me mospërfillje të rinjtë. Në

qoftë se nuk do të jemi të vetëdijshëm ndaj të gjitha këtyre, ato mund të bëhen një ngarkesë, një barrë.

«Studimi ynë dhe gjendja aktuale» (12 prill 1944), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Disa shokëve, që punojnë në ushtri, u është rritur mendja, ata sillen në mënyrë arrogante dhe arbitrare me ushtarët, me popullin, me organet e pushtetit dhe të partisë. Ata qortojnë vetëm shokët që punojnë në organet lokale dhe jo vehten; shohin vetëm sukseset dhe jo të metat e veta; u pëlqejnë vetëm komplimentat dhe jo kritikat. . . . Ushtria duhet t'i kushtojë vëmendje zhdukjes së këtyre të metave.

«Organizohuni!» (29 nëndor 1943), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Një punë e vështirë është si një barrë përpara nesh që pret nëse ne do të kemi guxim ta hedhim mbi supet tona. Ka barrë të lehta, ka edhe barrë të rënda. Disa njerëz preferojnë barrët e lehta dhe kanë fri-

kë nga të rëndat; ata të rëndat ua lënë të tjerëve, kurse për vehte zgjedhin të lehtat. Ky nuk është një qëndrim i mirë. Disa shokë sillen ndryshe, ata ua lënë rehatin të tjerëve dhe i mbajnë vetë barrët e rënda. Ata janë të parët në vështirësi dhe të fundit në pretendime. Këta janë shokë të mirë. Të gjithë ne duhet të marrim shembull nga shpirti i tyre prej komunisti.

«Mbi bisedimet e Çuncinit» (17 tetor 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

S'janë të rrallë njerëzit që mbajnë një qëndrim pa përgjegjësi ndaj punës, zgjedhin punët e lehta, u tremben punëve të rënda, barrën e rëndë ua lënë të tjerëve dhe marrin për vehte të lehtën. Në çdo rast ata para së gjithash mendojnë për vehte, pastaj për të tjerët. Kur bëjnë ndonjë gjë të vogël, e paraqesin si një vepër të madhe, u pëlqen të shesin mend, sepse kanë merak se mos të tjerët nuk do t'ua dinë. Për shokët dhe për popullin ata nuk ushqejnë ndjenja të ngrohta, por mbajnë një qëndrim

të ftohtë, indiferent dhe apatik. Në të vërtetë, këta njerëz nuk janë komunistë, ose së paku nuk mund të quhen komunistë të kulluar.

«Kujtimit të Norman Betynit» (21 dhjetor 1939), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 3.

Ata që pretendojnë këtë lloj "pavarësie" zakonisht kanë si cilësi të tyre të pandarë të vënë "unin" në plan të parë. Ata si rregull nuk e shikojnë drejt çështjen e marrëdhënieve midis individit dhe partisë. Megjithëse me fjalë edhe ata e respektojnë partinë, në të vërtetë e vënë vehten e tyre në plan të parë, ndërsa partinë — në të dytin. Për çfarë përpiqen këta njerëz? Ata përpiqen për famë, për pozitë dhe për t'u dukur në publik. Kur marrin nën drejtimin e tyre një sektor pune, ata menjëherë fillojnë të pretendojnë "pavarësinë". Për këtë qëllim ata disa njerëz i afrojnë pranë vehtes, disa të tjerë i largojnë dhe merren me lajka e përkëdhelje midis shokëve, duke

futur kështu në Partinë Komuniste stilin vulgar të partive borgjeze. Këta njerëz i merr në qafë pandershmëria e tyre. Për mendimin tim, ne duhet të punojmë me nder; pa një qëndrim të ndershëm ne nuk do të mund të bëjmë kurrë diçka të dobishme në botë.

«Për ndreqjen e stilit në parti» (1 shkurt 1942), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Komunistët duhet të kuptojnë parimin e nënshtrimit të kërkesave të pjesshme ndaj kërkesave të përgjithshme. Në qoftë se ndonjë propozim është i pranueshëm nga pikëpamja e së pjesshmes, por është i papranueshëm nga pikëpamja e së përgjithshmes, duhet që e pjesshmja t'i nënshtrohet së përgjithshmes. Dhe anasjelltas, në qoftë se ndonjë propozim është i papranueshëm nga pikëpamja e së pjesshmes, por është i pranueshëm nga pikëpamja e së përgjithshmes, edhe në këtë rast duhet që e pjesshmja t'i nënshtrohet së përgjithshmes.

Pikërisht kjo do të thotë të kesh parasysh gjendjen e përgjithshme.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Dëshira për qejfe. Në Ushtrinë e Kuqe nuk janë të pakët njerëzit, tek të cilët individualizmi çfaqet në dëshirën për qejfe. Ata dëshirojnë gjithmonë që repartet e tyre të shkojnë në qytete të mëdha. Ata duan të shkojnë atje jo për punë, por për qejfe. Atyre veçanërisht nuk u pëlqen të punojnë në zonat e kuqe, ku kushtet e jetesës janë të vështira.

«Mbi ndreqjen e mendimeve të gabuara në parti» (dhjetor 1929), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Duhen luftuar tendencat lokaliste që shprehen në pirjen për t'u kujdesur vetëm për vehte dhe jo për të tjerët. Kush mban një qëndrim indiferent ndaj vështirësive që hasin të tjerët, kush refuzon kërkesat e të

tjerëve për t'u dërguar kuadro që varen prej tij, ose u dërgon kuadro jo të mira, kush "mbyt arën e fqinjit për të shpëtuar arën e vet" dhe nuk përfill interesat e një sektori tjetër, të një krahine tjetër, të njerëzve të tjerë, ai është lokalist. Kjo do të thotë se ai e ka humbur krejtësisht frymën komuniste. Mospërfillja e interesave të përgjithshme, qëndrimi indiferent ndaj sektorëve të tjerë, ndaj krahinave të tjera dhe njerëzve të tjerë — këto janë tiparet karakteristike të lokalistëve. Me këta njerëz duhet forcuar puna edukative, në mënyrë që ata të kuptojnë se lokalizmi në vetvehte është një tendencë sektare, e cila, po të zhvillohet, bëhet shumë e rrezikshme.

«Për ndreqjen e stilit në parti» (1 shkurt 1942), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Liberalizmi çfaqet në forma të ndryshme: E sheh se një person nuk vepron drejt, por me qenë se e ke të njohur, bashkëvendas, shok shkolle, mik të ngushtë, njeri të dashur, koleg të vjetër ose vartës të vjetër, nuk

zhvillon një polemikë parimore me të, por e lejon të vazhdojë edhe më tutje, vetëm e vetëm që të ruash paqen dhe miqësinë me të, ose e qorton lehtë e butë, por nuk e zgjidh çështjen plotësisht, me qëllim që të shkosh mirë me të. Si rrjedhim, dëmtohet si kolektivi në tërësi, ashtu edhe personi në fjalë. Kjo është çfaqja e parë e liberalizmit.

I lejon vehtes një kritikë pa përgjegjësi prapa shpine, por nuk bën aktivisht sugjerime në organizatë; nuk ja thua tjetrit në sy, por dërdëllit prapa shpine; në mbledhje hesht, kurse pas mbledhjes merresh me llomotitje. Në mendjen tënde, në vend të parimeve të jetës kolektive, mbretëron vetëm çthurja liberale. Kjo është çfaqja e dytë.

Kur një çështje nuk ka të bëjë me ty personalisht, qëndron sa më larg saj; megjithëse e di mirë se një gjë nuk është e drejtë, kujton se bën mirë të flasësh sa më pak; i urti, mendon ti, di t'i ruhet së keqes, mjafton që vetë të mos bjerë në gabim. Kjo është çfaqja e tretë.

Nuk u bindesh urdhërave dhe mendimin tënd personal e vë në plan të parë; do vetëm që organizata të kujdeset për ty, por nuk i nënshtrohesh disiplinës së saj. Kjo është çfaqja e katërt.

Në vend që të zhvillosh polemikë dhe luftë kundër mendimeve jo të drejta për hir të unitetit, të përparimit dhe të mbarëvajtjes së punës, merresh me sulme personale, me grindje, me nxjerrjen e inatit personal dhe përpiqesh të marrësh hak. Kjo është çfaqja e pestë.

Dëgjon mendime jo të drejta dhe nuk hyn në diskutime, për më tepër, nuk njofton as për fjalët e kundërrevolucionarëve, por tregohesh indiferent, sikur të mos ketë ndodhur asgjë. Kjo është çfaqja e gjashtë.

Ndodhesh në gjirin e masave dhe nuk zhvillon propagandë e agjitacion me to, nuk flet, nuk bën hetime, nuk pyet, nuk kujdesesh për hallet e masave, nuk çan kokën për to, harron se je anëtar i Partisë Komuniste dhe vepron si një qytetar i zakonshëm. Kjo është çfaqja e shtatë.

Sheh ndonjë që vepron në dëm të interesave të masave dhe nuk revoltohesh, nuk

e këshillon, nuk e ndalon, nuk e sqaron, por e lë të vazhdojë sipas qejfit. Kjo është çfaqja e tetë.

Nuk e kryen me seriozitet punën, punon pa një plan të caktuar, pa një drejtim të caktuar, punon shkel e shko, sa për të kaluar radhën, si "murgu, që sa kohë është murg, i bie kambanës". Kjo është çfaqja e nëntë.

E heq vehten si njeri me merita ndaj revolucionit dhe kapardisesh me stazhin tënd, punëve të mëdha s'ua del dot, kurse të voglat i lë pas dore, punon pa kujdes, mësimin e merr me përtesë. Kjo është çfaqja e dhjetë.

Ke bërë një gabim dhe e ke kuptuar atë, por nuk ke ndërmend ta ndreqësh dhe mban kështu një qëndrim liberal kundrejt vetvehtes. Kjo është çfaqja e njëmbëdhjetë.

«Kundër liberalizmit» (7 shtator 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Në një kolektiv revolucionarësh liberalizmi është shumë i dëmshëm. Ai është një element brejtës, që shkakton çthurjen e unitetit, dobësimin e solidaritetit, pasivite-

tin në punë, mosmarrëveshje në mendime. Liberalizmi bën që në radhët e revolucionarëve të zhduken organizimi i shëndoshë dhe disiplina e rreptë, pengon zbatimin konsekuent të politikës dhe krijon një hendek midis organizatës së partisë dhe masave të udhëhequra prej saj. Kjo është një tendencë shumë e dëmshme.

Po aty.

Liberalët i shikojnë parimet e marksizmit si dogma abstrakte. Ata janë për marksizmin, por nuk kanë ndërmend ta vënë atë në praktikë, ose nuk kanë ndërmend ta vënë plotësisht në praktikë; ata nuk kanë ndërmend ta zëvendësojnë liberalizmin e tyre me marksizmin. Këta njerëz kanë në kokën e tyre edhe marksizëm edhe liberalizëm: me fjalë ata janë për marksizmin, kurse me vepra për liberalizmin; për të tjerët ata kanë marksizmin, për vehten e tyre — liberalizmin. Tek ata i gjen që të dy, secili ka përdorimin e vet. Kjo është mënyra e të menduarit e disa njerëzve.

Po aty.

Shteti popullor mbron popullin. Vetëm atëherë kur populli ka një shtet të tillë, ai ka mundësi që me anën e metodave demokratike të edukojë e të riedukojë vetvehten në shkallë kombëtare me pjesëmarrjen e të gjithëve, në mënyrë që të çlirohet nga influenca e reaksionarëve të brendshëm e të jashtëm (tani kjo influencë është akoma shumë e madhe dhe do të mbetet për një kohë të gjatë e nuk mund të zhduket shumë shpejt), të flakë tej zakonet e këqia dhe idetë e dëmshme të trashëguara nga shoqëria e vjetër, të mos lejojë të tërhiqet nga reaksionarët në një rrugë të gabuar, por të vazhdojë të ecë përpara, të marshojë drejt shoqërisë socialiste dhe shoqërisë komuniste.

«Mbi diktaturën demokratike të popullit» (30 qershor 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Nuk është vështirë që njeriu të bëjë ndonjë gjë të mirë. Është vështirë që ai të bëjë gjëra të mira gjatë tërë jetës, pa bërë asgjë të keqe, të veprojë kurdoherë në interes të masave të gjera, në interes të

rinisë, në interes të revolucionit, të bëjë vazhdimisht një luftë këmbëngulëse gjatë dhjetra vjetëve, si gjatë një dite të vetme — ia, kjo është gjëja më e vështirë!

«Përshëndetje shokut U Y-çan me rastin e 60-vjetorit të ditëlindjes» (15 janar 1940).

XXV. UNITETI

Bashkimi i vendit, uniteti i popullit dhe kompaktësia e të gjitha kombësive të vendit — këto janë garancitë themelore të fitores së sigurtë të çështjes sonë.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Vetëm nëpërmjet unitetit të Partisë Komuniste mund të arrihet uniteti i gjithë klasës dhe i gjithë kombit; vetëm me unitetin e gjithë klasës dhe të gjithë kombit mund të mposhtet armiku dhe të plotësohen detyrat e revolucionit kombëtar e demokratik.

«Lufta për të tërhequr masat shumëmilionëshe në frontin unik kombëtar antijaponez» (7 maj 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Ne duhet të bashkojmë fort të gjitha forcat e partisë sonë në bazë të parimeve organizative dhe të disiplinës të centralizmit demokratik. Ne duhet të bashkohemi me çdo shok, në qoftë se ai është i gatshëm të zbatojë programin, statutin dhe vendimet e partisë.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Në vitin 1942 këtë metodë demokratike për zgjidhjen e kontradiktave në gjirin e popullit ne e kemi konkretizuar në formulën: "unitet — kritikë — unitet". Po ta shprehim më gjerë, kjo do të thotë: duke u nisur nga dëshira për unitet, me anën e kritikës ose të luftës, të zgjidhim kontradiktat dhe kështu të arrijmë një unitet të ri mbi një bazë të re. Siç tregon eksperienca jonë, kjo është një metodë e drejtë për zgjidhjen e kontradiktave në gjirin e popullit.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Kjo ushtri ka një unitet të mrekullueshëm brenda dhe jashtë saj. Brenda ushtrisë ka unitet midis oficerëve e ushtarëve, midis eprorëve e deprorëve, midis punës ushtarake, punës politike e shërbimeve të prapavijës; jashtë saj ka unitet midis ushtrisë e popullit, midis ushtrisë e organeve të pushtetit dhe midis trupave tona e trupave mike. Çdo gjë që e dëmton këtë unitet, duhet flakur tej medoemos.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

XXVI. DISIPLINA

Në gjirin e popullit demokracia presupozon centralizmin, kurse liria — disiplinën. Këto janë dy anë të kundërta të një të tëre të vetme. Ato janë të kundërta, por njëkohësisht edhe në unitet. Ne nuk duhet të theksojmë në mënyrë të njëanshme njërën dhe të mohojmë tjetrën. Në gjirin e popullit s'mund të bëhet pa liri, por s'mund të bëhet as pa disiplinë; s'mund të bëhet pa demokraci, por s'mund të bëhet as pa centralizëm. Një unitet i tillë i demokracisë dhe centralizmit, uniteti i lirisë dhe disiplinës është pikërisht centralizmi ynë demokratik. Në një sistem të tillë populli gëzon një demokraci dhe liri të gjerë, por në të njëjtën kohë ai duhet t'i përmbahet disiplinës socialiste.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Është e nevojshme të ritheksohet disiplina e partisë që kërkon:

1) nënshtrimin e individit ndaj organizatës;

2) nënshtrimin e pakicës ndaj shumicës;

3) nënshtrimin e instancave më të ulta ndaj instancave më të larta;

4) nënshtrimin e të gjithë anëtarëve të partisë ndaj Komitetit Qendror.

Kush i shkel këto kërkesa të disiplinës, ai prish unitetin e partisë.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Një nga kërkesat e disiplinës së partisë është që pakica t'i nënshtrohet shumicës. Edhe në qoftë se pikëpamja e saj hidhet poshtë, pakica duhet të mbështesë vendimin që merr shumica. Në rast nevoje, çështja mund të shtrohet përsëri për diskutim në mbledhjen e ardhshme, por nuk

lejohet asnjë veprim që bie në kundërshtim me vendimin e marrë.

«Mbi ndreqjen e mendimeve të gabuara në parti» (dhjetor 1929), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Tri rregullat kryesore të disiplinës konsistojnë në sa më poshtë:

1) Në çdo veprim t'u bindesh urdhërave.

2) Asnjë gjilpërë e asnjë pe të mos u marrësh masave popullore.

3) Gjithë plaçkën e luftës t'ja dorëzosh komandës.

Tetë pikat që duhen pasur parasysh konsistojnë në sa më poshtë:

1) Folë në mënyrë të njerëzishme.

2) Zbato ndershmërisht parimet e shitblerjes.

3) Sendin e marrë hua, ktheja të zotit.

4) Paguaje ose zëvendësoje atë që ke prishur.

5) Mos i rrih e mos i shaj të tjerët.

6) Mos i prish të mbjellat.

7) Mos u bjerë më qafë femrave.
8) Mos i trajto keq robërit e luftës.

«Udhëzime të Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Popullore Çlirimtare Kineze me rastin e rishpalljes së tri rregullave kryesore të disiplinës dhe të tetë pikave që duhen pasur parasysh» (10 tetor 1947), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Duhet të forcohet disiplina, të zbatohen vendosmërisht urdhërat, të vihet në jetë kursi politik, të respektohen tri rregullat kryesore të disiplinës dhe tetë pikat që duhen pasur parasysh, të sigurohet uniteti midis ushtrisë dhe popullit, midis ushtrisë dhe organeve të pushtetit, midis oficerëve dhe ushtarëve dhe uniteti i gjithë ushtrisë, të mos lejohet asnjë shkelje e disiplinës.

«Manifest i Ushtrisë Popullore Çlirimtare Kineze» (tetor 1947), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

XXVII. KRITIKA DHE AUTOKRITIKA

Partia Komuniste nuk i trembet kritikës, sepse ne jemi marksistë, e vërteta është me ne, masat kryesore — punëtorët dhe fshatarët — janë me ne.

> «Fjala e mbajtur në konferencën kombëtare të Partisë Komuniste të Kinës mbi punën e propagandës» (12 mars 1957).

Materialistët konsekuentë nuk kanë frikë nga asgjë. Ne shpresojmë se të gjithë njerëzit që luftojnë sëbashku me ne, do të mbajnë me guxim përgjegjësitë e tyre, do t'i kapërcejnë vështirësitë, nuk do t'u tremben as dështimeve, as thashethemeve e talljeve dhe nuk do të kenë frikë të na bëjnë neve, komunistëve, kritika e sugje-

rime. "Kush s'ka frikë se e bëjnë copë e thërrime, guxon të rrëzojë perandorin nga kali" — këtë frymë trimërie duhet të kemi në luftën për socializmin dhe komunizmin.

Po aty.

Ne kemi në dorë armën marksiste-leniniste të kritikës dhe autokritikës. Ne jemi të aftë ta flakim tej stilin e keq dhe të ruajmë të mirin.

«Raport në plenumin e dytë të Komitetit Qendror të zgjedhur nga Kongresi i 7-të i Partisë Komuniste të Kinës» (5 mars 1949), *Vepra të zgjedhura,* vëll. 5.

Një tjetër veçori e qartë që na dallon nga partitë e tjera, është autokritika serioze. E kemi thënë më parë se dhoma duhet fshirë rregullisht, përndryshe ajo do të mbushej me pluhura, se fytyra duhet larë rregullisht, përndryshe ajo do të mbulohej me zhul. Edhe në mendjet e shokëve tanë dhe në punën e partisë sonë mund të gru-

mbullohen pluhura, prandaj edhe ato duhen spastruar e larë. "Uji që rrjedh nuk qelbet dhe krimbi nuk zë vend në çivinë e derës" — kjo do të thotë se lëvizja e tyre e vazhdueshme e ndalon depërtimin e mikrobeve ose të parazitëve. Të kontrollojmë rregullisht punën tonë, të përhapim në procesin e këtij kontrolli stilin demokratik, të mos kemi frikë nga kritika dhe autokritika, por të veprojmë sipas fjalëve të urta e mësimdhënëse të popullit kinez: "Po e dite, folë; po fole, thuaji të tëra", "mos qorto atë që flet, po të dëgjosh, do të mësosh", "në paç gabime, ndreqi; në mos paç, ruhu nga to", — ky është i vetmi mjet efikas lufte kundër infektimit të mendjeve të shokëve tanë dhe të organizmit të partisë sonë nga gjithfarë pluhurash politike dhe mikrobesh politike.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Në parti lindin vazhdimisht kundërshtime dhe luftë mendimesh të ndryshme. Ky është pasqyrimi në parti i kontradiktave

që ekzistojnë në shoqëri midis klasave, midis së resë dhe së vjetrës. Në qoftë se në parti nuk do të kishte kontradikta dhe luftë ideologjike për zgjidhjen e tyre, jeta e partisë do të pushonte.

«Mbi kontradiktën» (gusht 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Ne jemi për një luftë ideologjike aktive, sepse ajo është një armë, me anën e së cilës arrihet uniteti i brendshëm i partisë dhe i organizatave revolucionare në interes të luftës sonë. Çdo komunist e çdo revolucionar duhet ta zotërojë këtë armë.

Mirëpo liberalizmi e hedh poshtë luftën ideologjike dhe është për një paqe pa parim. Si rrjedhim, kjo lind stilin e kalbur e vulgar dhe i çon në degjenerimin politik disa hallka të veçanta e disa anëtarë të veçantë të partisë dhe të organizatave revolucionare.

«Kundër liberalizmit» (7 shtator 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Në luftën tonë kundër subjektivizmit, sektarizmit dhe skemave të gatshme në parti, ne duhet të kemi parasysh dy qëllime: së pari, "nxirr mësime nga gabimet e bëra që t'u shmangesh në të ardhmen" dhe, së dyti, "mjekoje të sëmurin për ta shpëtuar". Është e domosdoshme të nxjerrim në shesh të gjitha gabimet e bëra më parë, pavarësisht nga konsideratat personale, të analizojmë dhe të kritikojmë në mënyrë shkencore çdo gjë negative të së kaluarës, me qëllim që në të ardhmen të punojmë më të matur dhe më mirë. Ky është kuptimi i shprehjes "nxirr mësime nga gabimet e bëra që t'u shmangesh në të ardhmen". Megjithatë, duke nxjerrë në shesh gabimet dhe duke kritikuar të metat, kemi po atë qëllim që ka doktori, i cili e mjekon të sëmurin vetëm e vetëm për t'i shpëtuar jetën, e jo që ta bëjë të vdesë. Një njeri sëmuret nga apendiciti, doktori ja heq zorrën e verbër dhe kështu ai shpëton. Cilindo që ka bërë gabime, në qoftë se nuk e fsheh sëmundjen e nuk i shmanget mjekimit, nuk ngul këmbë në gabimet e veta aq sa të arrijë në një gjendje të pashërue-

shme, por tregohet i ndershëm, çfaq me të vërtetë dëshirën për t'u mjekuar dhe për t'u ndrequr, ne duhet ta përshëndesim, duhet ta shërojmë që të bëhet një shok i mirë. Kjo punë nuk do të jepte rezultate, në qoftë se ne, duke u tërhequr nga një rrëmbim i çastit, do ta godisnim si të na donte qejfi. Në mjekimin e sëmundjeve ideologjike e politike, në asnjë mënyrë nuk duhet të mbajmë qëndrim brutal, por duhet të mbajmë qëndrimin "mjekoje të sëmurin për ta shpëtuar". Kjo është e vetmja metodë e drejtë dhe efikase.

«Për ndreqjen e stilit në parti» (1 shkurt 1942), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Në lidhje me çështjen e kritikës brenda partisë, duhet vënë në dukje edhe një gjë tjetër: disa shokë në kritikën e tyre vëmendjen nuk ja kushtojnë asaj që është kryesore, por vetëm vogëlimave. Ata nuk e kuptojnë se detyra kryesore e kritikës është që të vërë në dukje gabimet politike dhe organizative. Përsa u përket të metave personale, në qoftë se ato nuk janë të

lidhura me gabime politike dhe organizative, nuk është nevoja të kritikohen rëndë, përndryshe shokët nuk do të dinë si të veprojnë. Në qoftë se do të përhapej një kritikë e tillë, vëmendja e organizatës së partisë do të përqëndrohej krejtësisht në të metat e vogla, të gjithë do të shndërroheshin në njerëz të ndrojtur që merren me vogëlima, duke harruar detyrat politike të partisë. Ky është një rrezik shumë i madh.

«Mbi ndreqjen e mendimeve të gabuara në parti» (dhjetor 1929), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Duke zhvilluar kritikën në parti, duhet të ruhemi nga gjykimet subjektiviste e arbitrare dhe nga vulgarizimi i kritikës. Kur diskutojmë, duhet të kemi argumenta dhe kur kritikojmë, duhet t'i kushtojmë vëmendje anës politike.

Po aty.

Kritika brenda partisë është një armë që shërben për forcimin e organizatës së partisë dhe për rritjen e aftësisë luftarake të

partisë. Mirëpo kritika në organizatat e partisë të Ushtrisë së Kuqe në disa raste nuk është e tillë, ajo shndërrohet në sulme personale dhe si rrjedhim dëmton jo vetëm persona të veçantë, por edhe organizatat e partisë. Kjo është një çfaqje e individualizmit mikroborgjez. Për ta ndrequr këtë duhet që anëtarët e partisë të kuptojnë se qëllimi i kritikës është forcimi i aftësisë luftarake të partisë për arritjen e fitores në luftën e klasave dhe se nuk duhet ta përdorin kritikën si mjet për sulme personale.

Po aty.

Në qoftë se ne kemi të meta, nuk kemi frikë se të tjerët do të na kritikojnë dhe do të na i vënë në dukje ato, sepse ne i shërbejmë popullit. Cilido qoftë mund të na i vërë në dukje të metat tona. Po na kritikove drejt, ne do t'i ndreqim ato. Në qoftë se propozimi yt është në interes të popullit, ne do të veprojmë simbas teje.

«T'i shërbejmë popullit» (8 shtator 1944), *Vepra të zgjedhura,* vëll. 4.

Komunistët kinezë, të cilët udhëhiqen nga interesat më të larta të masave më të gjera të popullit kinez, janë të bindur se çështja e tyre është plotësisht e drejtë; ata nuk ngurojnë të sakrifikojnë për të çdo gjë personale dhe janë gjithmonë të gatshëm të bëjnë fli për të edhe jetën e tyre. A do të kishte vallë ide, pikëpamje, mendime, metoda, nga të cilat ne nuk do të donim të hiqnim dorë, në qoftë se ato nuk do t'u përgjigjeshin nevojave të popullit? A do të pranonim ne që gjithfarë ndyrësirash politike ose mikrobesh politike të zhyenin fytyrën tonë të pastër dhe të brenin organizmin tonë të shëndoshë? Kur ne, që jetojmë, sjellim ndërmend dëshmorët e panumërt të revolucionit, që dhanë jetën e tyre për interesat e popullit, na mbushen zemrat plot hidhërim. Pra a do të kishte interesa personale, të cilat nuk do të mund t'i sakrifikonim? A do të kishte gabime, të cilat nuk do të mund t'i flaknim tej?

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Në asnjë rast ne nuk duhet të kënaqemi në vetvehte që në suksesin e parë. Ne duhet të ruhemi nga vetëkënaqësia, të kritikojmë vazhdimisht të metat tona, sikurse çdo ditë lajmë fytyrën dhe fshijmë dyshemenë për të mbajtur pastërtinë e për të hequr pluhurat.

«Organizohuni!» (29 nëndor 1943), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Kritika duhet bërë në kohë; duhet hequr dorë nga mania për të bërë kritika të vonuara.

«Mbi çështjen e kooperimit të bujqësisë» (31 korrik 1955).

Duke mësuar nga gabimet dhe mossukseset, ne jemi bërë më të zgjuar dhe puna jonë shkon më mirë. Cilado parti qoftë, cilido individ qoftë e ka vështirë t'u shmanget gabimeve, por ne kërkojmë që gabime të bëhen sa më pak. Me t'u bërë

një gabim, ne kërkojmë që ai të ndreqet, dhe sa më shpejt e rrënjësisht që ai të ndreqet, aq më mirë do të jetë.

«Mbi diktaturën demokratike të popullit» (30 qershor 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

XXVIII. KOMUNISTËT

Komunisti duhet të jetë i sinqertë, besnik dhe aktiv, interesat e revolucionit duhet të jenë për të më të shtrenjta se jeta, interesat personale duhet t'ua nënshtrojë interesave të revolucionit. Kurdoherë dhe kudo ai duhet t'u përmbahet parimeve të drejta, të zhvillojë një luftë të palodhur kundër të gjitha mendimeve dhe veprimeve të gabuara, në mënyrë që të forcojë jetën kolektive të partisë dhe lidhjet e partisë me masat. Ai duhet të kujdeset më shumë për partinë dhe për masat se sa për vehten, më shumë për të tjerët se sa për vehten. Vetëm kështu ai do ta meritojë emrin e komunistit.

«Kundër liberalizmit» (7 shtator 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Duhet që çdo shok ta kuptojë se në të gjitha fjalët dhe veprat e një komunisti kriteri më i lartë është se sa ato u përgjigjen interesave më të larta të masave më të gjera të popullit, se sa ato gjejnë përkrahjen e tyre.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Komunistët asnjëherë dhe asgjëkundi nuk duhet t'i vënë interesat personale në plan të parë, por duhet t'ua nënshtrojnë ato interesave të kombit dhe të masave popullore. Prandaj egoizmi, pasiviteti, çthurja në punë, vjedhja, degjenerimi, lakmia për t'u dukur etj., meritojnë përbuzjen më të madhe, kurse vetëmohimi, aktiviteti, devocioni në kryerjen e detyrës shoqërore dhe puna këmbëngulëse meritojnë respekt.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Komunisti duhet të jetë kurdoherë i gatshëm të mbrojë me vendosmëri të vërtetën, sepse e vërteta përputhet me interesat e popullit. Komunisti duhet të jetë kurdoherë i gatshëm të ndreqë gabimet, sepse asnjë gabim nuk përputhet me interesat e popullit.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Për çdo gjë komunisti duhet t'i bëjë vehtes pyetjen: "pse?", duhet ta analizojë vetë atë në mënyrë të gjithanshme, duhet të mendojë nëse ajo i përgjigjet realitetit, nëse është me të vërtetë e arësyeshme. Në asnjë mënyrë ai nuk duhet të ndjekë verbërisht të tjerët dhe të predikojë qëndrimin prej skllavi ndaj tyre.

«Për ndreqjen e stilit në parti» (1 shkurt 1942), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Duhet bërë që çdo shok të marrë parasysh interesat e së tërës. Çdo anëtar i partisë, puna në çdo sektor, çdo fjalë ose

veprim duhet të kenë si pikënisje interesat e gjithë partisë. Në asnjë mënyrë nuk lejohet shkelja e këtij parimi.

Po aty.

Komunistët duhet të jenë shembull si njerëz që në bazë të fakteve zbulojnë të vërtetën, si njerëz largpamës dhe me horizont të gjerë, sepse vetëm duke e zbuluar të vërtetën në bazë të fakteve ata mund të kryejnë detyrat që u janë ngarkuar dhe vetëm duke qenë largpamës dhe duke pasur horizont të gjerë, ata nuk do të humbasin orientimin në ecjen e tyre përpara.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Komunistët duhet të tregojnë largpamësinë më të madhe, vetëmohimin më të madh, vendosmërinë më të madhe dhe zotësinë më të madhe për ta studiuar gjendjen me mo-

desti, ata duhet të mbështeten në shumicën e masave dhe të fitojnë përkrahjen e tyre.

«Detyrat e Partisë Komuniste të Kinës në periudhën e Luftës së Rezistencës kundër Japonisë» (3 maj 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Komunistët duhet të jenë shembull edhe në mësim; ata duhet të jenë çdo ditë si mësues të masave, ashtu edhe nxënës të tyre.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Në lëvizjet e masave, komunisti duhet të jetë mik i masave dhe jo shef, ai duhet të jetë një mësues i palodhur, e jo një politikan burokrat.

Po aty.

Komunistët nuk duhet të shkëputen kurrë nga shumica e masave, nuk duhet të

vrapojnë përpara të vetmuar dhe si kokë-krisur në krye të një pakice të përparuar, pa marrë parasysh gjendjen e shumicës. Ata duhet të kujdesen për vendosjen e lidhjeve të ngushta midis elementëve të përparuar dhe masave të gjera. Pikërisht kjo do të thotë të kesh parasysh shumicën.

Po aty.

Ne, komunistët, jemi si fara, ndërsa populli është si toka. Kudo që të shkojmë, ne duhet të bashkohemi me popullin, të zëmë rrënjë dhe të lulëzojmë në mes të popullit.

«Mbi bisedimet e Çuncinit» (17 tetor 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Ne, komunistët, në çdo punë duhet të dimë të lidhemi me masat. A do të mundin anëtarët e partisë sonë t'i sjellin ndonjë dobi popullit kinez, në qoftë se ata do të rrinë gjithë jetën të mbyllur brenda katër mureve, duke u fshehur nga stuhitë dhe duke mos u futur në jetë? Jo, asnjë dobi.

Ne nuk kemi nevojë për njerëz të tillë si anëtarë partie. Ne, komunistët, duhet të kalitemi përmes stuhive, duhet të futemi në jetë. Këto stuhi janë stuhitë e mëdha të luftës së masave dhe kjo jetë është jeta e madhe e masave që luftojnë.

«Organizohuni!» (29 nëndor 1943), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Roli pararojë e shembullor i komunistëve ka një rëndësi shumë të madhe. Në Armatën e 8-të dhe në Korpusin e 4-të të Ri komunistët duhet të japin shembullin e trimërisë në luftim, të zbatimit të urdhërave, të respektimit të disiplinës, të zhvillimit të punës politike, të kompaktësisë dhe të unitetit të brendshëm.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Komunisti kurrë nuk duhet ta quajë vehten të pagabueshëm, të sillet me arrogancë, të mendojë se ai ka çdo gjë të mirë,

kurse të tjerët s'kanë asgjë të mirë. Ai nuk duhet të mbyllet në asnjë mënyrë në guaskën e tij, të mburrë e të lavdërojë vetvehten, ta quajë vehten zot të plotfuqishëm.

«Fjalim i mbajtur në Asamblenë e Zonës Kufitare Shensi-Gansu-Ninsia» (21 nëndor 1941), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Komunistët duhet të dëgjojnë me vëmendje mendimet e njerëzve pa parti dhe t'u japin mundësi atyre të shprehen. Në qoftë se ata thonë gjëra të drejta, ne duhet ta përshëndesim këtë dhe të marrim nga ata çdo gjë pozitive. Në qoftë se ata thonë gjëra jo të drejta, ne prapë duhet t'i lëmë të shprehin plotësisht mendimet e tyre, e pastaj t'i sqarojmë me durim.

Po aty.

Ata që kanë bërë gabime në punë, me përjashtim të njerëzve të pandreqshëm, komunistët nuk duhet t'i braktisin, por duhet t'i bindin që të kuptojnë gabimet e

tyre dhe t'i ndreqin, të heqin dorë nga rruga e vjetër dhe të ndjekin rrugën e re.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Ndaj njerëzve të prapambetur komunistët nuk duhet të mbajnë qëndrim përbuzës ose mospërfillës, por duhet t'u afrohen atyre, të bashkohen me ta, t'i bindin dhe t'i inkurajojnë për të shkuar përpara.

Po aty.

XXIX. KUADROT

Për të qenë të sigurtë se partia dhe vendi ynë nuk do të ndryshojnë ngjyrë, ne duhet jo vetëm të kemi një vijë dhe një politikë të drejtë, por edhe të pregatisim dhe të formojmë miliona vazhdues të çështjes së revolucionit proletar.

Pregatitja e vazhduesve të çështjes së revolucionit proletar në thelb ka të bëjë me çështjen nëse do të kemi njerëz që të vazhdojnë veprën revolucionare të marksizëm-leninizmit, të filluar nga revolucionarët proletarë të brezit të vjetër, me çështjen nëse udhëheqja e partisë dhe e shtetit tonë do të vazhdojë të ndodhet edhe në të ardhmen në duart e revolucionarëve proletarë, me çështjen nëse brezat tona të ardhshme do të vazhdojnë të ecin përpara në rrugën e drejtë marksiste-leniniste, pra me çështjen

nëse ne do të mund të ndalojmë me sukses çfaqjen e revizionizmit hrushovian edhe në Kinë. Me një fjalë, kjo është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme, çështje jete a vdekjeje për fatin e partisë dhe të shtetit tonë. Kjo është një çështje me rëndësi themelore për veprën e revolucionit proletar gjatë njëqind, njëmijë dhe bile dhjetëmijë vjetëve. Profetët imperialistë, duke u nisur nga ndryshimet që kanë ndodhur në Bashkimin Sovjetik, gjithashtu i varin shpresat e tyre për një "evolucion paqësor" tek brezi i tretë ose i katërt i komunistëve kinezë. Ne duhet të bëjmë medoemos që këto profeci imperialiste të dështojnë plotësisht. Ne patjetër duhet, në qendër e në bazë, t'u kushtojmë kudo një vëmendje të përhershme pregatitjes dhe formimit të vazhduesve të çështjes së revolucionit.

Ç'vetija duhet të kenë ata që të jenë vazhdues të çështjes së revolucionit proletar?

Ata duhet të jenë marksistë-leninistë të vërtetë, e jo si Hrushovi, revizionistë që mbulohen me etiketën e marksizëm-leninizmit.

Ata duhet të jenë revolucionarë që i shërbejnë me mish e me shpirt shumicës dërmuese të popullsisë së Kinës e të mbarë botës, e jo si Hrushovi, që në vendin e tij u shërben interesave të një grushti elementësh që përbëjnë shtresën e privilegjuar borgjeze, kurse në arenën ndërkombëtare — interesave të imperialistëve dhe reaksionarëve.

Ata duhet të jenë militantë politikë proletarë që dinë të bashkohen me shumicën dërmuese të njerëzve dhe të punojnë sëbashku me ta. Ata duhet jo vetëm të bashkohen me njerëzit që kanë mendime të njëjta me ta, por edhe të dinë të bashkohen me njerëzit që mendojnë ndryshe, bile edhe me njerëz që kanë qenë kundër tyre dhe që, siç ka vërtetuar praktika, e kanë pasur gabim. Por duhet të tregohet një vigjilencë e veçantë ndaj karrieristëve dhe intrigantëve të tillë si Hrushovi, dhe t'i pritet rruga uzurpimit të udhëheqjes në instancat e ndryshme të partisë dhe të shtetit nga ana e këtyre elementëve të këqinj.

Ata duhet të jenë shembull në zbatimin e centralizmit demokratik të partisë, të përvehtësojnë metodën e udhëheqjes që mbështetet në parimin "të marrim nga masat dhe të çojmë në masat", të përpunojnë një stil demokratik në punë, të dinë të dëgjojnë zërin e masave. Ata nuk duhet, si Hrushovi, të minojnë centralizmin demokratik të partisë, të sillen si despotë, të sulmojnë shokët në befasi, të veprojnë në mënyrë arbitrare dhe të vendosin diktaturën personale.

Ata duhet të jenë modestë dhe të matur, të ruhen nga mendjemadhësia e gjaknxehtësia, të kenë frymën e autokritikës dhe të ndreqin me guxim të metat e gabimet e veta në punë. Ata në asnjë mënyrë nuk duhet, si Hrushovi, të mbulojnë gabimet e veta, t'ja atribuojnë vehtes të gjitha meritat, ndërsa të gjitha gabimet t'ua hedhin të tjerëve.

Vazhduesit e çështjes së revolucionit proletar lindin në luftën e masave dhe rriten duke u kalitur përmes stuhive dhe dallgëve të revolucionit. Duhet që kuadrot t'i provojmë e t'i vlerësojmë, që

vazhduesit tanë t'i zgjedhim e t'i pregatisim pikërisht në procesin e luftës së gjatë të masave.

Cituar në artikullin «Mbi pseudokomunizmin hrushovian dhe mësimet historike botërore që dalin prej tij» (14 korrik 1964).

Partia jonë duhet t'i shtrijë organizatat e saj në gjithë vendin dhe të pregatisë në mënyrë të ndërgjegjshme dhjetra mijëra kuadro, ajo duhet të ketë qindra udhëheqës të shkëlqyer masash. Këta duhet të jenë kuadro e udhëheqës që zotërojnë marksizëm-leninizmin, të jenë largpamës në politikë, të zotë në punë, të mbrujtur me frymën e sakrificës, të aftë për t'i zgjidhur çështjet në mënyrë të pavarur, të palëkundshëm në vështirësi dhe të devotshëm në shërbim të kombit, të klasës dhe të partisë. Duke u mbështetur në ta, partia mban lidhje me anëtarët e saj dhe me masat e, duke u mbështetur në udhëheqjen e vendosur të masave prej tyre, do t'ja arrijë qëllimit, shpartallimit të armikut. Për ta duhet të jenë të huaj egoizmi, heroizmi individual

dhe lakmia për t'u dukur, dembellëku, pasiviteti dhe sektarizmi fudull; ata duhet të jenë heronj vetëmohues dhe të devotshëm të kombit dhe të klasës së tyre. Këto janë cilësitë dhe stili, me të cilët duhet të pajisen komunistët, kuadrot dhe udhëheqësit e partisë.

> «Lufta për të tërhequr masat shumëmilionëshe në frontin unik kombëtar antijaponez» (7 maj 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Mbasi të jetë përcaktuar vija politike, faktor vendimtar bëhen kuadrot. Prandaj pregatitja sistematike e kuadrove të reja të shumta është detyra jonë luftarake.

> «Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Kriteri i Partisë Komuniste në politikën e saj të kuadrove duhet të jetë: vendosmëria në zbatimin e vijës së partisë, nënshtrimi

ndaj disiplinës së partisë, lidhjet e ngushta me masat, aftësia për të punuar në mënyrë të pavarur, aktiviteti në punë dhe mospërfillja e interesave personale. Kjo është politika e "caktimit të kuadrove sipas cilësive të tyre".

Po aty.

Duhet të zbatojmë me vendosmëri sistemin e pjesëmarrjes së kuadrove në punën kolektive prodhuese. Kuadrot e partisë dhe të shtetit tonë janë punonjës të thjeshtë dhe jo zotërinj që i rrinë popullit në zverk. Duke marrë pjesë në punët kolektive prodhuese, kuadrot mbajnë lidhjet më të gjera, të vazhdueshme dhe të ngushta me punonjësit. Kjo është një çështje e madhe me rëndësi themelore për rendin socialist dhe ndihmon për të zhdukur burokratizmin e për t'i prerë rrugën revizionizmit dhe dogmatizmit.

Cituar në artikullin «Mbi pseudokomunizmin hrushovian dhe mësimet historike botërore që dalin prej tij» (14 korrik 1964).

Duhet të dimë t'i vlerësojmë kuadrot. Për kuadrot duhet të gjykojmë jo vetëm në bazë të një kohe të caktuar të veprimtarisë së tyre dhe të fakteve të veçanta, por në bazë të gjithë së kaluarës dhe të gjithë punës së tyre. Kjo është metoda kryesore për vlerësimin e kuadrove.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Duhet të dimë t'i përdorim kuadrot. Shkurt, një drejtues ka dy detyra kryesore: të japë ide dhe të përdorë kuadrot. Të gjitha planet, rezolutat, urdhërat, udhëzimet etj., hyjnë në nocionin "të japim ide". Dhe me qëllim që çdo ide të vihet në jetë, duhet t'i bashkojmë kuadrot dhe t'i inkurajojmë për veprim, dhe kjo hyn në nocionin "të përdorim kuadrot".

Po aty.

Duhet të dimë të kujdesemi për kuadrot. Mënyrat e kujdesjes për to janë:

Së pari, t'i orientojmë ato. Kjo do të thotë t'u lësh atyre iniciativë në punë, që të kenë guxim për të marrë përsipër përgjegjësinë, dhe njëkohësisht t'u japësh atyre në kohën e duhur udhëzime, në mënyrë që të zhvillojnë aftësitë e tyre krijuese, duke u udhëhequr nga vija politike e partisë.

Së dyti, të ngrejmë nivelin e tyre. Kjo do të thotë t'u japësh atyre mundësi të mësojnë, t'i edukosh ato në mënyrë që të ngrejnë nivelin e tyre teorik dhe të rrisin aftësitë e tyre në punë.

Së treti, të kontrollojmë punën e tyre, t'i ndihmojmë ato të përgjithësojnë eksperiencën, të shtojnë sukseset dhe të ndreqin gabimet e tyre. T'u ngarkosh kuadrove një punë, pa e kontrolluar kryerjen e saj dhe të kujdesesh vetëm pasi të jenë bërë gabime të rënda — kjo nuk është mënyrë kujdesjeje për kuadrot.

Së katërti, kundrejt kuadrove që kanë bërë gabime duhet të përdorim në përgjithësi metodën e bindjes, duke i ndihmuar që t'i ndreqin gabimet. Duhen luftuar vetëm ata që kanë bërë gabime

të rënda dhe që nuk pranojnë këshillat. Këtu duhet durim. Nuk është e drejtë t'u ngjitësh të tjerëve me mendjelehtësi etiketën e "oportunistit" dhe të "hapësh luftë" me mendjelehtësi kundër tyre.

Së pesti, duhet t'i ndihmojmë kuadrot për kapërcimin e vështirësive. Kur ata sëmuren ose u dalin vështirësi të tjera në jetë apo në familje, duhet që brenda mundësive t'u japim ndihmën e nevojshme.

Këto janë mënyrat e kujdesjes për kuadrot.

Po aty.

Një grup drejtues me të vërtetë i bashkuar dhe i lidhur me masat duhet të formohet gradualisht, gjatë luftës së masave; ai nuk mund të formohet duke qëndruar larg kësaj lufte. Në shumicën e rasteve, gjatë një lufte të madhe, në etapën fillestare, në etapën e mesme dhe në atë përfundimtare të saj, grupi drejtues nuk duhet dhe nuk mund të mbetet pa pësuar ndryshime në përbërjen e tij. Duhet të zgjidhen vazhdimisht aktivistë të rritur

gjatë luftës për të zëvendësuar ata pjesëtarë të grupit drejtues, që në krahasim me të tjerët janë treguar më të dobët ose që janë degjeneruar.

> «Disa çështje në lidhje me metodat e udhëheqjes» (1 qershor 1943), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Në qoftë se në partinë tonë nuk do të ketë një numër të madh kuadrosh të reja që të punojnë në unitet me kuadrot e vjetra, çështja jonë do të mbetet në mes të rrugës. Prandaj të gjitha kuadrot e vjetra duhet t'i presin me ngrohtësinë më të madhe kuadrot e reja dhe të kujdesen për to. Ç'është e vërteta, kuadrot e reja kanë mungesat e tyre: ato kanë marrë pjesë në revolucion vetëm pak kohë më parë, atyre u mungon akoma eksperienca, disa prej tyre kanë akoma gjurmë të ideologjisë së huaj të shoqërisë së vjetër, domethënë mbeturina të ideologjisë individualiste mikroborgjeze. Por këto mungesa mund të zhduken dalëngadalë gjatë punës edukative dhe kalitjes revolu-

cionare. Tiparet pozitive të kuadrove të reja qëndrojnë, sikurse ka thënë J. V. Stalini, në faktin se ato kanë ndjenjën e hollë të së resë, prandaj shquhen për entuziazmin dhe aktivitetin e tyre të lartë. Dhe është pikërisht kjo që u mungon disa kuadrove të vjetra. Kuadrot e reja dhe të vjetra duhet të kenë respekt për njëri tjetrin, të mësojnë nga njëri tjetri, të zhdukin të metat e tyre, duke marrë nga njëri tjetri cilësitë pozitive, me qëllim që të bashkohen si një trup i vetëm për çështjen e përbashkët dhe t'u presin rrugën tendencave sektare.

«Për ndreqjen e stilit në parti» (1 shkurt 1942), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Duhet të kujdesemi jo vetëm për kuadrot e partisë, por edhe për kuadrot pa parti. Jashtë partisë ka shumë njerëz të aftë, të cilët Partia Komuniste nuk mund t'i lërë mënjanë. Detyra e çdo komunisti është të flakë tej çdo tendencë veçimi e mendjemadhësie, të dijë të bashkëpunojë me

kuadrot pa parti, t'i ndihmojë sinqerisht ato, të mbajë një qëndrim të ngrohtë e shoqëror kundrejt tyre dhe ta drejtojë aktivitetin e tyre në çështjen e madhe të Luftës së Rezistencës kundër Japonisë dhe të ndërtimit të vendit.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

XXX. RINIA

Bota është juaja, është edhe jona, por në fund të fundit ajo ju takon juve. Ju, të rinjtë, jeni plot energji e gjallëri, jeni në kohën e lulëzimit të jetës, posi dielli në orën tetë ose nëndë të mëngjezit. Tek ju i kemi shpresat.

. . . . . .

Bota ju përket juve. E ardhmja e Kinës ju përket juve.

Bisedë në takimin me studentët dhe praktikantët kinezë në Moskë (17 nëndor 1957).

Duhet të bëjmë që gjithë rinia të kuptojë se vendi ynë sot është akoma shumë i varfër, se kjo gjendje është e pamundur të ndryshojë rrënjësisht brenda një kohe të shkurtër dhe se vetëm kur të jenë bashkuar për luftë rinia dhe gjithë populli,

ata brenda disa dhjetra vjetëve do të mund të ndërtojnë me duart e tyre një vend të begatshëm dhe të fuqishëm. Vendosja e rendit socialist na hapi rrugën drejt një shoqërie ideale, por që kjo të bëhet realitet, na duhet një punë e palodhur.

> «Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Mjaft të rinj për shkak të mungesës së përvojës politike dhe të përvojës në jetën shoqërore, nuk janë në gjendje të shohin kontrastin midis Kinës së vjetër dhe Kinës së re, nuk e kanë lehtë të kuptojnë thellë sa e rëndë dhe e vështirë ishte lufta, me anën e së cilës populli ynë mundi të çlirohej nga shtypja e imperializmit dhe e reaksionit të Gomindanit, se ç'punë këmbëngulëse dhe e gjatë duhet bërë për të ndërtuar shoqërinë e mrekullueshme socialiste. Prandaj duhet që me masat të zhvillojmë vazhdimisht një punë politike e edukative të gjallë dhe frytdhënëse, t'u sqarojmë vazhdimisht atyre të vërtetën mbi vështirësitë që lindin dhe bashkë me to të

gjejmë rrugët për kapërcimin e këtyre vështirësive.

Po aty.

Të rinjtë përbëjnë forcën më aktive, më të gjallë të gjithë shoqërisë sonë. Ata janë më të zellshëm në studim dhe më pak të lidhur me idetë konservatore, gjë që vihet re veçanërisht në epokën e socializmit. Ne shpresojmë se organizatat e partisë të krahinave do t'i ndihmojnë organizatat e Bashkimit të Rinisë dhe do të punojnë bashkë me to, do të studiojnë me vëmendje çështjen se si të vënë në veprim sidomos forcën e të rinjve dhe të mos i trajtojnë ata si të tjerët duke mohuar veçoritë e tyre. Natyrisht, të rinjtë duhet të mësojnë nga pleqtë e të rriturit dhe të përpiqen të sigurojnë, sa të jetë e mundur, pëlqimin e tyre kur ndërmarrin aktivitete të ndryshme të dobishme.

Shënim mbi artikullin «Brigada sulmuese e të rinjve të kooperativës bujqësore të prodhimit Nr. 9 të lokalitetit Sinpin, distrikti Çongshan» (1955), *Hovi i socializmit në fshatin kinez.*

Çfarë kriteri duhet ndjekur për të përcaktuar nëse një i ri është revolucionar? Si ta dallojmë? Ka vetëm një kriter: duhet parë a dëshiron ky i ri të bashkohet me masat e gjera të punëtorëve e të fshatarëve dhe a bashkohet ai me të vërtetë me to. Ai që dëshiron të bashkohet me punëtorët e fshatarët dhe që e bën këtë me të vërtetë, është revolucionar; përndryshe, ai nuk është revolucionar ose është kundërrevolucionar. Ai që sot bashkohet me masat e punëtorëve dhe të fshatarëve, ai sot është revolucionar. Por, në qoftë se nesër ai nuk do të bashkohet me to ose, përkundrazi, do të shtypë popullin e thjeshtë, ai nuk do të jetë revolucionar, ose do të jetë kundërrevolucionar.

«Drejtimi i zhvillimit të lëvizjes së rinisë» (4 maj 1939), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 3.

Përderisa intelektualët nuk janë bashkuar me luftën revolucionare të masave, përderisa ata nuk janë të vendosur t'u shërbejnë interesave të masave dhe të lidhen

me masat, ata shpesh çfaqin tendenca subjektivizmi dhe individualizmi, idetë e tyre shpesh janë të zbrazta, veprimet e tyre shpesh janë të lëkundshme. Prandaj, ndonëse masat e gjera të intelektualëve revolucionarë të Kinës luajnë rolin e iniciatorit dhe shërbejnë si përçues, jo të gjithë intelektualët mund të marrin pjesë deri në fund në revolucion. Një pjesë e tyre në çastet kritike të revolucionit shkëputen nga radhët e tij dhe mbajnë një qëndrim pasiv, ndërsa një numër i vogël i tyre bëhen armiq të revolucionit. Këto dobësi të intelektualëve mund të zhduken vetëm në luftën e gjatë të masave.

«Revolucioni kinez dhe Partia Komuniste e Kinës» (dhjetor 1939), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 3.

Përveç detyrës që të vazhdojë të bashkërendojë punën e vet me punën kryesore të partisë, Bashkimi i Rinisë duhet të zhvillojë një punë të pavarur në përshtatje me karakteristikat e të rinjve. Kina e re duhet të mendojë për të rinjtë, të kujdeset për rritjen

e brezit të ri. Të rinjtë duhet të mësojnë e të punojnë; por ata janë në periudhën e zhvillimit fizik, prandaj duhet të tregohet kujdes i madh si për punën dhe mësimin e të rinjve, ashtu dhe për argëtimet, aktivitetet sportive dhe çlodhjen e tyre.

Udhëzime të dhëna gjatë takimit me presidiumin e Kongresit të 2-të të Bashkimit të Rinisë (30 qershor 1953).

XXXI. GRUAJA

Burrat në Kinë në përgjithësi gjenden nën sundimin e tre sistemeve pushtetesh (pushteti politik, pushteti fisnor, pushteti fetar — shën. i red.). . . . Ndërsa gratë, përveç këtyre, ndodhen edhe nën sundimin e burrit (pushteti i burrit). Këto katër pushtete — pushteti politik, pushteti fisnor, pushteti fetar dhe pushteti i burrit — përfaqësojnë gjithë ideologjinë e sistemin feudal-patriarkal dhe janë katër litarë të trashë që lidhin popullin kinez dhe në mënyrë të veçantë fshatarësinë. Më sipër u përshkrua se si fshatarët po e përmbysin në fshat pushtetin politik të çifligarëve. Pushteti politik i çifligarëve është boshti, rreth të cilit vërtiten të gjitha pushtetet e tjera. Me përmbysjen e pushtetit politik të çifligarëve, fillojnë të lëkunden edhe

pushteti fisnor, pushteti fetar, pushteti i burrit. . . . Përsa i përket pushtetit të burrit, në familjet e fshatarëve të varfër ai kurdoherë ka qenë më i dobët, meqenëse gratë në këto familje, për shkak të gjendjes ekonomike, ishin të shtrënguara të merrnin pjesë në punë më shumë se sa gratë në klasat pasanike; për këtë arësye ato e fitojnë më shumë të drejtën e fjalës — bile të drejtën e vendosjes mbi punët në familje. Në këta vjetët e fundit, me rrenimin gjithnjë e më të madh të ekonomisë në fshat, u shkallmua edhe vetë baza e nënshtrimit të gruas ndaj burrit. Kohët e fundit, me lindjen e lëvizjes fshatare, gratë në shumë vise kanë krijuar bashkimet e grave fshatare; erdhi edhe për to koha që të ngrenë kokën dhe pushteti i burrit po lëkundet çdo ditë e më shumë. Me një fjalë, me rritjen e pushtetit të fshatarëve u tronditën gjithë ideologjia dhe sistemi feudal-patriarkal.

«Raport mbi studimin e bërë në provincën e Hunanit në lidhje me lëvizjen fshatare» (mars 1927), *Vepra të zgjedhura*, vëll. I.

Bashkohuni, merrni pjesë në prodhim e në aktivitete politike për të përmirësuar pozitën ekonomike dhe politike të gruas.

Mbishkrim për revistën «Gratë e Kinës së re», Nr. 1, 20 korrik 1949.

Të mbrohen interesat e të rinjve, të grave dhe të fëmijve, të ndihmohen të rinjtë që nuk kanë mundësi të vazhdojnë studimet, të organizohen të rinjtë e gratë që të marrin pjesë me të drejta të barabarta në aktivitete të dobishme për Luftën e Rezistencës kundër Japonisë dhe për përparimin shoqëror; të sigurohet liria e martesës dhe barazia e grave me burrat; t'u jepet mundësi të rinjve dhe fëmijve të fitojnë arësim të dobishëm. . .

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Detyra jonë më themelore në lëmin e prodhimit bujqësor është përdorimi i orga-

nizuar e racional i krahëve të punës dhe tërheqja e grave në prodhim.

«Politika jonë ekonomike» (23 janar 1934), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Për ndërtimin e shoqërisë së madhe socialiste, një rëndësi jashtëzakonisht të madhe ka mobilizimi i masave të gjera të grave në veprimtarinë prodhuese. Në prodhim, si për burrat, ashtu edhe për gratë, duhet të zbatohet parimi "për punë të barabartë, shpërblim të barabartë". Barazia e vërtetë midis burrit dhe gruas mund të arrihet vetëm në procesin e transformimit socialist të mbarë shoqërisë.

Shënim mbi artikullin «Gratë kanë hyrë në frontin e punës» (1955), *Hovi i socializmit në fshatin kinez*.

Pas kooperimit të bujqësisë, një numër i madh kooperativash gjenden përballë mungesës së krahëve të punës, pra është e nevojshme të tërhiqen në frontin e punës

masat e gjera të grave që më parë nuk merrnin pjesë në punët e fushës. . . . Gratë kineze përbëjnë një burim të madh fuqie punëtore. Ky burim duhet shfrytëzuar në luftën për ndërtimin e një vendi të madh socialist.

Shënim mbi artikullin «Tërheqja e grave në prodhim zgjidhi vështirësitë e mungesës së krahëve të punës» (1955), *Hovi i socializmit në fshatin kinez.*

Duhet që të gjithë krahët e punës të grave të hidhen në frontin e punës në bazë të parimit "për punë të barabartë, shpërblim të barabartë". Kjo duhet të bëhet brenda një kohe sa më të shkurtër.

Shënim mbi artikullin «Programi i degës së Federatës Demokratike të Grave për distriktin e Sintait lidhur me punën me gratë gjatë lëvizjes së kooperimit të bujqësisë» (1955), *Hovi i socializmit në fshatin kinez.*

XXXII. KULTURA DHE ARTI

Në botën e sotme gjithë kultura, pra edhe letërsia e arti, u përket klasave të caktuara dhe ndjek një vijë politike të caktuar. Në të vërtetë nuk ka art për art, art që të qëndrojë përmbi klasat, art që të zhvillohet jashtë politikës ose në mënyrë të pavarur prej saj. Letërsia dhe arti proletar janë një pjesë e gjithë çështjes së revolucionit proletar, ose, siç ka thënë Lenini, "rrotë e vidhë" e mekanizmit të përgjithshëm të revolucionit.

> «Fjalime të mbajtura në mbledhjen e Jenanit për çështjet e letërsisë dhe të artit» (maj 1942), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Kultura revolucionare u shërben masave të gjera të popullit si një armë e fuqishme

për revolucion. Para revolucionit ajo e pregatit atë ideologjikisht, ndërsa gjatë revolucionit ajo përbën një sektor të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të frontit të përgjithshëm të revolucionit.

«Mbi demokracinë e re» (janar 1940), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 3.

Letërsia dhe arti ynë u shërbejnë masave të gjera të popullit, në radhë të parë punëtorëve, fshatarëve dhe ushtarëve, ato krijohen për punëtorët, fshatarët e ushtarët dhe përdoren prej tyre.

«Fjalime të mbajtura në mbledhjen e Jenanit për çështjet e letërsisë dhe të artit» (maj 1942), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Punonjësit tanë të letërsisë dhe të artit duhet patjetër ta kryejnë këtë detyrë, të vihen në një truall tjetër, duhet medoemos që, duke u futur thellë në masat e punëtorëve, fshatarëve e ushtarëve dhe në luftën

praktike, në procesin e studimit të marksizmit dhe të shoqërisë të kalojnë gradualisht në anën tjetër — në anën e punëtorëve, fshatarëve dhe ushtarëve, në anën e proletariatit. Vetëm në këtë mënyrë ne do të mund të krijojmë një letërsi dhe një art që t'u shërbejnë me të vërtetë punëtorëve, fshatarëve dhe ushtarëve, një letërsi dhe një art me të vërtetë proletar.

Po aty.

Duhet që letërsia dhe arti të bëhen me të vërtetë një pjesë përbërëse e mekanizmit të përgjithshëm të revolucionit, një armë e fuqishme për bashkimin dhe edukimin e popullit, për goditjen dhe asgjësimin e armikut dhe të ndihmojnë popullin për të luftuar armikun me një zemër dhe vullnet të vetëm.

Po aty.

Kritika letrare dhe artistike ka dy kritere: njërin politik, tjetrin artistik. . . .

Ekzistojnë, pra, dy kritere — politik dhe artistik; po cili është raporti midis tyre?

Midis politikës dhe artit nuk mund të vihet shenja e barazimit, po ashtu sikurse ajo nuk mund të vihet as midis botëkuptimit të përgjithshëm dhe metodave të krijimtarisë artistike dhe të kritikës artistike. Ne mohojmë jo vetëm kriterin politik abstrakt, absolutisht të pandryshueshëm, por edhe kriterin artistik abstrakt, absolutisht të pandryshueshëm. Çdo klasë në çdo shoqëri me klasa ka kriterin e vet të posaçëm, si atë politik, ashtu edhe atë artistik. Megjithatë, cilado klasë qoftë në çdo shoqëri me klasa e vë gjithmonë kriterin politik në vend të parë, kurse kriterin artistik në të dytin. . . . Ne kërkojmë unitetin midis politikës dhe artit, unitetin midis përmbajtjes dhe formës, unitetin midis përmbajtjes politike revolucionare dhe formës artistike sa më të përsosur. Veprat artistike, të cilave u mungon cilësia artistike, sado përparimtare të jenë nga pikëpamja politike, mbeten prapëseprapë të pafuqishme. Prandaj ne jemi si kundër veprave artistike që përmbajnë pikëpamje politike të gabuara, ashtu edhe kundër tendencës

për të krijuar vepra "në stilin e parullave dhe pllakatave" që përmbajnë vetëm pikëpamje politike të drejta, por që nuk kanë forcë artistike. Në letërsi dhe art ne duhet të luftojmë në të dy frontet.

Po aty.

"Le të lulëzojnë njëqind lule, le të konkurojnë njëqind shkolla" është një kurs që nxit zhvillimin e artit dhe përparimin e shkencës, lulëzimin e kulturës socialiste në vendin tonë. Në art mund të zhvillohen lirisht forma dhe stile të ndryshme, në shkencë mund të konkurojnë lirisht shkolla të ndryshme. Ne jemi të mendimit se përdorimi i masave administrative për të përhapur me detyrim një stil, një shkollë dhe për të ndaluar një stil tjetër, një shkollë tjetër do të dëmtojë zhvillimin e artit dhe të shkencës. Çështja se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e padrejtë në art dhe në shkencë duhet zgjidhur me anën e një diskutimi të lirë në rrethet artistike dhe shkencore, duhet zgjidhur me anën e praktikës në art

dhe në shkencë dhe jo me anën e metodave simpliste.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Një ushtri pa kulturë është një ushtri e paditur, dhe një ushtri e paditur nuk është në gjendje ta mundë armikun.

«Fronti unik në punën kulturale» (30 tetor 1944), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

XXXIII. MËSIMI

Në luftën për transformimin e Kinës agrare të prapambetur në një vend industrial të përparuar, ne gjendemi përpara një pune shumë të vështirë, dhe përvoja jonë është fare e pamjaftueshme. Prandaj duhet të dimë të mësojmë.

«Fjala e hapjes në Kongresin e 8-të të Partisë Komuniste të Kinës» (15 shtator 1956).

Gjendja ndryshon pa ndërprerje dhe që idetë tona t'u përshtaten kushteve të reja, ne duhet të mësojmë. Edhe ata që e njohin relativisht mirë marksizmin dhe që mbajnë një qëndrim proletar relativisht të vendosur, prapë duhet të vazhdojnë të

mësojnë, të përqafojnë të renë dhe të studiojnë probleme të reja.

«Fjala e mbajtur në konferencën kombëtare të Partisë Komuniste të Kinës mbi punën e propagandës» (12 mars 1957).

Ne jemi në gjendje të mësojmë atë që më parë nuk e dinim. Ne jemi të aftë jo vetëm të shkatërrojmë botën e vjetër, por edhe të ndërtojmë botën e re.

«Raport në plenumin e dytë të Komitetit Qendror të zgjedhur nga Kongresi i 7-të i Partisë Komuniste të Kinës» (5 mars 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Ndaj mësimit ka dy qëndrime. Njëri prej tyre është qëndrimi dogmatik, marrja e çdo gjëje, të përshtatshme dhe të papërshtatshme, pa marrë parasysh kushtet e vendit tonë. Ky qëndrim nuk është i mirë. Një tjetër qëndrim është që gjatë mësimit të vësh në lëvizje trurin dhe të përvehtësosh ato që u përshtaten kushteve të vendit tonë, do-

methënë të marrësh eksperiencën që është e dobishme për ne. Neve na duhet pikërisht një qëndrim i tillë.

«Mbi çështjen e trajtimit të drejtë të kontradiktave në gjirin e popullit» (27 shkurt 1957).

Teoria e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit është një teori me vlerë universale. Atë duhet ta shikojmë jo si dogmë, por si udhëheqje për veprim. Nuk duhet të mësojmë vetëm termat dhe frazat e marksizëm-leninizmit, por duhet ta studiojmë atë si shkencë të revolucionit. Duhet që jo vetëm të kuptojmë konkluzionet në lidhje me ligjet e përgjithshme, të formuluara nga Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini si rezultat i studimit të jetës reale të gjithanshme dhe të eksperiencës së revolucionit, por edhe të mësojmë nga qëndrimi dhe metoda e tyre në shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjeve.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Në qoftë se kemi një teori të drejtë, por kufizohemi vetëm me fjalë boshe rreth saj, e mbajmë atë në sirtar dhe nuk e vëmë në praktikë, atëherë sado e mirë që të jetë kjo teori, ajo nuk ka asnjë vlerë.

«Mbi praktikën» (korrik 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Është e nevojshme ta përvehtësosh mirë teorinë marksiste dhe ta zbatosh atë. Ta përvehtësosh mirë pikërisht me qëllim që ta zbatosh. Në qoftë se ti do të mund të shpjegosh një ose dy çështje praktike nga pikëpamja marksiste-leniniste, do të meritosh lavdërime dhe mund të thuhet se ke arritur disa suksese. Sa më shumë çështje të shpjegosh, sa më të plota dhe më të thella të jenë shpjegimet e tua, aq më të mëdha do të jenë sukseset e tua.

«Për ndreqjen e stilit në parti» (1 shkurt 1942), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Si lidhet teoria marksiste-leniniste me praktikën e revolucionit kinez? Kjo mund

të shpjegohet me shprehjen popullore: "ta lëshosh shigjetën duke pasur përpara një shenjë". Raporti midis marksizëm-leninizmit dhe revolucionit kinez i ngjet raportit midis shigjetës dhe shenjës. Mirëpo disa shokë e "lëshojnë shigjetën pa pasur përpara një shenjë", qëllojnë ku të mundin. Njerëz të tillë mund t'i sjellin dëm revolucionit.

Po aty.

Ata që kanë eksperiencë në punë, duhet të merren me studimin e teorisë dhe t'i përvishen seriozisht leximit; vetëm atëherë ata do të mund të sistematizojnë e të përgjithësojnë eksperiencën e tyre dhe ta ngrejnë atë në teori, vetëm atëherë nuk do ta marrin gabimisht eksperiencën e tyre të pjesshme si një të vërtetë të përgjithshme dhe do të mund t'u shmangen gabimeve me karakter empirik.

Po aty.

Leximi është mësim; edhe zbatimi është mësim, bile një lloj mësimi akoma më i

rëndësishëm. Të mësojmë të luftojmë në procesin e luftës — kjo është metoda jonë kryesore. Njerëzit që nuk kanë mundësi të hyjnë në shkollë, gjithashtu mund të mësojnë të luftojnë, të mësojnë në luftë e sipër. Lufta revolucionare është çështje e masave popullore. Në këtë luftë njeriu shpesh lufton jo pasi të ketë mësuar të luftojë, por në fillim lufton dhe gjatë luftës mëson; të luftosh do të thotë të mësosh.

«Çështje të strategjisë së luftës revolucionare në Kinë» (dhjetor 1936), *Vepra të zgjedhura*, vëll. I.

Midis civilit dhe ushtarakut ka një farë distance, por kjo distancë nuk është Muri kinez dhe mund të kapërcehet shpejt. Të bësh revolucion, të bësh luftë — kjo është mënyra për ta kapërcyer këtë distancë. Kur themi se nuk është lehtë të studiosh dhe të zbatosh, ne kemi parasysh se nuk është lehtë të studiosh thellë dhe të zbatosh me mjeshtëri. Kur themi se civili mund të bëhet shpejt një ushtarak, ne kemi parasysh se nuk është aspak e vështirë t'i hysh kësaj pune. Lidhur me këto, është me vend të kujtojmë

një proverb kinez: "Në botë nuk ka punë të vështira, duhen vetëm njerëz të ndërgjegjshëm". Përderisa nuk është vështirë t'i hysh një pune, është edhe e mundur të perfeksionohesh. Për këtë duhet vetëm ndërgjegje, duhet vetëm të dish të mësosh.

Po aty.

Ne duhet të mësojmë të punojmë në fushën e ekonomisë nga të gjithë ata që dinë (pavarësisht se cilët janë ata). Ne duhet t'i nderojmë ata si mësues dhe të mësojmë prej tyre me respekt dhe ndërgjegje. Kur nuk dimë, duhet të pranojmë se nuk dimë e të mos hiqemi sikur dimë.

«Mbi diktaturën demokratike të popullit» (30 qershor 1949), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Dije do të thotë shkencë, dhe këtu s'ka vend për kurrfarë hipokrizie ose mendjemadhësie, këtu nevojitet pikërisht e kundërta — ndershmëria dhe modestia.

«Mbi praktikën» (korrik 1937), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 1.

Vetëkënaqësia është armiku i mësimit. Për të mësuar si duhet një gjë, është e nevojshme para së gjithash të flakësh tej vetëkënaqësinë. "Të mësojmë vetë pa u kënaqur" dhe "të mësojmë të tjerët pa u lodhur" — të tillë qëndrim duhet të mbajmë ne.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 2.

Ka njerëz që kanë lexuar disa libra marksiste dhe e heqin vehten si të ditur. Mirëpo leximi i këtyre librave nuk ka depërtuar dhe nuk ka lëshuar rrënjë në mendjen e tyre; ata nuk dinë ta vënë në përdorim atë që kanë lexuar dhe ndjenjat e tyre klasore mbeten të pandryshuara. Ka edhe disa të tjerë që janë shumë mendjemëdhenj. Meqë kanë lexuar disa fraza në libra, ata shesin mend dhe e mbajnë hundën përpjetë. Por me të filluar stuhia, shihet se qëndrimi i tyre është krejt i ndryshëm nga ai i punëtorëve dhe i shumicës së fshatarëve punonjës: i pari është i lëkundshëm, ndërsa i

dyti i vendosur; i pari është i errët, ndërsa i dyti i qartë.

> «Fjala e mbajtur në konferencën kombëtare të Partisë Komuniste të Kinës mbi punën e propagandës» (12 mars 1957).

Për ta përvehtësuar me të vërtetë marksizmin, atë duhet ta studiosh jo vetëm ndër libra, por kryesisht nëpërmjet luftës së klasave, nëpërmjet praktikës në punë dhe kontaktit me masat punëtore dhe fshatare. Në qoftë se intelektualët tanë do të kenë lexuar disa libra marksiste dhe do t'i kenë kuptuar ato në një farë shkalle në procesin e afrimit me masat punëtore dhe fshatare, nëpërmjet praktikës në punë, të gjithë ne do të kemi një gjuhë të përbashkët jo vetëm përsa i përket patriotizmit dhe sistemit socialist, por edhe përsa i përket botëkuptimit komunist. Në qoftë se do të arrihet kjo, puna jonë do të shkojë me siguri shumë më mirë.

Po aty.

PËRMBAJTJA

I.	Partia komuniste	1
II.	Klasat dhe lufta e klasave	9
III.	Socializmi dhe komunizmi	24
IV.	Trajtimi i drejtë i kontradiktave në gjirin e popullit	47
V.	Lufta dhe paqa	61
VI.	Imperializmi dhe të gjithë reaksionarët janë tigra prej letre	75
VII.	Guxim për luftë, guxim për fitore	86
VIII.	Lufta popullore	93
IX.	Ushtria popullore	106
X.	Udhëheqja e komiteteve të partisë	111
XI.	Vija e masave	126
XII.	Puna politike	143

XIII.	Marrëdhëniet midis oficerëve dhe ushtarëve	157
XIV.	Marrëdhëniet midis ushtrisë dhe popullit	162
XV.	Demokracia në tri fushat kryesore	167
XVI.	Arësimi dhe stërvitja	175
XVII.	T'i shërbejmë popullit	180
XVIII.	Patriotizmi dhe internacionalizmi	185
XIX.	Heroizmi revolucionar	192
XX.	Dashuria për punën dhe fryma e kursimit në ndërtimin e vendit	197
XXI.	Mbështetja në forcat e veta dhe lufta këmbëngulëse	206
XXII.	Metoda e të menduarit dhe metoda e punës	215
XXIII.	Hetime dhe studime	243
XXIV.	Ndreqja e mendimeve të gabuara	251
XXV.	Uniteti	266
XXVI.	Disiplina	269
XXVII.	Kritika dhe autokritika	273

XXVIII. Komunistët 284
XXIX. Kuadrot 293
XXX. Rinia 306
XXXI. Gruaja 312
XXXII. Kultura dhe arti 317
XXXIII. Mësimi 323

毛 主 席 语 录

外文出版社出版（北京）
1972年 版
编号：（阿尔巴尼亚）1050—567
00077
1—A1—734Pc